

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 92-të i botimit
Gusht-shtator 2024 / Nr. 5

Starton rrugëtimi akademik i 80 të rinjve të AFA-së



DREJTOR I QKMBMMFA

ARBEN SKËNDERAJ

**Shefe e Sektorit të Botimeve &
Kryeredaktore**

ANJEZA MUSOLLARI

GRAPHIC DESIGNER

AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE

SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË

KOLONEL HYSNI GJERGJI

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

KOLONEL ARBEN DHULI

© Ministria e Mbrojtjes

*Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të
riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimë, pa marrë
autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe
Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

*Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:*

*[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/
revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)*

**Mbrojtja**

- Starton rugëtimi akademik i 80 të rinjve të AFA-së 4
- Shqipëria, promotore e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal në prosperitet të popujve 8
- Sigurimi i jetës së trupave të FA-së me mision jashtë vendit, tashmë vendim i Këshillit të Ministrave 10
- Ministri Vengu: Përkrah miqve në kohëra të vështira 12
- Ministri Vengu pret komandantin e Komandës Europiane të SHBA-së, gjeneral Christopher G. Cavoli: Mirënjohje SHBA-së për mbështetjen në përpjekjet për modernizimin e FA-ve 14
- Ministri Vengu viziton Kosovën: Shqipëria, avokate e fortë për anëtarësimin e Kosovës në organizmat ndërkombëtare 15
- Ministri Vengu inspekton punimet për ndërtimin e Kampusit të Akademisë së FA-së: Do t'i shërbejë rritjes së profesionalizmit të Forcave tona të Armatosura 18
- Ndryshimet në buxhetin e 2024, ministri Vengu: Mundësojnë realizimin e disa investimeve të rëndësishme në Mbrojtje 19
- Deklarata e Shefave të Mbrojtjes së Iniciativës SHBA-Karta e Adriatikut: Qëllim kryesor, integrimi i të gjitha vendeve aspirante të Evropës Juglindore në NATO 20
- Ministri Vengu: Solidariteti evropian dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, shembull i shkëlqyer i misionit mes vendeve 22
- Zhvillohet Takimi "NATO Resilience Expert Consultation Meeting" 24
- U zhvillua Konferenca Planëzuese Kryesore "Defender Europe-25" 26
- Përfundoi me sukses trajnimi për Operacionet Psikologjike "PSYOPS" 27
- Detashmenti CIMIC i Forcës Tokësore, pjesë e stërvitjes vjetore "Saber Junction 2024" 28
- Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo priti në takim atasheun ushtarak të SHBA-ve në Shqipëri, kolonel Eric Coté 31
- Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit midis FARSH/FAJ dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, TIA 32
- Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë organizon ceremoninë e daljes në lirim të ushtarakëve 33
- Anija "Oriku" realizoi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane "Pegnitz" (M1090) 35
- Anija veliere italiane "Palinuro" zhvilloi një vizitë në portin e Durrësit 36
- Kontingjenti XV EOD me mision në eFP Letoni, tregon aftësitë operacionale në stërvitjen demonstruese, në pëmbushje të angazhimeve të Grup Batalionit Shumëkombësh 37
- SEEBRIG, siguri, stabilitet rajonal, besim, marrëdhënie e fqinjësisë së mirë midis vendeve të Europës Juglindore 40
- Bashkim Likaj, skënderbegasi, emblemë e mundjes shqiptare 43
- Integrimi i STANAG/AP-ve në botimet doktrinare, faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit të ndërveprimit në FA dhe vendet e Aleancës së NATO-s 48
- Logjistika e kontestuar 51
- "Proxy", një komponent i nënvlerësuar i luftës 54
- Pushtimi i Kurskut, ndër 3 poshtërimet e mëdha të Putinit në Ukrainë! 58
- "Mosmirënjohja, thelbi i poshtërsisë" 62
- Forca Tokësore, 24 vite mbrojtje e sovranitetit, pjesëmarrje në operacione humanitare dhe luftarake në mbështetje të paqes 64
- 9 shtator 1996, misioni i parë i FARSH-së në Bosnjë-Hercegovinë 66
- Rugëtimi historik i strukturës arsimore të mbi 45 mijë ushtarakëve elitë 69
- Historia 66 - vjeçare e nëndetësve shqiptare 72
- 15 vite SHKURSH, me të drejta të plota në CIOR 75
- Ushtria Amerikane i bashkohet betejës, nëse ndonjë prej këtyre vendeve shkon në luftë 79
- Teknologjia e parë në botë e kontrollit të mendjes 82
- Valiev dhe Dudaev: Synojmë medalje të artë, Shqipërinë e kemi në zemër 84
- Atdheu përjetë mirënjohës! 86
- Mustafa Gjinishi, komisari i parë i çetës partizane të Pezës 88
- Gjeneralitetet personal apo identikit kombëtar? 98

60

**"Mosmirënjohja,
thelbi i
poshtërsisë"**

04

Starton rrugëtimi akademik i 80 të rinjve të AFA-së


20

Deklarata e Shefave të Mbrojtjes së Iniciativës SHBA-Karta e Adriatikut: Qëllim kryesor, integrimi i të gjitha vendeve aspirante të Evropës Juglindore në NATO

56

“Proxy”, një komponent i nënvlerësuar i luftës

egjithëse shpesh anashkalohet ose keqinterpretohet, lufta “proxy” është një komponent i rëndësishëm i konfliktit të armatosur. Politikë bërësit dhe ushtarakët duhet të kuptojnë nuancën e luftës “proxy” për të shmangur gabimet në politikë dhe në praktikën ushtarake luftarake. Një luftë “proxy” mund të marrë formën e modelit tradicional më të njohur ose të modelit të përhapjes së teknologjisë. Në modelin tradicional, një aktor kryesor “palë e parë” përdor një palë “të tretë” për ashpërsi të luftimit kundër një armiku që është “pala e dytë”....



SEEBRIG, siguri, stabilitet rajonal, besim, marrëdhënie e fqinjësisë së mirë midis vendeve të Evropës Juglindore

Intervistoi:
ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

25 vjet nga themelimi, Brigada e Evropës Juglindore (SEEBRIG), një nga iniciativat rajonale të Ministrave të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM), vazhdon të tregojë se është një mekanizëm jashtëzakonisht i vlefshëm për promovimin e sigurisë...

Faqe 42



Integrimi i STANAG/AP-ve në botimet doktrinare, faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit të ndërveprimit në FA dhe vendet e Aleancës së NATO-s

Integrimi i STANAG/AP-ve në botimet doktrinare, manualët dhe rregulloret e strukturave të FA-së merr...

Faqe 50



Starton rrugëtimi akademik i 80 të rinjve të AFA-së

Viti akademik 2024-2025, ashtu si në të gjithë vendin startoi dhe për të rinjtë dhe të rejtat e Forcave të Armatosura. Në ceremoninë e organizuar nga Akademia e Forcave të Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes morën pjesë autoritete të larta si, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, ministrja e Arsimit dhe Sportit znj. Ogerta Manastirliu, ministri i Mbrojtjes i Kosovës, z. Ejup Maqedonci, komandantë të forcave, drejtorë të MM dhe SHPFA, rektorë të universiteteve,

studentë, personeli akademik, si dhe drejtues të AFA-së.

Ceremoninë e hapi gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, komandant/rektori i AFA-së, i cili në fjalën e tij përshëndetëse u shpreh se: “Dita e sotme mbart shumë emocione për të gjithë ne, por në mënyrë të veçantë për 80 studentët e rinj, përfshirë dhe ata nga Republika e Kosovës, të cilët, kanë vendosur t’i përkushtohen një prej profesioneve më fisnike dhe më të nderuara, profesionit të ushtarakut. Ju keni bërë zgjedhjen e duhur për t’u arsimuar



në Akademinë e FA-së. Këtu ju do të përgatiteni si liderë të së ardhmes të FARSH, për t'i shërbyer me devotshmëri atdheut, për të kontribuar në sigurimin e paqes kudo në botë, të rreshtuar me krenari "krah për krah" aleatëve tanë të NATO-s.

Akademia e Forcave të Armatosura, duke ndjekur modelin e Akademisë Ushtarake të SHBA-ve, 'West Point', vjen sot si një Institucion i Arsimit të Lartë edhe më i konsoliduar, duke hapur dyert e saj për 315 studentë, me gjashtë programe studimi në ciklin e parë, Bachelor, dhe tre programe të ciklit të dytë, dy prej të cilëve ofrohen për herë të parë: Master Shkencor në 'Siguri dhe Politikë Ndërkombëtare' dhe 'Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale'.

Intensifikimi i marrëdhënieve me institucionet e tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, është dhe do të mbetet prioritet i Akademisë së Forcave të Armatosura, me qëllim thellimin, zgjerimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe rritjen e ofertës akademike, duke përfshirë dhe hapjen e ciklit të tretë, të studimeve, programin PHD, brenda vitit akademik 2026, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Akademisë së Forcave të Armatosura.

Me prioritet të veçantë gjithashtu është parë edhe përmirësimi i infrastrukturës. Falë një investimi serioz nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, AFA po ndërton një prej kampuseve më modernë të arsimit të lartë në vend, për të ofruar një edukim me kushte moderne, të mirë pajisur me laboratorë, mjete didaktike

dhe teknikë bashkëkohore".

Më tej gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj falënderoi Ministrin e Mbrojtjes, Ministren e Arsimit dhe Sportit, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, për mbështetjen e vazhdueshme që i japin Akademisë së Forcave të Armatosura në procesin e vazhdueshëm



të transformimit.

Në fund, gjeneral brigade Nuredinaj u përcollti një falënderim të veçantë stafit akademik, administrativ dhe personelit komandues, të cilët punojnë me profesionalizëm dhe përkushtim për të bërë të mundur edukimin dhe farkëtimin e gjeneratave të studentëve ushtarakë me vlerat më të mira qytetare dhe ushtarake.

Më tej në fjalën e rastit Ministri e Arsimit dhe Sportit, znj. Ogerta Manastirliu u shpreh se ndihet e nderuar që ndodhej në këtë ceremoni me cilësinë e Ministres së Arsimit dhe sportit, por dhe si bijë e një oficeri të mbrojtjes. "Jam krenare, sepse për pak vite është dyfishuar numri i aplikuesve për AFA-në, ku para disa vitesh kemi qenë me rreth 600 aplikime për rreth 70 vende për ciklin e parë të studimeve dhe sot kemi rreth 1200 aplikime. Sigurisht që sfidat janë të shumta edhe për AFA-në, ashtu sikurse për të gjithë sistemin tonë të arsimit të lartë universitar, ku së bashku jemi duke u përpjekur për të përballuar sfidat e kohës, ku në universitete të ndryshme shfaqen sfida të ndryshme lidhur



me sfidat e teknologjisë, informacionit dhe sfidat që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë, sfida që lidhen me shkencat ekzakte, sfida që lidhen me formimin e profesionistëve të ndryshëm të shumë fushave. Sigurisht jam këtu sot edhe për të thënë se Ministria e Arsimit dhe Sportit do të vijojë me dedikim të mbështesë AFA-në, pasi AFA ka një status të veçantë dhe gjithashtu kemi punuar së bashku për të arritur drejt akreditimit institucional, faza e të cilit është drejt përfundimit, dhe shumë shpejt do të kemi një përfundim të kësaj detyre të madhe që është akreditimi institucional i AFA-së, në bazë të akreditimit të të gjithë cikleve të studimit. Jam gjithashtu e kënaqur të them se jo vetëm kemi arritur që të realizojmë dhe një objektiv tjetër për sa i përket ciklit të integruar të studimeve, por kjo Akademi është duke u përshtatur me standardet më të mira Akademisë “West Point”, të SHBA-ve, dhe ne si Ministri e Arsimit dhe Sportit jemi të gatshëm që të ofrojmë të gjithë lehtësirat e mundshme në çdo element që ka të bëjë me programin e studimit, por gjithashtu edhe me lehtësimin në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit dhe të profilizimit të ndryshëm.

Një vlerë e shtuar e kësaj ceremonie ishte dhe ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, zoti Ejup Maqedonci, i cili në fjalën e tij përshëndetëse do të shprehte emocionet e tij të veçanta: “Përveç faktit që jam një shqiptar i Kosovës, me Shqipërinë, dhe veçanërisht me ushtrinë shqiptare, më lidh e kaluara e tashmja dhe padyshim që do të më lidhë edhe e ardhmja. Në një kohë e rrethana krejtësisht të tjera, këtu në Shqipëri, në mars të vitit 1998, pikërisht nga një ish-oficer shqiptar nga Tirana, i quajtur Adem Shehu, mora njohuritë e para, para

luftës në Kosovë. Ademin më vonë do ta kisha edhe komandant brigade gjatë luftës në Kosovë. Në Shqipëri do të vijë më pas edhe shumë herë të tjera si komandant i kontingjentit të FSK-së, gjatë përmbajtjeve në qarkun e Shkodrës në vitin 2010; si oficer



planifikues në shumë aktivitete të përbashkëta; si vizitor i bukurive natyrore të Shqipërisë, por edhe si një ndër tifozët e parë të tifoklubit “Tifozët Kuq e Zi”, për të ndjekur ndeshjet e kombëtares sonë. Sot në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, i ftuar nga ministri Vengu, erdha këtu për të shënuar një datë të veçantë për ju kadetë të dashur, datë që shënon fillimin e formësimit tuaj akademik dhe profesional, rrugëtim ky krejt i veçantë dhe në thelb i jashtëzakonshëm. Padyshim profesioni

i ushtarakut por edhe edukimi në këtë profesion kërkon mund e sakrificë, përpjekje e angazhim, por ju jep mundësinë që t'i shërbeni Atdheut, kjo mundësi nuk jepet shpesh në jetë. Njeriu mund të ketë shanse e mundësi për t'u zhvilluar e për të punuar për vetveten gjatë gjithë jetës, por për të marrë pozitë publike, ku mund t'i shërbesh të tjerëve e para së gjithash Atdheut tënd është mundësi e rrallë, e çmuar. Duajeni këtë profesion, jepni më të mirën që ka secili nga vetja, do t'ju bëjë krenarë gjithë jetës, juve, familjen dhe fëmijët tuaj në të ardhmen. Dy ministrinë tona në vazhdimësi, por në veçanti në periudhën e fundit kanë rritur, thelluar dhe zgjeruar bashkëpunimin e ndërsjellë. Trajnimet e ushtrimit e përbashkëta edukimi i kadetëve të të dyja vendeve në akademitë ushtarake të Shqipërisë dhe Kosovës dhe bashkëpunimi në fushat e tjera, përveçse janë duke ndikuar në shkëmbimin e njohurive, po ndihmojnë edhe në ndërtimin e raporteve ndërpersonale të ushtarakëve tanë, duke lidhur kështu edhe më shumë kombin që jeton në dy shtetet tona". Ministri Maqedonci do të vinte theksin e tij se: "Në këtë kohë të ndryshimeve në ambientin strategjik të sigurisë, ku siguria e përgjithshme është shndërruar në çështje kryesore edhe në nivel global, bashkëpunimi mes nesh nuk është vetëm i nevojshëm por edhe i domosdoshëm. Gjersa kërcënimet i kemi të përbashkëta, është e pashmangshme që edhe qasjen dhe veprimet tona karshi këtyre kërcënimeve t'i kemi të përbashkëta. Përmes bashkëpunimit në fushat e stërvitjes dhe edukimit ushtarak, përveç trajnimit dhe zhvillimit individual të ushtarakëve tanë u mundësojmë dhe ndërtimin e ndërveprimit taktik dhe operacional të forcave tona ushtarake.



Të dashur kadetë, në këtë ditë të shënuar për ju, familjet tuaja e për të gjithë ne, ju uroj rrugëtim të suksesshëm në zhvillimin tuaj profesional dhe akademik. Qëndroni të bindur në zgjedhjen tuaj për profesionin fisnik të ushtarakut. Ju përshëndes në emër të qeverisë së Republikës së Kosovës, ju përcjell urimet e kadetëve të FSK-së. Një ditë do të jeni krah për krah me ta, duke u stërvitur në misione paqeruajtëse bashkë me ushtarë të tjerë të shteteve aleatë tanë. Nderojeni Shqipërinë, nderojeni Kosovën, nderojeni kombin!".

Ceremonia e fillimit të vitit të ri akademik u përshëndet dhe nga Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, z. Piro Vengu, i cili mes të tjerash u shpreh: "Është një përgjegjësi e madhe që t'i adresohesh kësaj rruge, të cilën e keni marrë me vendosmëri, por edhe një farë risku, duke vendosur që të hyni në një rrugë akademike ndryshe nga të tjerat, një rrugë akademike e cila përmban jo vetëm përgatitjen nga ana mësimore, përgatitjen fizike, por edhe përgatitjen morale. Synimi që kemi bashkë me stafin akademik, me të cilët kemi ndërtuar një marrëdhënie të posaçme bashkëveprimi është që ta kthejmë Akademinë e Forcave të Armatosura në një shkollë komandimi, e cila ofron edhe njohuritë më të fundit, me programet e saj akademike, por ofron gjithashtu një karrierë të sigurt, një karrierë sfiduese me të gjitha avantazhet e benefitet që sjell uniforma. Qeveria Rama ndër vite ka mundësuar që uniforma të jetë ajo që nderohet dhe kjo uniformë të ketë gjithashtu jo vetëm përgjegjësitë por edhe benefitet që i takojnë, qoftë nga pikëpamja e pagës, qoftë nga pikëpamja e motivimit profesional dhe ana e mbështetjes së familjeve të ushtarakëve tanë. I përmend këto sepse është padyshim privilegj veshja e uniformës, janë të paktë ata që e kanë këtë privilegj. Ne synojmë që të jenë edhe më shumë në të ardhmen, ndaj dhe investojmë fuqishëm në mënyrë që akademia të hapet edhe më shumë në të gjithë spektrin e njohurive bashkëkohore, padyshim duke investuar më shumë në teknologjinë e informacionit dhe mbrojtjen kibernetike. Gjithashtu kemi biseduar me të gjithë Shtabin, kohët e fundit, mënyrën më të mirë se si akademia jonë t'i përgjigjet nevojave të strategjisë kombëtare të mbrojtjes dhe strategjisë kombëtare të industrisë

ushtarake. Ndaj, aty ku akademia nuk mund të ofrojë kurrikula të caktuara e të specializuara, së bashku me mbështetjen e ministres së Arsimit, do të synojmë që përmes universiteteve të tjera në vend të mundësojmë programe me formime të dyfishta për inxhinierë të specializuar, për inxhinierë të prodhimit të armatimit, si dhe inxhinierë në fushën e mbrojtjes kibernetike apo të teknologjive, që iu nevojiten forcave për të ushtruar secili detyrën e tyre". Më tej ministri Vengu theksoi se ka ardhur momenti që forcat e armatosura në tërësi ta shohin përgjegjësinë e tyre përtej detyrave të mbrojtjes së integritetit dhe sovranitetit të vendit, të cilat janë parësore dhe do të vijnë në mbeten të tilla. "Ne së bashku me gjeneralët e Shtabit dhe stafin pedagogjik të AFA-së, kemi bindjen që Forcat e Armatosura do të luajnë rolin e një skuadre, e cila përpilon dhe përgatit burime njerëzore si kapacitet kombëtar, që t'i vlejë kombit jo vetëm si forca të armatosura, por edhe në fusha të tjera civile dhe është shumë e rëndësishme që t'ju japin mundësinë në karrierën tuaj që të vijoni dhe karrierën civile dhe të riktheheni në Forcat e Armatosura dhe të keni një ecuri karriere të gjithanshme, sepse janë të pranishme sidomos në vendet më të zhvilluara të NATO-s, kanë krijuar një marrëdhënie shumë dinamike mes uniformës, jetës civile, rikthimit në uniformë, sipas nevojave të vendit në momente të caktuara", - do të mbyllte fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes Vengu.



Shqipëria, promotore e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal në prosperitet të popujve

U mbajt në Tiranë Konferenca e 27-të e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Iniciativës SHBA - Karta e Adriatikut, nismë që këtë vit kryesohet nga Shqipëria. .

Ky takim i rëndësishëm i përfaqësuesve më të lartë ushtarakë të vendeve të Iniciativës SHBA - Karta e Adriatikut u përshëndet edhe nga presidenti i Republikës, njëherësh komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Bajram Begaj, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë, njëherësh komandant i Forcave Amerikane në Europë, gjeneral Christopher G. Cavoli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Arben Kingji.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu theksoi se ky takim simbolizon përkushtimin e vendeve tona për sigurinë kolektive, bashkëpunimin e mbrojtjes dhe stabilitetin rajonal: “Secili nga vendet

tona ka historinë dhe sfidat e veta unike, por ne jemi të bashkuar nga një qëllim i përbashkët: të garantojmë paqen dhe sigurinë për qytetarët tanë. Lidhjet që ne forcojmë përmes kësaj konference shtrihen përtej fuqisë ushtarake; ato përfshijnë parimet e lirisë, të drejtat e njeriut dhe prosperitetit për popujt tanë. Në këtë kuptim, është e domosdoshme të ndërtojmë dhe avancojmë këto parime, vlera dhe rezultate të arritura deri më tani dhe jo të vetëkënaqemi, apo aq më keq, t'i çojmë në regres”, - u shpreh ministri Vengu.

Shqipëria, sipas ministrit të Mbrojtjes, vijon të ketë në fokus të saj, promovimin e fqinjësisë së mirë, pranimin të njëri-tjetrit, integrimin e plotë euroatlantik dhe forcimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit rajonal: “Mos të biem pre e interesave dhe ndërhyrjeve dashakeqëse të Rusisë, Kinës dhe Iranit, të cilat përbëjnë një triadë mjaft

shqetësuese dhe për ne si Shqipëri, ato nuk duhet të kenë vend në të tashmen dhe të nesërmen e rajonit tonë”, - nënvizoi në fjalën e tij ministri Vengu.

Teksa foli për zhvillimet në Ballkanin Perëndimor, ministri i Mbrojtjes tha se: “Historia nuk ka qenë shumë ‘e dashur’ me rajonin tonë, por assesi nuk duhet të mbejtemi peng i së shkuarës. Është thelbësore të tejkalohen problemet etnike, kulturore dhe politike që kanë qenë vetëm burim konfliktesh. Mësimet duhet t'i kemi nxjerrë, edhe pse shpeshherë, dëgjojmë zëra përçarës e zjarr-nxitës ‘partnerë të vlerave perëndimore në deklarata, por ithtarë dhe shërbëtorë të dukshëm të luftës hibride të Lindjes’, të cilët gjithashtu nxisin grupet ultra-nacionaliste e kriminale të vendosin në pikëpyetje stabilitetin, sigurinë dhe paqen në rajon”.

“Shqipëria, - theksoi më tej në fjalën e tij ministri i Mbrojtjes, - do vijojë të jetë një

avokate e palëkundur e bashkëpunimit rajonal dhe në një mori iniciativash rajonale; Karta e Adriatikut qëndron në ballë me tregues të prekshëm, si pjesëmarrja e vendeve tona në Afganistan para shumë viteve, apo trajnime e stërvitje të përbashkëta, siç është seria e stërvitjeve 'Defender Europe', rishtazi".

Teksa informoi për projektet e radhës së Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë dhe misionet e Forcave të Armatosura në krah të Aleancës së NATO-s, ministri Vengu theksoi se: "duhet gjithashtu që Karta të qëndrojë besnike e parimeve themelore të saj, përfshirë 'Politikën e Dyerve të Hapura'. Në këtë kuptim, më lejoni të them, që vendi i Kosovës duhet të jetë këtu, në këtë tavolinë".

Në mbyllje të fjalës së tij, ministri Vengu nënvizoi rëndësinë e angazhimit të përbashkët të aleatëve dhe partnerëve të NATO-s: "Në një botë që ndërlidhet gjithnjë e më shumë, është e domosdoshme të punojmë së bashku dhe të shfrytëzojmë fuqinë kolektive. NATO dhe BE qëndrojnë si forca të pakrahasueshme dhe shumëfishuese për të ardhmen e rajonit, ndërsa SHBA-të, 'ylli polar', pa të cilin, ky rajon nuk do ishte ky që është sot", - u shpreh ministri Vengu.

Kjo konferencë bashkë-kryesohet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë, njëherësh komandant i Forcave Amerikane në Europë, gjeneral Christopher G. Cavoli.

Fokusi i kësaj konference janë zhvillimet dhe dinamikat në mjedisin e sigurisë në rajon dhe më gjerë, rritja e shpenzimeve të Mbrojtjes mbi pragun 2% e Produktit të Brendshëm Bruto, si një mënyrë për të përmbushur objektivat e kapaciteteve të Aleancës dhe objektivat e planifikimit dhe rishikimit të NATO-s për vendet partnere.

Në përfundim të punimeve morën pjesë vendet nënshkruese të A-5: SHBA, Shqipëri, Bosnje - Hercegovinë, Kroaci, Mal i Zi dhe Maqedonia e Veriut, ndërsa në statusin e vëzhguesit janë të pranishëm edhe përfaqësues nga Kosova dhe Sllovenia, komandanti i Komandës së Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli, Itali, si dhe adjutantët e përgjithshëm nga shtetet përkatëse të Programit të Partneritetit të Gardave Kombëtare të SHBA-ve (New Jersey, Maryland, Minnesota, Vermont, Maine), shtetet e Programit të Partneritetit Shtetëror Vëzhgues (Ohio, Colorado, Iowa).



Rijetëzimi i Industrisë Ushtarake, 440 milionë lekë për fazën e parë të projektit

Akti normativ i Këshillit të Ministrave injekton 440 milionë lekë në fazën e parë të projektit për rijetësimin e Industrisë Ushtarake.

Konkretisht, janë alokuar 290 milionë lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të uzinave të industrisë ushtarake ndaj punonjësve, ish-punonjësve, bashkive dhe enteve të tjera.

150 milionë lekë janë dedikuar për themelimin e shoqërisë tregtare "KAYO sh.a", e cila do të udhëheqë procesin e modernizimit të Industrisë Ushtarake dhe rijetësimin e kapaciteteve prodhuese të Mjekësit, Gramshit dhe Poliçanit.

Rijetësimi i Industrisë Ushtarake është një mundësi e re për zhvillimin ekonomik dhe social të zonave të përfshira në këto projekte, por edhe shumë i rëndësishëm për integrimin e vendit në hallkat e prodhimit dhe logjistikës ndërkombëtare.

Projekti i qeverisë shqiptare për modernizimin e sektorit, kontribuon gjithashtu në forcimin e kapaciteteve të Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare në përputhje me objektivat e Aleancës.

Trupave të Forcave të Armatosura, që shërbejnë në misionet jashtë vendit do t'u sigurohet jeta dhe shëndeti. Vendimi është marrë në mbledhjen e fundit të qeverisë dhe u bë publik nga ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu. “Kemi një vendim të rëndësishëm që ka të bëjë me ofrimin e gjithë paketës financiare dhe ligjore që ofron dhe mbulon sigurimin e jetës së trupave të Forcave të Armatosura me mision jashtë vendit. Një vendim shumë i rëndësishëm për dy arsye: e para sepse kemi një diversifikim të misioneve jashtë vendit, kemi një shtesë të angazhimit të Shqipërisë, jo vetëm në misione që tashmë lidhen jo vetëm me NATO-n, por edhe Bashkimin Evropian, misione qoftë me kontribute tokësore, por tashmë edhe me kontribute detare. Sigurohemi që të gjitha forcat tona të angazhuara jashtë kanë mbulimin e nevojshëm në vështirësitë që mund të hasin, në misione që zgjasin, më shumë se disa muaj”, - theksoi ministri Vengu,

Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për sigurimin e jetës së personelit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, që dërgohet me misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit.

Vendimi i zbardhur jep detaje për sigurimin e jetës së personelit të Forcave të Armatosura për vitet 2024, 2025 dhe 2026.

-Sigurimi i jetës bëhet sipas kontratës që lidhet me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Ky sigurim mbulon ngjarjet në rastet e:

a) Humbjes së jetës për shkak të detyrës apo si rezultat i aksidenteve gjatë ushtrimit të saj;

b) Zhdukjes;

c) Dëmtimit shëndetësor, me pasojë paaftësi të përhershme, të plotë ose të pjesshme, si rezultat i një aksidenti gjatë kohëzgjatjes së misionit ushtarak dhe stërvitjes jashtë vendit;

ç) Dëmtimit shëndetësor, me pasojë paaftësi të përkohshme, të plotë ose të pjesshme, si rezultat i një aksidenti gjatë



Sigurimi i jetës së trupave të FA-së me mision jashtë vendit, tashmë vendim i Këshillit të Ministrave



kohëzgjatjes së misionit ushtarak dhe stërvitjes jashtë vendit;

d) Shërbimeve mjekësore në spitalet publike ose private brenda dhe/apo jashtë vendit, kur mbulimet shëndetësore nuk ofrohen në spitalet publike.

- Shuma e përcaktuar në kontratën e sigurimit, për çdo person të siguruar, nuk është më e ulët se:

a) 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për rastet e humbjes së jetës për shkak të detyrës apo zhdukjes së personit;

b) 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, për rastet e dëmtimit shëndetësor me pasojë paaftësi të përhershme;

c) 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për rastet e humbjes së jetës, si rezultat i aksidenteve gjatë ushtrimit të detyrës;

ç) 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për rastet e dëmtimit shëndetësor, me pasojë paaftësi të përkohshme.



Ministri Vengu viziton Komandën e KFOR-it dhe kontingjentin e forcave shqiptare në Pejë

Ministri Vengu vizitoi Komandën e KFOR-it dhe kontingjentin e forcave shqiptare në Pejë. Gjatë vizitës zyrtare në Kosovë, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu u ndal edhe në Komandën Qendrore të KFOR-it, si dhe në Komandën e Zonës Perëndimore në Pejë, ku takoi trupat shqiptare, që shërbejnë përkrah vendeve aleate dhe partnere të NATO-s.

I shoqëruar nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Petrit Malaj, ministri i Mbrojtjes u prit nga komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutaş, me të cilin ndanë shqetësimin rreth kontekstit të brishtë të sigurisë, kryesisht në veri të Kosovës, duke kujtuar sulmet kriminale dhe terroriste ndaj trupave të KFOR-it si edhe atë në Banjskë, vitin e kaluar: “Shqipëria mbështet pa asnjë lëkundje KFOR-in, si të vetmen garanci për një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm në Kosovë”, - u shpreh Vengu, duke falënderuar gjeneralmajor Ulutaş për vendosmërinë dhe maturinë në parandalimin e situatave kërcënuese.

Në bazën e KFOR-it në Pejë, delegacioni shqiptar u prit nga komandanti italian i ba-

zës, koloneli Mundo, i cili e informoi zotin Vengu për kontributin e trupave shqiptare, duke theksuar se angazhimi dhe profesionalizmi i tyre vlerësohet nga të gjithë shtetasit e Kosovës dhe veçanërisht nga minoritetet. Në takim me kontingjentin shqiptar, ministri Vengu falënderoi gratë dhe burrat e Forcave tona të Armatosura që shërbejnë në misionin e KFOR, i cili ka për qëllim sigurinë e të gjithë popullsisë dhe lirinë e lëvizjes në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Rritja e kontributeve të Shqipërisë në misionet e NATO-s, kërkon gjithashtu një vëmendje më të madhe ndaj përmirësimit të kushteve në mision të forcave tona dhe mbështetje të vazhdueshme për familjet e tyre. Kontingjenti shqiptar në misionin e KFOR-it është rritur së fundmi dhe përbëhet nga 107 efektivë në Komandën Rajonale Perëndimore në Pejë dhe 25 përfaqësues civilë dhe ushtarakë në Shtabin e KFOR-it në Film City, Prishtinë.



Ministri Vengu: Përkrah miqve në kohëra të vështira

Në takimin e 24-të, në Ramstein, Gjermani, mbledhet grupi i kontaktit, pjesë e të cilit ishte dhe Ministri Mbrojtjes z. Pirro Vengu, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral-major Arben Kingji.

Ky koalicion është i përbërë nga të gjitha vendet e NATO-s dhe më shumë se 18 vende partnere, të bashkuar dhe të vendosur për të ndihmuar Ukrainën kundër pushtimit të paprovokuar të nisur nga Rusia që prej shkurtit 2022.

Në fjalën e tij, ministri Vengu çmoi këtë nismë të udhëhequr nga SHBA-të dhe nënvizoi se Shqipëria do vazhdojë të qendrojë përkrah Ukrainës dhe popullit të saj, duke vijuar të japë asistencë ushtarake dhe humanitare.

Në këtë drejtim, vendi ynë radhitet ndër vendet me kontribut domethënës në radhët e Aleancës, në përpjekjen kolektive për të rritur kapacitetet ukrainase dhe për të frenuar agresionin rus. Më tej ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu diskutoi për çështje të ndryshme me interes dypalësh me



homologët e Italisë, Britanisë së Madhe, Kanadasë dhe Letonisë.

Rijetësimi i industrisë ushtarake, një nga pikat qendrore të programit të qeverisë shqiptare, ishte në qendër të bisedimeve me homologët, ndërsa u dakordësuan

edhe veprimtari të përbashkëta që kanë lidhje me sigurinë ndërkombëtare në kuadër të NATO-s.

Me homologun e Kosovës z. Ejup Maqedonci, u ritheksua nevoja e koordinimit në kuadër të iniciativave të sigurisë rajonale

***Vendi ynë radhitet
ndër vendet
me kontribut
domethënës në
radhët e Aleancës,
në përpjekjen
kolektive për të
rritur kapacitetet
ukrainase dhe për
të frenuar
agresionin rus.***





me qëllim anëtarësimin dhe përfshirjen më të madhe të Kosovës.

Në takimin me homologun e Maqedonisë së Veriut, biseda e ministrit Vengu u zhvendos te përpjekjet për zhvillimin e Korridorit të 8-të, si një aks me rëndësi strategjike për zinxhirët e furnizimit dhe sigurinë e rajonin. Kolegu Misajlovski konfirmoi angazhimin e tij dhe të qeverisë së Maqedonisë së Veriut për të vijuar punën dhe investimet për këtë projekt, duke nënvijëzuar rëndësinë e mbështetjes nga Bashkimi Evropian.

Në lidhje me këtë projekt, ministri Vengu diskutoi edhe me kolegun bullgar, ministrin Atanos Zapryanov, me të cilin ra da-



kord për ndërveprim më të madh në muajt në vijim.

Së fundmi në takimin me kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Bauer, u bisedua mbi hapat që po ndërmerr Aleanca që prej Samitit të Uashingtonit si edhe zbatimin e planeve të Mbrojtjes. Në këtë drejtim u trajtua ecuria e ndërtimit të kompleksit portual civil dhe ushtarak në Porto Romano, si një kapacitet me rëndësi kritike për vendin tonë dhe të dobishëm për Aleancën.

Në takim mori pjesë edhe presidenti i Ukrainës z. Zelenski, ndërkohë që bisedimet zhvillohen në një moment kyç dhe dinamik të luftimeve në terren.



Ministri Vengu pret komandantin e Komandës Europiane të SHBA-së, gjeneral Christopher G. Cavoli: Mirënjohje SHBA-së për mbështetjen në përpjekjet për modernizimin e FA-ve

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu priti në një takim komandantin Suprem të Forcave Aleate në Evropë, njëherësh komandant i Forcave Amerikane në Evropë, gjeneral Christopher G. Cavoli dhe delegacionin e tij.

Gjatë bisedës me ushtarakun e lartë amerikan, ministri Vengu foli për situatën në rajon, mbështetjen e madhe që NATO vijon të japë në Kosovë dhe rrugëtimin e saj euroatlantik, sikundër dhe nevojën që të adresohen njëzëri retorikat destabilizuese dhe influencat dezinformuese të aktorëve të tretë në vendet e rajonit.

Ministri Vengu falënderoi gjeneral Cavolin për mbështetjen jetike që Shtetet e Bashkuara të Amerikës japin çdo ditë në përpjekjet për modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë si dhe fuqizimin e kapitalit njerëzor. Gjatë këtij takimi, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu rikonfirmoi gjithashtu mbështetjen e Shqipërisë ndaj Ukrainës dhe garantoj se vendi ynë do të vijojë të kontribuojë në këto ditë të vështira për të, si një investim në sigurinë e mbarë kontinentit.

Nga ana e tij, gjeneral Cavoli përshëndeti masat e marra për rivitalizimin e Industrisë Ushtarake në Shqipëri, jo vetëm si një in-

strument zhvillimi ekonomik, por gjithashtu si një industri që do të përshpejtojë rritjen e kapaciteteve të Shqipërisë në armatim dhe inovacion brenda planeve të Aleancës.



Ecuria e zhvillimit dhe modernizimit të infrastrukturës portuale në Porto Romano zuri një vend të rëndësishëm në këtë takim. Ministri Vengu dhe komandanti i lartë amerikan u ndalën në detaje të rëndësishme të këtij projekti, si pjesë jetësore e infrastrukturës rajonale të Korridorit VIII, një korridor i dobishëm për sigurinë, lëvizshmërinë ushtarake si dhe zinxhirët e furnizimit të rajonit dhe mbarë Aleancës.

Më herët gjeneral Cavoli u prit me ceremoni nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji. Gjeneralmajor Kingji e njohu gjeneral Cavolin me disa nga zhvillimet kryesore në Forcat e Armatosura shqiptare, kontributin e vendit tonë në operacionet dhe misionet e drejtuara nga Aleanca, rishikimin e dokumenteve strategjike, përmirësimet ligjore si dhe projektet e modernizimit.

Ministri Vengu viziton Kosovën: Shqipëria, avokate e fortë për anëtarësimin e Kosovës në organizmat ndërkombëtare

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, vizitën e tij të parë zyrtare jashtë vendit e zhvilloi në Kosovë. Fillimisht ministri Vengu takoi kryeministrin e Kosovës, z. Albin Kurti, ku gjatë takimit theksi u vendos tek forcimi i bashkëpunimit në rrafshin e Mbrojtjes, stabilitetin rajonal dhe ndërveprimin e domosdoshëm me aleatët për një konsolidim të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Ministri Vengu po ashtu zhvilloi edhe një takim me homologun e tij Ejup Maqendonci, ku vlerësoi pa masë bashkëpunimin e shkëlqyer dhe vëllazëror midis dy vendeve dhe theksoi se bashkëpunimi me Kosovën konsiderohet strategjik, stabilizues për rajonin dhe orientues për perspektivën euroatlantike.

Ministri Vengu rikonfirmoi se, Kosova vijon të jetë prioritet absolut i Shqipërisë dhe si rrjedhojë prioritet parësor i Ministrisë së Mbrojtjes, e cila ka qenë gjithmonë në krah dhe në mbështetje të zhvillimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës. Sa i takon anëtarësimit të Kosovës në organizmat ndërkombëtare, ministri Vengu siguroi se Shqipëria do të jetë një avokate e fortë e saj: “Viti 2024, rezulton të jetë një vit shumë impenjativ për Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë, pasi këtë vit kemi kryesimin e disa iniciativave rajonale dhe shumë aktivitete në kuadër të tyre do të drejtohen dhe organizohen nga ana jonë (A5). Unë siguroj kolegun Maqendonci, se kjo mundësi do shfrytëzohet maksimalisht jo vetëm për të qenë një avokate e fortë e Kosovës, por për të shtuar të gjitha përpjekjet për një



anëtarësim të plotë të saj në këto iniciativa.” Gjatë takimit u diskutua edhe për thellimin e bashkëpunimit në fushat e çminimit të brezit kufitar ndërmjet dy vendeve si dhe dhënien e asistencës së nevojshme për

konsolidimin e mëtejshëm të Qendrës Rajonale për Emergjencat Civile. Situata e sigurisë dhe mbrojtjes në rajonin e Ballkanit Perëndimor me fokus kryesor, situatën aktuale në Kosovë ishte një tjetër pikë e rëndësishme e takimit: “Vlerësojmë se dialogu Kosovë - Serbi, në koordinim me partnerët strategjikë të Kosovës, SHBA dhe BE duhet të ketë si rezultat përfundimtar një marrëveshje të detyrueshme ligjore, që mundëson njohjen e ndërsjellët mes dy vendeve, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtim të drejtë të minoriteteve, konform Kushtetutës së Kosovës”, - tha ministri Vengu, i cili vlerësoi z. Maqendonci për mikpritjen.





239 vajza e djem nisen në Kursin e Stërvitjes Individuale Bazë, për t'u bërë pjesë e FA-së, ministri Vengu: Shembull frymëzues për të gjithë

239 vajza e djem janë përzgjedhur për të zhvilluar Kursin e Stërvitjes Individuale Bazë, që është një hap i parë për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura. Në ceremoninë e përcjelljes, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu përgëzoi të rinjtë për zgjedhjet e kësaj rruge që kërkon sakrificë, duke thënë se janë një shembull frymëzues për të gjithë.

"239 djem dhe vajza, mes shumë pikëpyetjeve keni bërë hapin e madh drejt këtij sheshi, duke vendosur të ecni në një rrugë ndoshta më të vështirë por gjithashtu më të bukur dhe më përbushëse, si çdo rrugë që qëndron mes investimit në dije dhe investimit në vlerë. Me siguri ky rrugëtim i ri, do të sfidojë karakterin, forcën dhe intelektin tuaj. Por në këtë udhë, ju do të keni për krah, jo vetëm njëri - tjetrin, por edhe përkushtimin e të gjithë stafit akademik të kursit bazë, të





edhe 33 vajza; 25 kandidatë janë me arsim të lartë; 160 me arsim të mesëm dhe 54 kandidatë janë me arsim 9 - vjeçar. Të kualifikuarit kanë kaluar me sukses të gjitha testimet e zhvilluara: fizik, intelektual dhe testimin psikologjik. Gjithashtu kandidatët e kualifikuar plotësojnë edhe kushtin e sigurisë, verifikuar nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Policia Ushtarake. Pjesë e Forcave të Armatosura mund të bëhet çdo i ri nga moshë 18 - 27 vjeç që nuk ka probleme me ligjin dhe ka një figurë të pastër morale. Stërvitja Individuale Bazë (SIB), e cila konsiderohet si porta hyrëse për çdo të ri në Forcat e Armatosura dhe njëherësh edhe si shkolla e parë e edukimit ushtarak, nisi më 16 shtator dhe do të zhvillohet deri më 22 nëntor të këtij viti. Në përfundim të kësaj stërvitjeje intensive, rekrutët do të betohen për të shërbyer më pas në reparte të ndryshme të Forcave të Armatosura. Të gjithë të rinjtë që bëhen pjesë e FA-së, përfitojnë një trajtim dinjitoz financiar dhe mundësi mjaft të mira për karrierë.

cilët dua t'i falënderoj dhe t'i uroj këtu, pasi kanë detyrën e vështirë të dëshmojnë çdo ditë se Forcat e Armatosura janë një familje e madhe, ashtu si familja që ju ka rritur e sjellë këtu sot për të nderuar veten dhe vendin", - theksoi ministri Vengu.

"Ndoshta duke vendosur të jeni këtu sot, keni hequr dorë nga disa komoditete, por me këtë sakrificë vjen edhe ndjenja e krenarisë, jo ajo krenaria boshe dhe kryeneçe, por krenaria e detyrës së kryer, krenaria e përmirësimit të vetes dhe të shoqërisë, krenaria e shërbimit dhe e sfidës së tejkaluar si një skuadër e vetme, e pakrahasueshme me asnjë ndjesi tjetër", - theksoi ministri i Mbrojtjes.

Ministri Vengu, porositi të rinjtë të ruajnë me krenari simbolet kombëtare dhe të jenë shembull i respektit ndaj traditave tona.

Mes 239 kandidatëve të kualifikuar në përfundim të procesit të rekrutimeve për ushtarë/detarë, të drejtën për të vijuar kursin e kanë



Ministri Vengu inspekton punimet për ndërtimin e Kampusit të Akademisë së FA-së: Do t'i shërbejë rritjes së profesionalizmit të Forcave tona të Armatosura

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu inspektoi punimet për ndërtimin e Kampusit të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), një nga projektet më të rëndësishme të planifikuara nga Ministria e Mbrojtjes, që bazohet në modelin e akademisë prestigjioze amerikane "West Point".

I shoqëruar edhe nga komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, ministri Vengu u njoh me ecurinë e projektit, që është një tjetër investim që i shërben modernizimit të FA-së.

Sipas ministrit të Mbrojtjes, kontrata parashikon që deri në mars 2025, të përfundojë faza e parë e projektit, që përfshin godinën e re të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë si dhe mensën për studentët. Deri më tani janë realizuar 50% e punimeve. Ministri Vengu tha se: "... më pas do të vijohet me financimin e fazës së dytë, për të përballuar kapacitetet në rritje, në mënyrë që sezonin e ardhshëm kampusi të jetë në gjendje pune. Synimi është që kjo të jetë një akademi autonome, sipas modelit të 'West Point-it'".

Këtë vit, sipas gjeneral brigade Bardhyl



Nuredinaj, parashikohet hapja e dy programeve të reja në nivelin master, "Inteligjencë artificiale" dhe "Marrëdhënie Ndërkombëtare".

Kampusi i ri i Akademisë së Forcave të Armatosura po ndërtohet në një sipërfaqe 9,1 hektarë. Në projekt, veç godinave të akademisë janë edhe ndërtimi i godinave

akomoduese për studentët, terrenet sportive, kinoklub, qendër shëndetësore, palestër, poligon qitje, etj. Në bashkëpunim me SHBA-të, në këto mjedise do të jetë edhe Qendra e Simulimit, e cila do të sigurojë trajnimin e forcave në një mjedis të përshtatshëm dhe me kosto më të ulët, krahasuar më stërvitjet në terren.



Ndryshimet në buxhetin e 2024, ministri Vengu: Mundësojnë realizimin e disa investimeve të rëndësishme në Mbrojtje

Në seancën parlamentare për aktin normativ, për disa ndryshime e shtesa në ligjin “Për buxhetin e vitit 2024”, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu deklaroi se ky akt i jep një mbështetje të madhe edhe Buxhetit të Mbrojtjes, duke krijuar kushtet që një numër i konsiderueshëm prioritetesh dhe investimesh të jetësohen.

Ministri Vengu vuri theksin në vendimet transformuese të qeverisë shqiptare në favor të personelit civil dhe ushtarak, përmes rritjes së pagave nga 7% deri në 22%. Ringritja e Industrisë së Mbrojtjes, rritja e investimeve për modernizimin dhe gatishmërinë operacionale të Forcave të Armatosura janë disa nga pikat kryesore të planifikimit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky akt normativ sjell disa risi në Buxhetin e Mbrojtjes, duke krijuar kushtet që një numër i konsiderueshëm prioritetesh dhe investimesh të jetësohen.

Përtej faktit që Buxheti për Sigurinë dhe Mbrojtjen vjen në rritje (vlera totale 48,7 miliardë lekë, duke u shtuar në vlerën 355,5 milionë lekë, apo e shprehur në përqindje 0.74%), në përputhje me angazhimin tonë përkundrejt Aleancës, më lejoni të sqaroj shkurtimeisht disa risi në fushën e Mbrojtjes:

Shtylla e parë ka të bëjë me rritjen e pagave të personelit civil dhe ushtarak, nga 7% e përshkallëzuar deri në 22%, duke i dhënë përparësi gradave të ulëta. U tha këtu se, nuk kemi risi për pagat. Jo vetëm që kemi rritje pagash, por kemi gjithashtu një politikë rishpërndarje të të ardhurave publike drejt atyre që kanë më shumë nevojë.

Në këtë mënyrë jo vetëm linjëzojmë pagat e Forcave të Armatosura me rritjen që mori së fundmi trupa e Policisë së Shtetit, por sigurojmë gjithashtu që personeli i specializuar ushtarak, pilotët, inxhinierët apo operatorët e dronëve ushtarakë, të kenë një shpërblim sa më dinjitoz.

Ky është një hap domethënës drejt arritjes së objektivit të qeverisë shqiptare për një trupë ushtarake të mirëpajisur, të mirëpërgatitur dhe të mirëstërvitur.

Shtylla e dytë ka të bëjë me ringritjen e Industrisë së Mbrojtjes, ku Akti Normativ parashikon një investim domethënës për krijimin e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes dhe themelimin e shoqërisë shtetërore KAYO. Këto dy ente të reja përbëjnë instrumentin kryesor të rijetësimit të Industrisë Ushtarake. Përse është e rëndësishme kjo? Për tre arsye:

- E para, për efekt se tashmë kemi një kuadër rregullator të qartë, të linjëzuar me standardet e NATO-s, duke përfshirë disa masa nxitëse për investorët e huaj në këtë fushë, duke synuar krijimin e kompanive të përbashkëta, nga prodhimi i të cilave shteti shqiptar mund të gjenerojë më shumë të ardhura publike, sepse kjo qeveri e di më mirë se askush tjetër që nevojat reale për më shumë drejtësi sociale, më shumë barazi në paga dhe më shumë investime në shërbime publike, nuk mund të adresohen me rritje taksash, por vetëm me rritjen e qëndrueshme të të ardhurave dhe të mirave publike;

- Pikërisht dhe kjo është pika e dytë, vizioni që jetëson ky akt normativ është që: sektori i mbrojtjes mos të jetë vetëm një shpenzim, mos të jetë vetëm një kosto për taksapaguesit, por të



mund të gjenerojë gjithashtu të ardhura dhe të mira publike në funksion të rritjes së pagave, rritjes së pensioneve dhe rritjes së investimeve;

- Dhe, arsyeja e tretë, përse kjo industri është e rëndësishme, ka të bëjë me efektet zinxhirë, që sjell në ekonominë në tërësi, sidomos në industritë civile pasi nuk ka industri ushtarake të suksesshme pa një industri civile dinamike.

Në këtë kontekst, vlen të theksohet se akti normativ mundëson gjithashtu likuidimin 100% të të gjitha detyrimeve të Ndërmarrjeve Shtetërore Ushtarake të Poliçanit, Gramshit dhe Mjekësit, duke përfshirë këtu detyrimet ndaj personelit, ish-punonjëseve, bashkive dhe ente të tjera, duke adresuar një problematikë disaveqare, që sjell dhe një frymëmarrje financiare për pushtetin vendor, përkatësisht: Kombinati Mekanik Poliçan 213.000.000 lekë; Uzina e Lëndëve Plasëse Mjekës 50.000.000 lekë; Uzina Mekanike Gramsh 27.000.000 lekë.

Në këtë mënyrë, këto tre objekte shkarkohen nga e gjithë barra e pengesës së të shkuarës dhe u jepet mundësia për të parë nga e ardhmja. Shlyerja e detyrimeve të tre uzinave ushtarake hap një kapitull të ri për bashkitë ku ndodhen, të cilat përfitojnë të ardhura që koha i kishte “ngrirë” prej rreth 15 vitesh.

Shtylla e tretë, ka të bëjë me rritjen e investimeve për modernizim dhe rritjen e gatishmërisë operacionale të strukturave të FARSH-së dhe vijimin e kontributit në operacionet dhe misionet jashtë vendit, të cilat janë shtuar së fundmi edhe në kuadër të misioneve ushtarake detare. Shtylla e katërt, ka të bëjë me përballimin e shpenzimeve për qytetarët e dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore në tërësinë e vendit, në Kamëz, Vorë, Kurbin, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Mat, Klos, Dibër, Kolonjë, Pogradec, Kukës dhe Poliçan. Shtylla e pestë është gjithashtu shumë e rëndësishme, pasi ka të bëjë me përballimin e shpenzimeve të shtuara për medikamente mjekësore, materiale ortopedike, neurologjike, shërbime spitalore në Spitalin e Traumës, ku, siç e dini, kemi gjithashtu mbulimin e shërbimeve shëndetësore për personelin ushtarak dhe synojmë të përmirësojmë shërbimet për një numër të shtuar trupash të specializuara. Ja pra, pesë shembuj, ku akti normativ siguron një rritje të investimeve dhe një rishpërndarje të të ardhurave, dy detyra parësore të një buxheti më të drejtë.

Deklarata e Shefave të Mbrojtjes së Iniciativës SHBA-Karta e Adriatikut: Qëllim kryesor, integrimi i të gjitha vendeve aspirante të Evropës Juglindore në NATO

Shefat e Mbrojtjes të Iniciativës SHBA-Karta e Adriatikut (A5) në Konferencën 27-të, miratuan Deklaratën e Përbashkët, ku riafirmohet angazhimi për të qëndruar së bashku kundër luftës së paligjshme, të pajustificueshme dhe të paprovokuar të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, e cila ka shkatërruar paqen dhe stabilitetin në zonën euroatlantike dhe ka dëmtuar rëndë sigurinë në rajonin tonë dhe globalisht.

“Ne dënojmë, në termat më të fortë, shkeljen e dukshme të Kartës së Kombeve të Bashkuara nga Rusia dhe ndikimin e luftës së Rusisë në pjesën tjetër të botës. Ne përshëndesim popullin ukrainas për rezistencën e tij të guximshme dhe shprehim simpatinë dhe ngushëllimet tona për humbjen dhe vuajtjen e tyre”, - thuhet në deklaratën e përbashkët të Përfaqësuesve të lartë ushtarakë të Iniciativës SHBA-Karta e Adriatikut, ku bëjnë pjesë: Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, me pjesëmarrjen e komandantit të Komandës Evropiane të SHBA-së, njëherësh komandant i Forcave Amerikane në Europë, gjeneral Christopher G. Cavoli.

Në solidaritet të plotë me popullin e Ukrainës, vendet riafirmojnë synimin për të vijuar mbështetjen në këtë luftë. “Ne jemi të përkushtuar për të arritur një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme që mbështet parimet e Kartës së OKB-së, në veçanti sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë. Mbështetja kolektive për Ukrainën konfirmon mirëkuptimin tonë të ndërsjellë, se bashkëpunimi me aleatët dhe partnerët është jetik për aftësinë tonë kolektive, për t’iu përgjigjur sfidave aktuale dhe të ardhshme”, - thuhet në deklaratën e përbashkët.

Sipas deklaratës së përbashkët, “Ballkani Perëndimor mbetet subjekt i ndikimeve malinje, duke përfshirë dezinformimin,



kërcënimet hibride dhe kibernetike, të paraqitura nga aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë. Në këtë drejtim, vlerat demokratike, sundimi i ligjit, reformat e brendshme, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe gjithëpërfshirja, janë jetike për bashkëpunimin rajonal dhe integrimin euroatlantik dhe ne jemi të përkushtuar të vazhdojmë të përparojmë drejt këtij qëllimi. Ne ripohojmë përkushtimin tonë ndaj parimeve të SHBA-Karta e Adriatikut, duke pranuar se integrimi në NATO i të gjitha vendeve aspirante në Evropën Juglindore është një nga qëllimet kryesore të Iniciativës. Në këtë kuptim, ne mbështesim politikën e dyerve të hapura të NATO-s dhe mbështesim aspiratat e vendeve aspirante të mbetura nga Evropa Juglindore drejt anëtarësimit në NATO, duke respektuar nevojën për dialog të brendshëm”, - theksohet në deklaratë.





Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji mbledhi në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm, në shenjë mirënjohje dhe falënderimi për përkushtimin dhe punën e palodhur, kolonelët, të cilët mbyllën me nder qëndrimin e tyre në këtë gradë, sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë. Gjeneralmajor Kingji në ceremoninë e organizuar me këtë rast për kolonel Agim Shahun, kolonel Arben Dhulin, kolonel Ardian Lulajn, kolonel Dilaver Hoxhën, kolo-

nel Isuf Hamatin, kolonel Roland Berzanin dhe kapitenin e rangut I Ëngjell Sinanaj, shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e tij dhe gjithë komunitetit të Forcave të Armatosura, për profesionalizmin, sakrificën dhe përkushtimin në këtë rrugëtim të gjatë nën uniformë, duke e përmbushur me sukses misionin ndaj detyrës dhe Atdheut. Më tej ai u uroi shëndet, mbarësi dhe suksese të mëtejshme në jetën civile. “Faleminderit për shërbimin tuaj!”, - mbylli fjalën e tij gjeneralmajor Kingji.





Ministri Vengu: Solidariteti evropian dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, shembull i shkëlqyer i misionit mes vendeve

Pas përpjekjesh intensive prej disa ditësh, misioni i shuarjes së zjarreve në Shqipëri ka përfunduar me sukses. Dy avionët ushtarakë rumunë, të tipit C-27J “Spartan” dhe C-130 “Hercules”, të cilët u angazhuan në këtë mision në kuadër të Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile, kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në luftën kundër flakëve që kishin përfshirë disa nga zonat më të rrezikuara të vendit tonë. Gjatë këtyre ditëve, avionët rumunë kanë kryer dhjetëra fluturime mbi disa nga vatrat më të nxehta të zjarrit, duke ndihmuar në izolimin dhe fikjen e flakëve në parqet kombëtare, zonat e banuara, si dhe në terrenet më të vështira dhe të paarrishme. Përpjekjet e tyre kanë qenë vendimtare për të ndaluar dëmet e mëtejshme. Gjatë gjithë misionit në Shqipëri, avioni rumun kreu gjithsej 23

hedhje, duke përdorur një total prej 141.000 litrash ujë në zonat e liqenit të Prespës, malit të Tomorit, në fshatin Nënshetaj, në Orosh të bashkisë Mirditë, në Fushë - Bulqizë dhe në fshatin Arrën në Bashkinë e Kukësit.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, shprehu mirënjohje të thellë për stafin rumun të angazhuar në këtë operacion të ndërlikuar, duke vlerësuar profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre gjatë gjithë misionit. Ministri Vengu ka falënderuar gjithashtu Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile për mbështetjen e pakursyer dhe bashkëpunimin e ngushtë në koordinimin e këtyre përpjekjeve.

“Ky mision ishte një shembull i shkëlqyer i solidaritetit evropian dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në momente kritike. Ndihma e dhënë nga Rumania dhe Mekanizmi Evropian i Mbrojtjes Civile ka qenë e paçmueshme për menaxhimin e situatës emergjente në vendin tonë”, - tha ministri Vengu.

Një falënderim i veçantë i është drejtuar edhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e cila ka luajtur një rol kyç në koordinimin dhe mbështetjen e operacionit në terren, duke bërë të mundur që përpjekjet ndërkombëtare dhe ato vendase të bashkërendohen në mënyrë efikase.

I pranishëm në këtë aktivitet, ambasadori rumun në Shqipëri, Octavian Șerban, falënderoi Bashkimin Evropian për vendimin që morën për të ndërhyrë, si dhe trupat shqiptare për punën e tyre në luftën me zjarret dhe bashkëpunimin shumë të mirë. Avionët rumunë, që prej datës 14 gusht iu bashkuan përpjekjeve të Forcave të Armatosura dhe autoriteteve të tjera lokale për përballimin e situatës së krijuar nga zjarret.



Ministri Vengu: Prioriteti ynë, modernizimi i pajisjeve në funksion të misioneve dhe përparësive kombëtare të FA-së

Regjimenti i Këmbëtorisë së Jugut, pjesë e Forcës Tokësore të Forcave të Armatosura, është një nga strukturat që ka një kontribut të rëndësishëm në operacionet e emergjencave civile gjatë këtij viti.

Vetëm gjatë muajit të fundit, 1057 efektivë dhe 85 mjete kanë marrë pjesë në 35 operacione për shuarjen e zjarreve në rajonet e Llogorasë, Vlorës, Pashalimanit, Himarës, Delvinës, Dropullit, Gjirokastrës, Sarandës, Tepelenës, Beratit, Maliqit, Korçës dhe i fundit i kryer dje, në Konispol.

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu ishte në Poshnje, ku u takua me efektivë të këtij regjimenti, të cilët i falënderoi për punën e pal-



odhur në ndihmë të komunitetit. Gjatë vizitës ministri i Mbrojtjes theksoi vijimin e përpjekjeve për modernizimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura, si një element tejet i rëndësishëm, jo vetëm për përmbushjen e zotimeve në kuadër të sigurisë kolektive të NATO-s, por edhe në funksion të misioneve dhe përparësive kombëtare të Forcave të Armatosura.

Gjatë kësaj vizite në Poshnje, ministri i Mbrojtjes drekoi me efektivët e Regjimentit të Këmbëtorisë së Jugut, të cilët ndanë edhe momente nga përditshmëria e tyre.

Rekord aplikimesh për Akademinë e Forcave të Armatosura, 1114 maturantë në garë për 70 kuota studimi

Interes i lartë i të rinjve për të studiuar në Akademinë e Forcave të Armatosura. Këtë vit është shënuar numër rekord aplikimesh për programet që ofron kjo akademi.

1114 të rinj e të reja kanë aplikuar për të fituar një të drejtë studimi nga 70 kuota të planifikuara për ciklin e parë Bachelor, për këtë vit akademik. Ky është numri më i lartë i aplikimeve krahasuar me tre vitet e mëparshme.

Akademia e Forcave të Armatosura ofron 3 programe në ciklin Bachelor: Teknologji Informacioni, Marrëdhënie ndërkombëtare dhe Shkenca Komunikimi në fushën e mbrojtjes.

Për të gjithë fituesit, përveç një karriere të sigurt, përsosjes së aftësive në një gamë të gjerë profesioneve ofrohen programe akademike prestigjioze dhe unike në Shqipëri, pagë mujore dinjitoze, akomodim dhe trajtim ushqimor gjatë gjithë periudhës së studimit.





Zhvillohet Takimi “NATO Resilience Expert Consultation Meeting”

Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua takimi konsultues me ekspertë të NATO-s mbi Qëndrueshmërinë.

Të pranishëm në këta takim ishin përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, AKMC, Ministria e Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit, Ministri e Bujqësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe institucione të tjera.

Gjatë këtij takimi u diskutua me ekspertët e NATO-s, mbi progresin aktual dhe vështirësitë në fushën e Qëndrueshmërisë si një nga elementë kryesorë të planifikimit të mbrojtjes në NATO. Ekspertët e NA-

TO-s theksuan rëndësinë gjithnjë e në rritje që qëndrueshmëria dhe aspekti civil po merr në kryerjen e operacioneve në rast konflikti apo krize.

Ekspertët nënvizuan fushën e gjerë që qëndrueshmëria mbulon si dhe domosdoshmërinë e koordinimit midis institucioneve, me qëllim krijimin e sinergjisë në nivel kombëtar për përmbushjen me sukses të shtatë kërkesave bazë të qëndrueshmërisë. Gjithashtu, ekspertët ofruan këshilla dhe praktika nga vendet e tyre për t'u marrë në konsideratë gjatë përmbushjes së kërkesave të Qëndrueshmërisë.

Në mbyllje ekspertët shprehën vlerësimin e tyre për organizimin e këtij event, i cili është tregues i angazhimit dhe rëndësisë që vendi ynë i jep përmbushjes së detyrimeve në fushën e Qëndrueshmërisë.

Ministri Vengu inspekton bazën ajrore të Kuçovës

Dronët “Bayraktar” do të kalojnë së shpejti në funksion monitorues 24 orë në shtatë ditë të javës, si një element mbështetës i rëndësishëm krah autoriteteve vendore në betejën kundër zjarreve.

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, shoqëruar edhe nga komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dima inspektuan bazën ajrore të Kuçovës dhe njësinë e dronëve, e cila tashmë është plotësuar me personel të kualifikuar.

Kjo njësi tashmë ka rritur gatishmërinë edhe pas trajnimit të pilotëve për misionet në kushtet e errësirës. Dronët UAV janë përdorur prej disa ditësh në operacionet e përbashkëta me forcat e tjera në luftën kundër zjarreve, për një evidentim më të saktë të vatrave. Rezultatet e imazheve të dronëve “Bayraktar” do të jenë kyçe për të mbështetur bashkitë edhe në procesin e evidentimit të dëmeve të krijuara nga zjarret.



Rijetësimi i industrisë ushtarake, zhvillim social-ekonomik, siguri kombëtare

Akti normativ i Këshillit të Ministrave injekton 440 milionë lekë në fazën e parë të projektit për rijetësimin e industrisë ushtarake. Konkretisht, janë alokuar 290 milionë lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të uzinave të industrisë ushtarake ndaj punonjësve, ish-punonjësve, bashkive dhe enteve të tjera. 150 milionë lekë janë dedikuar për themelimin e shoqërisë tregtare “KAYO Sh.a”, e cila do të udhëheqë procesin e modernizimit të industrisë ushtarake dhe rijetësimin e kapaciteteve prodhuese të

Mjekësit, Gramshit dhe Poliçanit.

Rijetësimi i industrisë ushtarake është një mundësi e re për zhvillimin ekonomik dhe social të zonave të përfshira në këto projekte, por edhe shumë i rëndësishëm për integrimin e vendit në hallkat e prodhimit dhe logjistikës ndërkombëtare.

Projekti i qeverisë shqiptare për modernizimin e sektorit, kontribuon gjithashtu në forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare në përputhje me objektivat e Aleancës.





U zhvillua Konferenca Planëzuese Kryesore “Defender Europe-25”

Forcat e Armatosura në bashkëpunim me Ushtrinë Amerikane për Europën dhe Afrikën (USEUR-AF) zhvilluan Konferencën Planëzuese Kryesore të stërvitjes “Defender Europe-25”, me pjesëmarrjen e 600 përfaqësuesve nga vendet aleate dhe partnere të NATO-s. Në vijimësi të stërvitjeve DEFENDER, përgjatë 2025, Shqipëria do të jetë pjesë e stërvitjes më të madhe të drejtuar nga USEUR-AF, si një mundësi e shkëlqyer për t'u trajnuar dhe vepruar së bashku me vendet aleate dhe partnere, me qëllim forcimin e gatishmërisë operationale, sigurisë dhe ruajtjes së paqes.



Ministria e Mbrojtjes: Mbështetje maksimale ndaj familjeve të efektivëve të Forcave të Armatosura, përkrah tyre në çdo hap, si një familje e madhe

Me fillimin e vitit të ri shkollor, Ministria e Mbrojtjes u gjend në familjet e Dëshmorëve të Atdheut, ku së bashku me urimin për një ecuri të mbarë në rrugën e dijes, për këta fëmijë, prindërit e të cilëve ranë në krye të detyrës për të garantuar më shumë siguri për jetën e gjithëve ne, bashkë me dhuratat simbolike për fëmijët e Dëshmorëve të Atdheut, Ministria e Mbrojtjes shprehu edhe angazhimin për të vijuar mbështetjen ndaj familjeve të efektivëve të Forcave të Armatosura, për të qenë në krah të tyre në çdo hap si një familje e madhe.



Edhe fëmijët e efektivëve të FA-së përfituan nga paketa e teksteve shkollore falas, mbështetje e qeverisë shqiptare për 238 mijë nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe mbi 12 mijë nxënës nga 16 kategori të grupeve më në nevojë në gjimnaze.

Përfundoi me sukses trajnimi për Operacionet Psikologjike “PSYOPS”

Në Garnizonin e Regjimentit të Operacioneve Speciale u zhvillua ceremonia përmbyllëse, e cila shënoi përfundimin e trajnimit pesëditor për Operacione Psikologjike (PSYOPS), të organizuar nga njësi PSYOPS amerikane rezidente në Mal të Zi. Kjo njësi trajnoi personelin e përzgjedhur të ROS-it me aftësitë kryesore për zhvillimin e operacioneve psikologjike.

Në trajnimin e drejtuar nga ekspertët e fushës të PSYOPS, morën pjesë 17 efektivë, të cilët e përfunduan trajnimin për zbatimin e parimeve bazë të PSYOPS, shtatë hapat e planëzimit të PSYOPS, si dhe rolin dhe rëndësinë tyre në mbështetje të Forcave të Operacioneve Speciale.



Në fjalën përmbyllëse zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Altin Kurti, u shpreh mbi rëndësinë kritike të trajnimit të operatorëve të Forcave të Operacioneve Speciale, gjithashtu



gjeneral Kurti theksoi se aftësitë e përfituara nga ky trajnim janë thelbësore për zbatimin me efikasitet të operacioneve psikologjike.

Nënkolonel Ajet Jata, komandant i Regjimentit të Operacioneve Speciale theksoi se: Hartimi dhe zbatimi i duhur i PSYOPS para dhe gjatë një fushate ushtarake ndikon në perceptimin, sjelljen e ushtarakëve dhe faktorëve kyç të cilët kanë ndikim dhe vendimmarrje, si dhe rrit ndjeshëm përfitimet operacionale, të cilat janë thelbësore për formimin dhe mbështetjen e misioneve tona. Eksperienca e fituar nga ky trajnim do të rritë ndjeshëm efektivitetin tonë operacional”.

Kjo nismë dëshmon angazhimin serioz të aleateve tanë strategjike për të përmirësuar vazhdimisht aftësitë e personelit në mbështetje të operacioneve ushtarake.



Kontingjenti shqiptar, që sapo mori detyrën në misionin e KFOR-it në Kosovë, u angazhua menjëherë në stërvitjen për menaxhimin e trazirave dhe turmave të dhunshme.

Trupat shqiptare, përkrah kolegëve nga vendet aleate, janë në gatishmëri 24h për ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe lirisë së lëvizjes në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, për të gjithë qytetarët.



Detashmenti CIMIC i Forcës Tokësore, pjesë e stërvitjes vjetore “Saber Junction 2024”

Një ekip efektivësh nga Detashmenti CIMIC i Forcës Tokësore, mori pjesë në stërvitjen vjetore “Saber Junction 2024”, e cila u zhvillua në Grafenwöhr dhe Hohenfels të Gjermanisë. Në këtë stërvitje, të drejtuar nga Komanda e Armatës së 7-të e SHBA-së marrin pjesë ekepe të vendeve aleate dhe partnere të NATO-s. Qëllimi i pjesëmarrjes së Detashmentit CIMIC në “Saber Junction-24” është rritja e aftësive profesionale nëpërmjet bashkëpunimit dhe ndërveprimit me aktorët jo ushtarakë dhe aleatët në një mjedis operacional ndërkombëtar,



nëpërmjet aplikimit praktik të parimeve dhe taktikave, teknikave dhe procedurave të bashkëpunimit civil-ushtarak.

“Saber Junction – 24” është një stërvitje vjetore e ushtrisë amerikane me aleatët dhe partnerët e NATO-s, ku këtë vit janë përfshirë 4500 pjesëmarrës nga 11 vende të ndryshme të Aleancës.

Forca Tokësore nis kontingjentin KFOR-6 në kuadër të misionit KFOR, Pejë, Kosovë

Në mjediset e Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përcjelljes së trupave nga Batalioni i Këmbëorisë së Lehtë (bkl), të cilët do të shërbejnë në KFOR, si pjesë e misionit të NATO-s, në Pejë, Kosovë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Altin Kurti, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Ilirjan Dauti, shefa nga shtabi i FT-së dhe i bkl-së etj.

Fjala e hapjes u mbajt nga komandanti i bkl-së, kolonel Xhevair Kërzhalliu, i cili ndër të tjera vuri theksin tek eksperiencia e krijuar ndër vite nga efektivët e batalionit në operacione paqeruajtëse. Është kjo eksperiencë, por edhe trajnimi i vijueshëm që kryhet në këtë repart, ato që e mbushin me besim se ky mision do të jetë i suksesshëm, ashtu si edhe misionet paraardhëse.



Duke marrë fjalën në ceremoni, komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Xhebexhia, pasi i uroi ushtarakëve pjesëmarrës suksese në mision theksoi: “... Ju jeni ambasadorët e paqes dhe si të tillë duhet të kryeni të gjitha detyrat me përkushtim dhe profesionalizëm sa më të lartë, duke treguar vlerat tuaja dhe të Forcës që përfaqësoni...”. Në mbyllje të fjalës së tij, gjeneralmajor Xhebexhia i siguroi pjesëmarrësit e kontingjentit “KFOR-6” me mision në Kosovë, se Forca Tokësore, por edhe Shtabi i Përgjithshëm e Ministria e Mbrojtjes do të jenë gjithmonë në kontakt me ta dhe pranë tyre, për çdo problem apo nevojë që do të kenë.

Të pranishmit, i përshëndeti në emër të kontingjentit, komandanti i kontingjentit kapiten Saimir Sheme, i cili pasi falënderoi eprorët për besimin e treguar i siguroi ata se misionin që ju është ngarkuar, do ta kryejnë me devotshmëri dhe profesionalizëm.

Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Xhebexhia pret delegacionin e Gardës Kombëtare të FSK-së

Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet FARSH-së dhe FSK-së, delegacioni i Gardës Kombëtare të FSK-së, zhvilloi sot një vizitë kortezie në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore. Delegacioni i kryesuar nga komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri u prit në takim nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia.

Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia pasi u uroi mirëseardhjen delegacionit Kosovar u shpreh në domosdoshmërinë e rritjes së bashkëpunimit mes Forcës Tokësore dhe Gardës Kombëtare të FSK-së, si në fushën e arsimit ashtu edhe në zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta.

Në fjalën e tij, komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri, pasi falënderoi gjeneralmajor Ilir Xhebexhian për mikpritjen, theksoi domosdoshmërinë për rritjen e bashkëpunimit dhe trajnimeve dypalëshe për t'u përballur me sfidat dhe situatat të cilat vijnë në rritje.



Të pranishmit në takim ndër të tjera diskutuan në lidhje me realizimin e vizitave e takimeve të përbashkëta, për njohjen më nga afër me strukturat dhe aktivitetet e përditshme që ato realizojnë. Në përfundim të takimit ndërmjet komandantit të Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri dhe komandantit të Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia u shkëmbyen dhuratat simbolike dhe u realizua foto e përbashkët.

Trupat e Batalionit Special të ROS marrin pjesë në stërvitjen “Valor Shield 24”

Efektivë të Batalionit Special të ROS, në Forcën Tokësore, zhvillojnë në Kosovë stërvitjen “Valor Shield 24”, së bashku me efektivë të FSK-së dhe efektivëve amerikanë.

Kjo stërvitje ka si qëllim testimin e operacioneve speciale në nivel task grupi si dhe rritjen e bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë për përbushjen e misionit si dhe konsiston në rritjen e ndërveprueshmërisë së forcave speciale të vendeve partnere dhe një-sive të ndryshme në operacionet e përbashkëta.

Në këtë stërvitje forcat pjesëmarrëse do të veprojnë sipas skenarëve në drejtim të operacioneve të zbulimit taktik, operacioneve psikologjike, analizimin e të dhënave nga zbulimi, përdorimin e doneve



gjatë fazave të zhvillimit të operacioneve të goditjes objekteve si dhe parandalimin e veprimeve të grupeve taktike sulmuese.



Në këtë stërvitje do të marrin pjesë dhe efektivë të Forcave të Ndërhjryes së Shpejtë të Policisë së Kosovës.

Dronët UAV realizuan trajnimin e fluturimit natën



Për herë të parë, Detashmenti i Avionëve pa Pilot (UAV) zhvilloi fluturime natën, në vijim të arritjeve dhe përvetësimit të Sistemit UAV.

Trajnimi i fluturimit të natës është një komponent kritik i stërvitjes së pilotëve. Ai aftëson pilotët dhe u jep njohuritë e nevojshme për të operuar avionët në mënyrë të sigurt në kushte me dritë të ulët (natën).

Fluturimet natën sigurojnë që personeli UAV të jetë i aftë në navigimin dhe kontrollin e UAV-ve në errësirë. Kjo përfshin përdorimin e pajisjeve të shikimit të natës dhe sistemeve të imazhit termik. Pilotët dhe operatorët e ngarkesave u trajnuan për të interpretuar imazhet termike, të cilat janë thelbësore.



Helikopteri AS532AL “Cougar” ulet në Rinas, i gatshëm për operatione

Helikopteri tip AS532AL “Cougar” me numër FA634 është ulur në Aeroportin e Rinasit dhe është në gatishmëri operationale. Helikopteri kreu punimet e thella të mirëmbajtjes pranë kompanisë RUAG në Zvicër, falë bashkëpunimit me NSPA (Agjencinë e Prokurimeve të NATO-s), me të cilën jemi në rrugën e duhur për të rikthyer progresivisht gatishmërinë teknike të të gjithë Flotës sonë Ajrore.

Fluturimi i kontrollit teknik dhe i marrjes në dorëzim (Acceptance Test Flight) është kryer me personelin pilot dhe teknik të Forcës Ajrore shqiptare në bord.



Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dima priti në takim atasheun ushtarak të SHBA-ve në Shqipëri, kolonel Eric Cote

Kolonel Eric Cote dhe komandanti i ekipit trajnues SATMO, u njohën nga afër me zhvillimet dhe planet e modernizimit të Forcës Ajrore, ku në fokus të veçantë ishte Baza Ajrore e Kuçovës, implementimi i fazës së parë të projektit GAG, si dhe vazhdimi i bashkëpunimit me “Lockheed Martin” për mbajtjen në gatishmëri të SIVHA.

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Dima i falënderoi për kontributin e dhënë për riparimin dhe mbajtjen në gatishmëri të helikopterëve UH60 “Blackhawk”. Në përfundim të takimit, atasheu amerikan konfirmoi vazhdimin e mbështetjes për Forcën Ajrore, si në drejtim të projekteve të zhvillimit të mod-



ernizimit ashtu edhe për mbështetjen në trajnimin e pilotëve dhe teknikëve gjatë viteve të ardhshme.

Forca Ajrore realizon me sukses misionin për shuarjen e zjarreve

Deri në momentin e normalizimit të situatës së zjarreve, në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile dhe autoriteteve vendore, do të vijojë mbështetja nga mjetet ajrore rumune tip C-27J, “Spartan” dhe C-130 “Hercules” në operacionet për shuarjen e zjarreve, të cilët do të operojnë nëpërmjet Bazës Ajrore Kuçovë drejt rajoneve të prekura nga emergjencat e rënies së zjarreve.

Janë angazhuar në total 30 persona, me detyrë pilotë, teknikë helikopteri, kontrollorë, personel i shërbimeve mbështetëse. Qëllimi kryesor ka qenë izolimi i plotë i vatrave të zjarrit në zonat Gjirokastrë, Korçë, Vau Dejës, Fushë-Krujë, Bulqizë.

Pavarësisht erërave të forta, të cilat në disa zona, kanë vështirësuar aksionin për shuarjen e zjarreve, gatishmëria, angazhimi dhe bashkëpunimi i personelit të Forcës Ajrore nuk ka munguar, duke realizuar 10 misione.



Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit midis FARSH/FAj dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, TIA

Në mjediset e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura/ FAj dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

Kjo marrëveshje u nënshkrua nga Administratorët e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës dhe Komandanti i Forcave Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo.

Marrëveshja e përbashkët do të ndihmojë në lehtësimin e hyrje/daljeve jo vetëm të ushtarakëve shqiptarë, por edhe forcave ushtarake të NATO-s dhe partnerëve që vijnë në Shqipëri për trajnime, stërvitje apo operacione të ndryshme të përbashkëta.

Ky bashkëpunim i rëndësishëm synon forcimin e marrëdhënieve ndërinstitutionale dhe rritjen e koordinimit në fushën e sigurisë, duke kontribuar në përmirësimin e standardeve tona të sigurisë, si dhe shërbimit në aeroport.



Vizitë kortezie e Atasheut Ushtarak Francez i akredituar në vendin tonë, kolonel Valery Sens, në Komandën e FAj

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, priti në një takim kortezie atasheun ushtarak Francez i akredituar në vendin tonë, Kolonel Valery Sens.

Gjeneral Dimo, pasi e uroi kolonelin Sens për detyrën e re të atasheut ushtarak të Francës, e njohu atë me prioritetet dhe ecurinë e operacionalitetit të mjeteve ajrore. Gjatë takimit u disku-



tua mbi rritjen e bashkëpunimit me kompaninë AIRBUS, kryesisht në drejtim të trajnimit të pilotëve dhe personelit teknik të helikopterëve "Cougar", në funksion të rritjes së gatishmërisë operacionale të tyre. Në përfundim të takimit, gjeneral Dimo, falënderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Ajrore, duke e siguruar se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë organizon ceremoninë e daljes në lirim të ushtarakëve

Në ambientet e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë u zhvillua ceremonia e daljes në lirim të kolonel Ardian Lulaj dhe kolonel Isuf Hamati. Në këtë aktivitet të veçantë morën pjesë Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë gjeneral brigade Ylli Pulaj, staf akademik, mbështetës dhe kolegë.

Ceremonia u hap me fjalën e komandantit të Kolegjit, gjeneral Pulaj, i cili ndër të tjera citoi: “Në të vërtetë nuk është e lehtë që të përshëndetemi sot me dy kolonelët, mirëpo, jashtë kësaj ndjesie njerëzore, një përshëndetje institucionalisht është në nderin dhe detyrimin e personelit ushtarak dhe civil të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, për ju Kolonel Ardian Lulaj që shërbyet si pedagog në Departamentin e Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara dhe ju Kolonel Isuf Hamati, duke shërbyer si Shef i Departamentit të Operacioneve Ushtarake, ndaj më lejoni që të përfitoj nga kjo ceremoni për t’ju uruar jetë të gjatë,

shëndet e lumturi familjarisht”.

Më pas, përshëndetën kolonel Ardian Lulaj dhe kolonel Isuf Hamati, të cilët ndanë disa nga momentet kulminante të karrierës së tyre në detyra brenda dhe jashtë vendit, duke u shprehur se: “Dalja në lirim është kohë emocionale, lënia e karrierës pas dekadash, ditësh të gjata dhe punë të palodhur sjell ndjenja gëzimi dhe lehtësimi, së bashku me pak nostalgji dhe ndoshta trishtim për t’i thënë lamtumirë kolegëve dhe miqve të dashur. Tani do kemi më shumë kohë për familjen ndoshta si kompensim për ditët dhe netët e munguara, por dhe si kohë për të treguar më shumë mbi përvojën jetësore të jetuar me frymën e bashkëpunimit, organizimit dhe kulturës ushtarake, e cila tashmë reflektohet dhe në përditshmërinë si civil”.

Aktiviteti përfundoi me shpërndarjen e certifikatave të mirënjohjes dhe fotografi të përbashkët.

Firmoset marrëveshja për digjitalizimin e procesit mësimor mes AFA-së dhe RASH-së

Digjitalizimi i procesit mësimor në Akademinë e Forcave të Armatosura ishte në fokusin e takimit të gjeneralit dhe rektorit të AFA-së, Bardhyl Nuredinaj me dr. Arjan Xhelajn, drejtor i RASH-së.

Procesi u finalizua me firmosjen e marrëveshjes së bashkëpunimit për digjitalizimin e procesit mësimor nëpërmjet shërbimeve TIK, të ofruara nga RASH dhe lidhjen me rrjetin GÉANT Community.

Synimi kryesor është përmirësimi i procesit mësimor në mbështetje të studentëve dhe personelit akademik. AFA do të vijojë me punën për transformim, duke ofruar arsim cilësor dhe bashkëkohor me punësim dhe karrierë të sigurt brenda FARSH-së.



AFA dorëzon dokumentacionin e përgatitur për procesin e riakreditimit, pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL)



Në kuadër të Akreditimit Institucional, Akademia e Forcave të Armatosura dorëzoi dokumentacionin e përgatitur për procesin e riakreditimit, pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL). Dokumentacioni përmban Raportin e Vlerësimit të Brendshëm

të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në gjuhën shqip dhe anglisht, bashkëshoqëruar me 255 evidenca plotësuese që pasqyrojnë në 360 gradë punën që AFA bën për përmbushjen e standardeve të sigurimit të cilësisë, si IAL e vetme



në vend në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. AFA mirëpret besimplotë hapin e radhës, vizitën e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në datën 4-10 tetor.



Anija “Oriku” realizon tjetër operacion SAR me sukses

Personeli i anijes “Oriku” vazhdon të tregojë gatishmëri dhe profesionalizëm të lartë; brenda 48 orëve të fundit ka realizuar 3 operacione SAR, duke iu ardhur në ndihmë 81 personave. Gjithashtu ditën e sotme gomnia me 21 emigrantë, mes tyre gra dhe fëmijë është konstatuar nga Roja Bregdetare shqiptare, duke u koordinuar me RB turke dhe RB greke, të cilat ndodheshin në rajon. Njerëzit u morën nga Roja Bregdetare greke për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.



Anija “Oriku” realizoi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “Pegnitz” (M1090)

Anija e Forcës Detare/Rojës Bregdetare P-132 “Oriku” pjesë e misionit të NATO-s në detin Egje, zhvilloi në ujërat ndërkombëtare një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “Pegnitz” (M1090).

Në stërvitje u zhvilluan seriale stërvitorë sipas standardeve të manualeve të NATO-s, stërvitje që shërben për rritjen e aftësive operacionale të efektivave të Forcës Detare.

Në përfundim të stërvitjes komandanti i Task Forcës (CTU)



kapiten i rangut II, Thorsten Geldmacher, shprehu falënderimet për zhvillimin me sukses të stërvitjes dhe profesionalizmit të treguar gjatë kohës në mision në detin Egje, kontingjentit V.

Forca Detare/Roja Bregdetare vazhdon kontributin e saj në shërbim të Aleancës në fushën e ruajtjes dhe sigurisë.



Anija veliere italiane “Palinuro” zhvilloi një vizitë në portin e Durrësit

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në Portin e Durrësit u zhvillua një vizitë nga anija veliere italiane “Palinuro”, pjesë e Forcës Detare italiane.

Qëllimi i vizitës së anijes italiane ishte trajnimi praktik i lundrimit të oficerëve dhe nënoficerëve të rinj të Forcës Detare italiane, dhënia e kontributit në projektionin e imazhit të Forcës Detare italiane nëpër botë dhe zhvillimi i trajnimeve dhe aktiviteteve dypalëshe ushtarake me vendet aleate të Italisë, e cila u shërben për forcimin e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet vendeve gjatë zhvillimit të vizitave portuale.

Komandanti i anijes, kapiten i Rangut II Samuele Mondino, së bashku me një pjesë të ekuipazhit të anijes realizoi një vizitë në Komandën e Forcës Detare/Rojës Bregdetare, gjatë së cilës u prit nga shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut I Arsen Mullaj. Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e shkëlqyer ushtarak ndër vite, benefitet që sjellin këto vizita, si dhe shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet dy Forcave Detare.



Gjatë vizitës tre ditore, anija veliere italiane u vizitua nga autoritet e larta civile dhe ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, si dhe personeli ushtarak i Forcës Detare/Rojës Bregdetare.

Kontingjenti XV EOD me mision në eFP Letoni, tregon aftësitë operacionale në stërvitjen demonstruese, në përmbushje të angazhimeve të Grup Batalionit Shumëkombësh

Efektivi i kontingjentit të 15-të EOD me mision në Letoni, zhvilloi një stërvitje demonstruese, ku u improvizuan disa skenarë me natyrë EOD dhe IEDD, pjesë nga detyrat që toga EOD zgjidh në mision.

Në këtë aktivitet morën pjesë Komandanti i Grup-Batalionit Shumëkombësh dhe anëtarë të shtabit të batalionit.

Skenarët që u zhvilluan ishin:

- Improvizimi i një fushe të minuar, procedurat e çminimit manual;
- Procedurat EOD/IEDD, në një makinë



bombë të improvizuar (VBIED);

- Procedurat për vënien në siguresë (RSP) të një municioni të paplasur si dhe procedurat për asgjësimin në vend (BIP) të municioneve të paplasura të paprekshme e të pa lëvizshme.

Në përfundim të aktivitetit, Komandanti i Grup-Batalionit Shumëkombësh në

Letoni, shprehu vlerësime të larta për togën EOD, për performancën e shfaqur nga efektivi, disiplinën, profesionalizmin, integritetin dhe seriozitetin e treguar në të gjitha aktivitetet e Grup-Batalionit Shumëkombësh si dhe përgëzoi me Medalje dy efektive të kontingjentit të 15-të EOD.



Komanda Mbështetëse priti Komandantin e Gardës Kombëtare të FSK, gjeneral brigade Naim Haziri

Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet FARSH-së dhe FSK-së, delegacioni i Gardës Kombëtare të FSK-së, zhvilloi një vizitë njohëse në ambientet e Komandës Mbështetëse. Delegacioni i kryesuar nga komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri u prit në takim nga zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela. Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse shprehu falënderime për bashkëpunimin e kahershëm në fushën e arsimimit dhe kualifikimit institucional, profesional si dhe për stërvitjet dypalëshe. Vizita njohëse e delegacionit vijoi me zhvillimin e një bërthame, ku të pranishmit u prezantuan me historikun, strukturën, misionin, detyrat, operacionet e kryera nga Komanda Mbështetëse në mbështetje të emergjencave civile në rast zjarri, përmbytje, operacionet e ndryshme EOD.

Në fjalën e tij të radhës, komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri falënderoi zëvendëskomandantin e Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela për ftesën dhe theksoi domosdoshmërinë për rritjen e bashkëpunimit, ndërveprimet, dhe trajnimeve dypalëshe për t'u përballur me sfidat dhe situatat e emergjencave civile të cilat vijnë në rritje. Të pranishmit në takim ndër të tjera diskutuan në lidhje me realizimin e vizitave e takimeve të përbashkëta, për njohjen më nga afër me strukturat dhe aktivitetet e përditshme që ato realizojnë.

Në përfundim të takimit ndërmjet komandantit të Gardës Kom-



bëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri dhe zëvendëskomandantit të Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela u shkëmbyen dhuratat simbolike dhe u realizua foto e përbashkët.

Përfundoi ndërtimi i urës tip “Bailey”, në fshatin Togëz, bashkia Librazhd

Efektivët e Kompanisë së Urave në Batalionin e Xhenios ndërtuan urën në fshatin Togëz, njësi administrative Qendër, bashkia Librazhd. U desh më tepër sesa një muaj që ekspertët xhenierë të përfundonin ndërtimin e urës tip “Bailey”, me gjatësi 75 m, me seksion 2/1 dhe peshëmbajtje deri në 40 tonë. Kjo urë do t'i vijë në ndihmë jo vetëm banorëve të lagjes Çota, por të gjithë komunitetit të fshatit Togës, duke lehtësuar jetesën e tyre të përditshme.



Përfundoi operacioni EOD për asgjësimin e predhave luftarake në fshatin Bregas, bashkia Poliçan

Ekspertët xhenerë të kompanisë EOD, në Batalionin e Xhenios kanë përfunduar operacionin në mbështetje të Emergjencave Civile në bashkinë Poliçan, për identifikimin, vlerësimin dhe heqjen e municioneve të rrezikshme. Ekipi EOD, duke zbatuar rregullat e procedurat e parashikuara në manualin EOD ML-400-5-2 ka vlerësuar, ka bërë përmirësimin dhe ka konstatuar se municionet e gjetura në fshatin Bregas, njësi administrative Vertop ishin



bomba aviacioni të Luftës së Dytë Botërore, të prekshme dhe të lëvizshme.

Efektivët e kompanisë EOD, duke respektuar masat e sigurimit teknik, bënë transportimin e municioneve për në ambientet e Batalionit të Xhenios.

Kompania EOD në mbështetje të strukturave të Forcave të Armatosura dhe komunitetit në bashkitë Vlorë dhe Këlcyrë

Specialistët e kompanisë EOD, përfundojnë operacionin në mbështetje të një strukture tjetër të Forcave të Armatosura, repartit ushtarak nr. 5005, Bunavi, Vlorë.

Ekipi i ekspertëve me njohuritë e tyre profesionale, bëri vlerësimin e municionit të gjetur në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Ushtarëve dhe konstatoi se bëhej fjalë për një predhë artilerie E-TH 120 mm.

Pas një ekzaminimi të kujdesshëm u vlerësua se municioni ishte i prekshëm dhe i lëvizshëm, duke bërë të mundur dhe transportimin në ambientet e batalionit të xhenios. Një tjetër operacion EOD u realizua për identifikimin, vlerësimin dhe asgjësimin e municionit luftarak të gjetur pranë një banesë në lagjen Gurë, bashkia Këlcyrë.

Specialistët e kompanisë EOD në batalionin e xhenios kanë realizuar operacionin, duke siguruar fillimisht perimetrimin e zonës, ku është gjetur municioni dhe kanë konstatuar një granatë dore Italiane SRCM.

Ekspertët përmes një vlerësimi të kujdesshëm konkluduan se

municioni ishte i palëvizshëm dhe duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik të parashikuara në manualin EOD, bënë asgjësimin në vend të tij.

Kompania EOD, përmbush misionin e saj në shërbim të komunitetit, duke shmangur incidentet e rrezikshme, njëkohësisht duke ruajtur jetën dhe pronën e tyre.



Specialistët EOD më pranë komunitetit për sigurinë e jetës dhe mjedisit nga municionet e rrezikshme

Ekipi EOD i Batalionit të Xhenios përfundoi operacionin për largimin e municionit në një zonë ujore në fshatin Dobërdol, bashkia Tropojë. Pas rikonicionit të kryer nga ekipi EOD, u identifikua një minë anti-personel fragmentuese. Municioni u cilësua i prekshëm, i lëvizshëm dhe i transportueshëm.

Përfundon me sukses një tjetër operacion EOD për vlerësimin, identifikimin



dhe largimin e municioneve luftarake të rrezikshme të konstatuara në vendin e quajtur pylli i Kadiut, njësi administrative Koms, bashkia Mat.

Ekipi EOD me të mbërritur në vendngjarje zhvilloi rikonicionin dhe konstatoi municionet si: mortaja eksploziv-thërrmuese 60 mm, 82 mm dhe 120 mm, granatë dore mbrojtëse kundër këmbësorisë, djegore të ndryshme, municionet e gjetura u konsideruan të prekshme dhe të lëvizshme.

Ekipet EOD morën të gjitha masat për largimin, transportimin dhe magazinimin e tyre në depon e Batalionit të Xhenios, brenda të gjitha rregullave të sigurisë.

Përfundon montimi i urës metalike tip “Bailey” në fshatin Luzhë, njësia administrative Llugaj, bashkia Tropojë


Banorët e fshatit Luzhë, njësia administrative Llugaj, bashkia Tropojë tashmë do të kenë një urë të re, e cila do t'i vijë në ndihmë banorëve të kësaj zone për të kryer aktivitetet e përditshme, duke e bërë më të lehtë jetesën e tyre dhe duke i ndihmuar për të zhvilluar më tej ekonominë. Për më shumë se një javë specialistët xhenierë të Batalionit të Xhenios, në Komandën Mbështetëse kanë punuar me përkushtim për montimin e urës metalike tip “Bailey” me gjatësi 15 metra, me seksion 2/1, urë që do të bëjë të mundur lidhjen dhe komunikimin me rrugën kryesore automobilistike. Komanda Mbështetëse me strukturat vartëse, përmes punës së realizuar në mbështetje të komunitetit, tregon gatishmërinë dhe sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e misionit të saj.



Përfundojnë operacionet EOD, në bashkitë Elbasan dhe Sarandë

Efektivë të kompanisë EOD në batalionin e xhenios u angazhuan në kryerjen e operacioneve në mbështetje të emergjencave civile në bashkitë Elbasan dhe bashkinë Sarandë. Gjatë punimeve të realizuara për përmirësimin e infrastrukturës në poligonin e qitjes në Detashmentin e Mbrojtjes Rajonale, Mengel janë identifikuar municione të rrezikshme të paplasura. Ekipi i ekspertëve të kompanisë EOD, ka bërë kontrollin, vlerësimin dhe identifikimin e municioneve, të cilat rezultuan të jenë predha artilerie 45 mm. Municionet e gjetura u konsideruan të lëvizshme.

Specialistë të kompanisë EOD, i janë përgjigjur kërkesës së autoriteteve përgjegjëse për vlerësimin dhe largimin e municionit të ndodhur në anijen e peshkimit, ankoruar në portin e Limjanit në Sarandë. Grupi EOD me përgatitjen e duhur profesionale, ka konstatuar se municioni ishte minë detare britanike e prekshme dhe e lëvizshme. Duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik, u bë transportimi dhe magazinimi i municioneve për në ambientet e batalionit të xhenios. Batalioni i xhenios vazhdon kontributin e tij për pastrimin e territorit nga municionet e paplasura duke i ofruar komunitetit një mjedis dhe jetesë të sigurt.



Ekipi EOD zhvillon operacionin për vlerësimin dhe largimin municioneve të rrezikshme në fshatin Nartë, bashkia Gramsh

Menjëherë pas marrjes së informacionit për prezencë municionesh të rrezikshme në fshatin Nartë, bashkia Gramsh, ekspertët e kompanisë EOD të batalionit të xhenios kanë marrë detyrën për sigurimin e perimetrit të zonës, ku do të kryhej operacioni dhe kanë bërë të mundur rikonicionin dhe kontrollin e zonës.

Pas identifikimit dhe vlerësimit të municionit të gjetur “predhë artilerie eksploziv thërrmuese 75 mm”, i cili u konsiderua i prekshëm, i lëvizshëm dhe i sigurt për transportim, u bë magazinimi në ambientet e batalionit të xhenios duke respektuar të gjitha masat e sigurimit teknik.





Kontingjenti XV EOD, realizon me sukses detyrat në kuadër të stërvitjes “Paladin Strike”

Kontingjenti XV EOD, pjesë e grup-batalionit shumëkombësh të Prezencës së Përparuar të Përforcuar të NATO-s (eFP), në Letoni, realizon me sukses të gjitha angazhimet, duke performuar me rezultate të larta në të gjitha stërvitjet dhe detyrat e tjera. Kontingjenti EOD mori pjesë në stërvitjen “Paladin Strike”, duke u radhitur përkrah forcave të tjera aleate të NATO-s, duke bashkëpunuar dhe ndarë eksperiencat në lidhje me teknikat, taktikat dhe procedurat e ndjekura për neutralizimin e rrezikut që vjen nga prania e municioneve luftarake të rrezikshme. Gjatë kësaj stërvitje efektive të togës EOD, zgjidhën me përgjegjësi detyra dhe situata, duke treguar nivel të lartë përgatitje profesionale. Efektivët e kontingjentit EOD, në përfundim të stërvitjes “Paladin Strike”, u vlerësuan maksimalisht nga drejtuesit e grup-batalionit shumëkombësh.



Kontingjenti i dytë i Policisë Ushtarake niset në misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhgimit (MFO) në Sinai, Egjipt

Siguria ndërkombëtare është një element i rëndësishëm në misionin ushtarak të Shqipërisë. Policia Ushtarake i ka kapacitetet për t'u ardhur në ndihmë edhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, të cilëve u gjendeni në krah me trupat dhe njerëzit tanë të specializuar. Në këtë kuadër, pas urdhrat të ministrit të Mbrojtjes, u përçoll kontingjenti i dytë i Policisë Ushtarake në misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhgimit (MFO) në Sinai, Egjipt. Një mision i rëndësishëm që përfshin tre efektivë të Policisë Ushtarake, të cilët do të kontribuojnë me eksperiencën e tyre për 12 muaj



për të përbushur me përkushtim detyrat në kuadër të MFO-së. Ju urojmë efektivëve tanë ta përbushin me sukses këtë mision fisnik dhe shpresojmë për kthimin e sigurt të tyre në atdhe!



SEEBRIG, siguri, stabilitet rajonal, besim, marrëdhënie e fqinjësisë së mirë midis vendeve të Europës Juglindore

Intervistoi:
ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

25 vjet nga themelimi, Brigada e Evropës Juglindore (SEEBRIG), një nga iniciativat rajonale të Ministrave të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM), vazhdon të tregojë se është një mekanizëm jashtëzakonisht i vlefshëm për promovimin e sigurisë rajonale, besimin dhe ruajtjen e bashkëpunimit ushtarak midis shteteve anëtare. Nga viti 1999, për të dytën herë kjo iniciativë drejtohet nga

Shqipëria. Mandati që nisi në gusht të vitit të kaluar mbahet nga një ushtarak me gradë madhore të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneral brigade Bilbil Bitri.

Shqipëria është një pjesëmarrëse aktive në këtë projekt të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes mes vendeve të Evropës Juglindore dhe ka treguar përkushtimin e saj, ku më e rëndësishmja është ruajtja e frymës së fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimi për një zhvillim paqësor të rajonit.

Gjeneral brigade Bilbil Bitri, do të jetë për një mandat trevjeçar Komandant i Brigadës së Evropës Lindore, të dislokuar në Kumanovë të Maqedonisë së Veriut. Për më shumë informacion

mbi këtë Brigadë dhe misionin e saj do të na informojë mes kësaj interviste gjeneral brigade Bilbil Bitri.

I nderuar gjeneral, ju uroj suksese në këtë mision të rëndësishëm për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe më gjerë!

Çfarë është SEEBRIG?

Faleminderit për urimet dhe për mundësinë që po më jepni të ndaj me lexuesin e revistës/gazetës të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e SEEBRIG.

Brigada e Europës Jug-Lindore (SEEBRIG) është 'instrumenti ushtarak' i një procesi politik, Ministrat e Mbrojtjes të Evropës Juglindore (SEDM), të nisur në vitin 1996 në Tiranë, me një takim të Ministrave të Mbrojtjes të Evropës Juglindore dhe të pasuar me takime të zëvendësministrave të Mbrojtjes dhe të zëvendëshefave të Shtabeve të Mbrojtjes të këtyre vendeve. Objektivi kryesor ishte forcimi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit politiko-ushtarak në rajon për të rritur stabilitetin dhe sigurinë në Evropën Jug-Lindore.

Kur u themelua?

Në vitin 1998, ministrat e Mbrojtjes të shtatë vendeve të Evropës Jug-Lindore, Shqipërisë, Bullgarisë, Greqisë, Italisë, Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rumanisë dhe Turqisë nënshkruan, në Shkup, Marrëveshjen për Forcën Shumëkombëshe të Evropës Jug-Lindore (Multinational Peace Force South Eastern Europe – MPFSEE). Kjo marrëveshje është baza e krijimit të SEEBRIG, strukturë e cila u aktivizua, më 31 gusht 1999, në Plovdiv të Bullgarisë. Në vitin 2015, Italia në mënyrë të njëanshme

vendosi të tërhiqet nga marrëveshja. Prej krijimit, SEEBRIG e ka ushtruar aktivitetin e saj dhe në Stamboll, Turqi; Konstanca, Rumania; dhe Tynavos, Greqi. Në rolin e vëzhguesit, prej krijimit të SEEBRIG, janë Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Sllovenia, Ukraina, Serbia dhe SHBA-të.

Cilat janë objektivat kryesore të SEEBRIG?

Objektivi kryesor dhe i pandryshueshëm për SEEBRIG, për sa kohë nuk ndryshon misioni, mbetet përgatitja dhe mbajtja në gatishmëri e kapaciteteve për t'u angazhuar në Operacione të Mbështetjes së Paqes, të autorizuar nga OKB ose OSBE dhe të drejtuara nga NATO ose BE, si dhe në Operacione për Lehtësimin e Pasojave nga katastrofat natyrore (Disaster Relief Operations), në rajon edhe me gjerë.

SEEBRIG, me të njëjtin përkushtim e angazhim është fokusuar dhe në ndërveprimin me Forcat e Armatosura të vendeve kontribuuese, vendeve anëtare të SEDM-it, struktura të NATO-s edhe me struktura e organizata ndërkombëtare rajonale në interes të promovimit të sigurisë dhe stabilitetit dhe rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit ushtarak.

Struktura dhe funksionimi i SEEBRIG

SEEBRIG është konceptuar si një Brigadë e Këmbësoresisë së Lehtë, e aftë për t'u angazhuar në Operacione të Mbështetjes së Paqes. Struktura e saj përfshin Shtabin e Brigadës, i cili plotësohet me personel nga shtetet kontribuuese në bazë të marrëveshjes së dakordësuar, katër batalione manovre të këmbësoresisë së lehtë, elementë të mbështetjes së luftimit si



dhe një batalion të mbështetjes me shërbime. Pak muaj pas aktivizimit të Brigadës vendet kontribuuese ranë dakord edhe për krijimin e një strukture/elementi të veçantë për të kontribuar në operacione për Lehtësimin e Pasojave nga Katastrofat Natyrore, Task Forca e Xhenios (Engineering Task Force – ETF). Shtetet kontribuojnë proporcionalisht me elementë të manovrës dhe mbështetjes. Të gjithë këto elementë të dedikuar për SEEBRIG trajnohen, stërviten e përgatiten në vendet e tyre respektive dhe kalojnë nën komandën e SEEBRIG në rast aktivizimi për mision ose për stërvitje.

Misionet dhe arritjet e SEEBRIG

Në 25 vjet aktivitet të një strukture apo organizate, besoj ka gjithmonë shumë për të thënë lidhur me arritjet.

SEEBRIG përbën një histori suksesi për shumë arsye. Mjafton të kthehemi në kohë dhe të rikujtojmë kontekstin gjeopolitik të rajonit, por edhe përtej tij në vitin 1999. Katër nga vendet kontribuuese në SEEBRIG, Shqipëria, Bullgaria, Maqedonia e Veriut dhe Rumania kishin shprehur ambicien e tyre për integrim Euro-Atlantik. Sot të gjitha vendet e SEEBRIG janë anëtarë të NATO-s. Besoj do të mjaftonte ky fakt për të identifikuar një nga arritjet e SEEBRIG – kontributi në promovimin e sigurisë dhe stabilitetit si dhe rritjen e bashkëpunimit ushtarak.

Nëse do duhet të veçoj një prej arritjeve, patjetër që “diamanti” është misioni në Kabul, Afganistan, në vitin 2006. Prej shkurtit deri në gusht 2006, SEEBRIG me shtabin dhe elementët mbështetës (më shumë se 400 ushtarakë) kishte komandën e ISAF IX KMNb - Brigada Shumëkombëshe e Kabulit. Një dimension i rëndësishëm i arritjeve të SEEBRIG janë organizimi dhe ekzekutimi çdo dy vjet

i serisë së stërvitjeve “Seven Stars”, me pjesëmarrjen e shtabit, reparteve të varësisë (affiliated units) si dhe strukturave e organizatave të tjera nga rajoni, ushtarake dhe civile.

Cilat janë detyrimet e kësaj iniciative në të ardhmen?

SEEBRIG mbetet objektiv dhe detyrë e përhershme e promovimit të sigurisë, paqes dhe stabilitetit në rajon. Ky është edhe një nga qëllimet, në mos kryesori për të cilin SEEBRIG u krijua. Por ndërkohë është e domosdoshme të theksohet se dobishmëria e çdo strukture apo organizate varet nga aftësia e saj për t’iu përshtatur rrethanave të mjedisit, në rastin e SEEBRIG, të mjedisit gjeopolitik dhe të sigurisë. Në këtë kontekst, për SEEBRIG është e rëndësishme të bëjë përpjekjet maksimale të adaptohet, ndërsa për shtetet kontribuuese ndoshta është koha të vlerësojnë dhe mundësinë e transformimit. Adaptimi dhe transformimi janë përgjigjja më e mirë ndaj çdo ndryshimi.

Faleminderit!

Shqipëria është një pjesëmarrëse aktive në këtë projekt të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes mes vendeve të Evropës Juglindore dhe ka treguar përkushtimin e saj, ku më e rëndësishmja është ruajtja e frymës së fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimi për një zhvillim paqësor të rajonit.





BASHKIM LIKAJ, skënderbegasi, embleme e mundjes shqiptare

Intervistoi: **ANJEZA MUSOLLARI,**
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në rrugëtimin si gazetarë kam bashkëpunuar me personalitete, kontributi i të cilëve ka pasur ndikim të madh në jetën sociale të vendit, por njerëzit që kanë lënë gjurmë në memorien time janë ata njerëz që moto të tyre kanë: “Detyra, Nderi, Atdheu”, të formësuar intelektualisht në shkollat ushtarake dhe me shkëlqim shumëdimensional në fusha si arti, kultura, shkenca dhe sporti. Ndër vite këta njerëz jo vetëm kanë qenë në mbrojtje të atdheut, por na kanë bërë krenarë me flamurin e kuq dhe shqiponjën dykrenore në duar si triumfator në të gjithë botën. Një prej tyre është dhe i madhi skënderbegasi, mundësi rekordmen, trajneri Bashkim Likaj. Brezat e rinj me këto figura të nderuara do kuptojnë se si, edhe në kohëra të vështira, ku logjistika dhe standardet ku punohej ishin larg realitetit të sotëm, kanë arritur të çudisin botën dhe të korrin suksese të mëdha. Për më tepër profesor Bashkim Likaj do të rrëfejë për shtypin ushtarak rrugëtimin e tij por dhe të tre brezave dalë nga familja Likaj, denjësisht në uniformën e gjelbër dhe shkëlqimin e tapetit të kuq.

I nderuar profesor, si nisi rrugëtimi juaj nën uniformën e gjelbër dhe njëkohësisht pjesë e formacioneve sportive të shkollës ‘Skënderbej’?

Shkolla “Skënderbej”, ajo që quhej fidanishte e ushtrisë, ishte edhe për sportet në atë kohë fidanishte, ku kanë dalë shumë sportistë. Aty kisha fatin të njihja Bejkush Birçen, të cilin e kisha pedagog të lëndës së fizikulturës. Ai këtë gjë e pikasi në shumë aktivitete të shkollës dhe një ditë më thotë: “Bashkim, në kampionatin e kompanisë do ta na përfaqësosh ti!”, - “Si urdhëron profesor!”, - iu përgjigja unë. Në kampionat dola mirë, dola mirë edhe në kampionatin midis kompanive, pastaj në kampionatin e shkollës, ku u dallova për talentin që kisha. Që në atë kohë, pra në vit të dytë të shkollës, u regjistrova në ekipin e skënderbegasve, në ekipin e të rinjve të “Partizanit”, pastaj në vitin 1966-1968 pata stërvitje të pandërprerë dhe në vitin 1968 dola kampion me të rinjtë dhe më pas kampion me të rriturit, në një aktivitet që u bë. Nga viti 1968, ’69, ’70, ’71, ’72 isha kampion absolut në peshën time, kampion gjithmonë në kampionate e në kupa... dhe kështu arrita të bëhesha një sportist i mirë.




Me Komandantin e shkollës, Rustem Peçi dhe shefin e Katedrës Petrit Murzaku, në fushim dimëror

Ndërkohë, pasi mbarova studimet në shkollën “Skënderbej”, vijova studimet e larta në Institutin e Fizikulturës, ku edhe aty vazhdova në vitin e parë e të dytë të mbaja titullin kampion. Në Institut ndjehesha edhe i përkëdhelur për këto arritje si sportist, ku dola edhe në tabelën e Nderit, edhe si kampion, por edhe për rezultatet sportive të suksesshme, për tre vjet, ku dalloja në aktivitetet sportive shumë të suksesshme.



Më pas fillova të stërvitja ekipin e shkollës “Skënderbej”, që në vit të dytë në Institut, ku morëm 70 skënderbegas, nga këta 70 u seleksionuan dhe pas dy muajsh mbetën vetëm 20 më të mirët, ndër ta ishin Bekim Lamja, Ndoci, Mazreku, Ilir Qosja, të cilët bënë të mundur formimin e ekipit të parë të “Partizanit”, të rinj të talentuar. Ndërkohë në ekipin e “Partizanit” kishte një krizë për trajner, ku dy vjet qëndroi njëri e pastaj një tjetër dhe kështu u ndërrua 4-5 herë trajneri. Unë ndërkohë mbarova Institutin dhe më caktuan trajner, njëkohësisht isha sportist elitë edhe me kombëtaren, isha kapiten i ekipit kombëtar. Atëherë kombëtarja kishte shumë aktivitete, në atë kohë dy herë kam luajtur me Rumaninë, ku i fituam dy ndeshjet dhe më pas shkuam edhe në Rumani, ku luajtëm ndeshje miqësore. Kur më caktuan trajner të ekipit të “Partizanit” isha akoma 22 vjeç dhe këto aktivitete: sportist edhe trajner, i vazhdova të dyja njëkohësisht dhe ndërkohë në Shkollën e Bashkuar isha instruktor i Përgatitjes Fizike, kisha 7 grupe mësimore. Mora ekipin e “Partizanit” në moshën 23 vjeçare, i “dhashë karar” dhe i thashë stop sportit dhe vendosa të vazhdoja trajnimin. Ndërkohë mora edhe ekipin kombëtar, sepse shumica e ekipit të “Partizanit” bënë pjesë në ekipin e kombëtares. Aty kuptova që trajnerët bënin marifete që të fusnin sportistët e vet nga ekipet e tjera si “Studenti”, “17 Nëntori”, “Vllaznia”, pa e merituar dhe na përplasnin ne të “Partizanit” me njëri-tjetrin, kështu, nga dy shkonim në një dhe ata të vetët rrinin në formacion, kjo ishte një hile, që unë e kuptova shumë shpejt. Organizova një mbledhje Federate, vura veton dhe kërkova që kjo të bëhej dhe vura disiplinë në përcaktimin e formacionit.

Pra pata një autoritet si sportist e si trajner i “Partizanit”. Në moshën 23 vjeçare, në vitin ’73, mora ekipin kombëtar. Ekipin Kombëtar e drejtova deri në vitin 1979-1980, aktiviteti i fundit për mua. Kishim 3-4 aktivitete në vit, ku ata vinin në Shqipëri e ne shkonim në Kampionat Europian dhe Botëror, ndeshje që i drejtova me sukses. Në vitin ’73 kemi pasur vendin e 6-të në Europë, me këtë pozicion ishim shumë mirë. E keqja ishte se kur shkonim në Europian na takonin ndeshje me spanjollët, me të cilët s’kishim



marrëdhënie diplomatike, po ashtu me rusët e BS, me të cilët i kishim prishur marrëdhëniet, e kështu eliminoheshim, sepse nuk lejohej ndeshja me Spanjën. Dhe ne na ra të ndesheshim pikërisht me Spanjën, pasi kishim fituar dy ndeshje me rumunët, të cilët ishin nënkampionë Europe dhe dolën sërish nënkampionë, me dy përfaqësues në peshat përkatëse, në vendet e dyta. Unë isha shpallur pretendent me rumunët, sepse ata ishin prezent pothuaj në të gjitha ndeshjet, por më ra të përballësja me spanjollët që në ndeshjen e parë. Më vonë i ra të ndeshesh me rusët Stefan Gjirait, në 1979 i ra të ndeshesh Abedin Lames me spanjollin, ku Abedini e kishte tashmë një fitore të shkëlqyer me një austriak, kishte edhe një barazim me një rumun dhe dilte direkt në treshe, po të fitonte me spanjollin, por nuk i lejohej, sepse kështu ishin politikat e kohës, nuk lejohej me një vend që nuk kishim marrëdhënie diplomatike. Kështu jemi djegur nga disa gjëra, por mundja në atë kohë kishte ecur shumë përpara. Unë si trajner i “Partizanit” dhe i Kombëtares, iniciova një lloj aktiviteti që ekipet e mundjes të ndesheshin si futbolli, vajtje-ardhje. Këtë e kërkesë e ngrita në një mbledhje që u zhvillua me zëvendëskryeministrin e asaj kohe, i cili përgjigjej për sportin. “Çfarë thotë ky djalë?!” - tha ai, ia shpjeguan që kërkojmë që ndeshjet të zhvilloheshin vajtje-ardhje, në të gjitha rrethet. Atëherë ishte shumë e lodhshme për kohën, sepse duhet ta kishe ekipin e plotë dhe ekipet e tjera nuk ishin të plotë si “Partizani”, vuanin se nuk e plotësonin dot peshën, plus që dhe nuk kishin interes ta bënin vajtje-ardhje, donin të bënin dy aktivitete në vit, donin të përfitonin nga koha e qëndrimit, të merrnin trajtimin e të përfitonin nga të mirat e asaj kohe, por kjo zhvillonte shumë cilësinë sportive. Gjatë kësaj kohe kishte një rivalitet shumë të madh, “Shkodra”, “Dinamo”, “17 Nëntori”, “Partizani po e po, “Durrësi”, “Vlora”, u bënë të gjithë ekipe elitë që mund të të rrihnin në çdo kohë, po të ishte pak i pakujdesshëm. Ishin 12 ekipe të kategorisë së parë. U përmirësua shumë cilësia sportive. Unë drejtova ekipin kombëtar në disa aktivitete, ekipi ishte 90 për qind i “Partizanit”, edhe me Kombëtaren ka funksionuar çdo gjë me drejtësi absolute.

Cilin keni pasur rivalin më të fuqishëm përballë jush?

Përballë meje ka qenë Hasan Porova i “Dinamos”, në atë kohë ishte 21 vjeç, s’e kishte mundur njeri deri në kohën që dola unë.

Asip Omuri, gjithashtu ka qenë një mundës i mirë i “17 Nëntorit”, s’e kishte mundur njeri as atë, por ishte shumë më tepër se unë në peshë, mirëpo unë atë kohë nuk kisha trajner dhe trajnerët më futën me peshat e forta. Asipin e kam mundur për herë të parë në Dajt, në çeljen e sezonit veror, ku vinin e gjithë rinia, ishte edhe instruktori fizkulturës. Unë isha në vit të dytë në institut, nuk isha i pjekur, në krahasim me Omurin isha shumë i dobët, ai ishte 87 kg, unë isha 74, u detyrova të pija 16 kavanoza ujë që të arrija peshën e tij, sepse nuk lejohej, duhej të isha mbi 82 kg që të shkoja në peshën e tij. E munda pastër fare, me hedhje të cilësisë së lartë. Edhe Instituti i Fizkulturës ishin të gjithë tifozë me mua, më ngritën në krahë, e përjetuan me gëzim të madh. Ndërsa Hasan Porova ishte mundës që s’e kishte mundur dot as trajneri im. Kam pasur dy trajnerë shumë të ashpër, kampionë, Luigj Deda, ai ishte pak më i madh se Porova në moshë dhe nuk e kishte mundur dot, dhe ma lanë mua. Më stërviti disa kohë dhe në fund e munda bindshëm. Ka pasur shumë kundërshtarë të fortë, kanë qenë ata të Shkodrës, Gegë Gjoni, Dushani, i cili ishte shumë i fortë. Mundës të mirë kishte e gjithë Shqipëria.

Profesor, ju thatë që e keni nisur si skënderbegas, pra keni ardhur me pantallona të shkurtra, keni filluar 14 vjeç. Përse zgjodhët pikërisht të vishnit uniformën ushtarake, ndikoi dikush nga familja juaj apo një zgjedhje e kohës?

Unë kisha babanë oficer në Ministrinë e Brendshme, ai ka qenë adjutant i Enver Hoxhës nga viti 1945 deri në vitin 1972, ka qenë komandant i shërbimit dhe zëvendëssekretar partie grupi në Byronë politike. Me fillimin e luftës, që në ditën e parë të krijimit të Brigadës së parë Sulmuese ka qenë me Mehmet Shehun korrier i Brigadës së Parë, bashkë me Ismail Shehun, të cilin e kishte djalë xhaxhai. Me Brigadën e Parë ka qenë gjithë kohës, në luftë ka qenë snajper, ka qenë i shkëlqyer, ka pasur shumë shënjestër, më mësoi edhe mua. Edhe unë jam marrë me sportin e qitjes, kam qenë kampion në garnizonin e Tiranës. Ndërsa luftën babai im e ka nisur që në Kosovë, e morën italianët ushtar nga Himara, ku ishte në punë, e çuan në Pejë, atje pas disa kohësh u lidh me lëvizjen në Kosovë me Fadil Hoxhën dhe u arratisën nga ushtria. Më pas lëvizi çetë më çetë deri te Haxhi Lleshi, se atëherë kështu bëheshin lëvizjet. Erdhi më në fund në Mallakastër, i veshur me rroba kosovare, ndërkohë në shtëpi e kishin qarë, e dinin të vdekur. Kështu që filloi lufta atje, mbaroi te Brigada e Parë, nga momenti i formimit të brigadës e deri në çlirimin e Tiranës. Pastaj në vitin 1945, kur Mehmet Shehu u largua me studime, mori edhe babanë me vete. Deri në vitin 1972, u detyrua të largohej për shkak të sëmundjes së tij dhe në moshën 71 vjeçare ndërroi jetë. Kështu që, ishte babai që na afroi me ushtrinë. Më parë afroi vëllain, i cili ishte i shkëlqyer gjatë studimeve në shkollë dhe vazhdoi karrierën ushtarake, ku më vonë u emërua drejtor i Topografisë Ushtarake. Gjatë 4 viteve si skënderbegas pashë foton e vëllait, të ekspozuar në shkollë si i dalluar. Pastaj unë fillova si skënderbegas me sportin e më pas në Institutin e Fizkulturës. Arrita majat e sportit në ushtri, si trajner i “Partizanit”, trajner i Kombëtares pastaj arrita të bëhem kryetari i Federatës së Mundjes. Më zgjodhën në sajë të aftësive që kisha. Kam qenë edhe kryetar i Këshillit të Trajnerëve për shumë kohë edhe materialet që përgatisja, planet e stërvitjes etj., ishin model, që i merrnin në të gjithë Shqipërinë trajnerët e

tjerë. Më vonë u emërova kryetar i Kolegjiut Gjyqtar, ku lashë sportin si trajner dhe kalova si gjyqtar, ku edhe aty më zgjodhën kryetar. Mundja pati gjyqtarë dinjitozë, që në bazë të rregulloreve ndërkombëtare i gjykonin ndeshjet njësoj sikur të ishin jashtë.

Profesor, sporti juaj i mundjes, ka qenë më mirë atëherë, në periudhën para viteve '90 apo pas viteve '90, në raport me burimet njerëzore por edhe infrastrukturën?

Për sa i përket infrastrukturës, është e vështirë të thuash se ka qenë më mirë. Por ajo që më gëzon është vendimi që qeveria shqiptare mori për futjen e sportit nëpër shkolla dhe për pajisjen e shkollave me palestra moderne, me të gjitha fushat e sporteve të ndryshme, si atletikë, volejbol, basketbol, ku mund të bëhen ndeshje pafund me ekipet e mundjes. Nga ana e bazës materiale tani është shumë më mirë, ndërsa nga ana e masivitetit atëherë ishte shumë më tepër, sepse kishte më shumë rini, dashuria për sportin ishte më e madhe. Atëherë ishte parulla: "Sporti për mbrojtjen e Atdheut dhe për shëndetin". Kishte shumë përkrahje nga politikat e shtetit, por deri te sporti masiv, kishte shumë interes të kishte sa më shumë sport, por kur vinte puna te cilësia, nga sportist elitar që mund të ishte këtu brenda vendit, për të dalë sportist elitar jashtë vendit duhej shumë kujdes, ishte shumë e vështirë. Nuk dilnim dot nga koncepti i sportit masiv. Një nga pengesat ishte kjo, që kur dilnim me Bashkimin Sovjetik nuk bëhej ndeshja, por, po mos të bëhej ndeshja prishej aktiviteti. Për shembull në ndeshjen në Kampionatin Europian në Poloni, kemi qenë dy herë, në Katovicë u prish aktiviteti, sepse ndryshon formula e përplasjes. Polakët u bënë entuziastë, sepse do të tregonin që "...ne jua treguam para gjithë popullit që ne nuk ndeshemi me BS, sepse është shtet social-imperialist dhe ka pushtuar Çekoslovakinë. Ne s'kemi marrëdhënie diplomatike...etj., me ovacione etj...". Edhe ne, kur bëmë ndeshje me Pirro Kokalarin dhe me Stefan Gjirain, ne deklaranim: "Ne nuk ndeshemi me ata, sepse ata janë vend social-imperialist, kanë pushtuar Çekoslovakinë etj.". Mirëpo populli e mori vesh këtë deklaratë dhe na thoshin: "Ju jeni superfuqi, jo BS...", pra ishin të frikësuar shumë.

Sporti arriti shumë nivele të larta, por jo për cilësi, për cilësi mund të përmendim Luiza Gegën sot, ajo është një heroinë. Ka pasur edhe atëherë sportiste si Gega, por jo me këto rezultate të nivelit europian. Por mund të them që edhe atëherë ishte sport dinjitoz, kudo që shkonim ndesheshim me dinjitet, nuk na ecte shumë për çështje përvoja. Për shembull mundësit shkonin një herë në dy vjet në Europian, ose një herë në vit dhe me vështirësi ambientoheshim me rregullat, sa të ambientoheshim ne, humbim pikët, pra për çështje përvoja kishim mungesë, ndërsa për çështje teknike e taktike ishim më se të barabartë me mundësit më të mirë, me bullgarët, rusët rumunët, madje rumunët arritëm t'i mundnim disa herë. Por gjithsesi duhet përvoja për cilësi të lartë, këtu çalonim.

Po Sot? A janë të rinjtë tanë në nivelin e pritshmërive tuaja?

Po të krahasojmë, ne në atë kohë ishim 12 ekipe të kategorisë së parë dhe të 12-të ekipet kishim të drejtë me ligj, që 5 deri 7 ekipe t'i mbanim më pas: të rinj, para të rinj, fëmijë, shkollorë, kishim të drejtë të paguanim trajnerë, kishim palestër. Disa klube arrinin deri te 7-a, "Partizani" kishte mjaftueshëm,

ndërsa klubet e tjera bënin deri 5 ekipe, sipas hapësirës. Kishte mbështetje shumë të madhe për talentet.

Kohët e sotshme fillon aktiviteti në orën 8.00 në mëngjes dhe mbaron në 4.00 pasdite, ndërsa atëherë fillonte në 8.00 të mëngjesit dhe mbaronte në 10.00 të darkës, ditën e parë, po ashtu edhe ditën e dytë dhe ndoshta edhe ditën e tretë, sepse ishin 12 ekipe, me ekipe të plotë, pa mungesa, pra ishte një aktivitet shumë i fortë. Të dilje kampion atëherë ishte shumë e vështirë, ndërsa tani në tre veta një del në vend të parë, një në të dytin dhe tjetri në të tretin, kështu vazhdon që nga 92-shi. Tani kemi arritur që të marrim mundës edhe nga jashtë, dhe kjo nga njëra anë është gjë e mirë, sepse tregon që ka interes nga të huajt që vijnë këtu, por burimi vendas është pozitiv. Do të ishte mirë që ata që vijnë të sjellin përvojën e vet dhe të jenë të aftë që të përgatisin një brez të mirë edhe të mundësve shqiptar, ashtu siç kanë bërë me veten, sepse kur të vijnë olimpiadat e radhës, pas katër vjetësh, ne duhet të kemi mundës shqiptar, nuk është pozitive për ne të mos kemi përfaqësues shqiptar.



Profesor, folëm për prejardhjen tuaj, nisur nga babai juaj, më pas erdhëm tek ju, për të shkuar te brezi i tretë, pasardhësit tuaj. Ju vazhdoni të mbeten brenda FA-së, pra një pjesë e familjes tuaj vazhdon ta ruajë traditën e sportit, po njëkohësisht edhe uniformën ushtarake?

Ashtu është, unë ushtarak jam në gen, babai ishte ushtarak, vëllai i madh ka qenë ushtarak, ndërsa tani kam djalin ushtarak, i cili së shpejti do të marrë gradën "major". Edhe djali si unë ka mbaruar Akademinë e Sporteve dhe punon po në të njëjtën katedër, ku unë kam qenë instruktor, pedagog, shef Katedre. Ai kur vjen në palestër shikon fotografinë time, e cila ndodhet tek palestra e lojërave. Është emocionuese...kjo është një vazhdimësi. Ai është shumë i përgatitur dhe është pozitive për të, sepse i ka mbaruar të gjitha shkallët e kualifikimeve si trajner, e drejta e tij është që mund të stërvitë edhe një ekip kampion bote, pra në bazë të diplomave që ka mund ta ushtrojë profesionin kudo që të ndodhet edhe jashtë Shqipërie. Ai është shumë i lidhur me fëmijët, bën një punë shumë të mirë me ta, me fëmijët e ushtarakëve këtu, por edhe me fëmijë të tjerë që kanë dëshirë, por janë me kufizim, sepse ambientet janë të vogla.



Mua më duket se punon mirë, sepse ka sjellë disa kupa në shtëpi, e ka mbushur ambientin e shtëpisë me to, plus diplomave e kualifikimeve. Jam entuziast, sepse po vazhdon traditën edhe si ushtarak edhe si sportist dhe në të njëjtin ambient ku kam punuar edhe unë. Në Akademi kam punuar shumë, pesë vitet e fundit nga viti '87-'92 kam qenë shef Katedre, dhe gjithë këto terrene i kam shkëlur pëllëmbë për pëllëmbë. E di se çfarë ka qenë, e kemi ndërtuar me sakrificë të mëdha. Këtu ka qenë fusha e futbollit e minifutbollit, ka qenë edhe qyteti sportiv, që ishte për gjimnastikën me dhjetëra vegla. Edhe në sheshin qendror ne kishim bërë fushat e basketbollit dhe volejbollit, ku vijëzimi ishte i gatshëm dhe të gjitha pajisjet e tjera montoheshin në moment. Kur kishte kohë të lirë, të gjithë batalionet: të këmbësorisë, të specialiteteve dhe të artilerisë, të tria aktivizoheshin njëkohësisht me dymijë studentë në të njëjtën kohë, ku për të gjithë kishte uniformë sportive, ambient, topa e çdo gjë që nevojitej, pa asnjë pengesë. Unë atë bërë kur erdha në shkollën e Bashkuar për së dyti, sepse një pesëvjeçar isha tek "Partizani", ku bëra stazhin e partisë e kur u ktheva, Perit Nazarko doli në pension dhe më kaluan mua shef Katedre. Kisha mbaruar edhe gjuhën e huaj, që ishte kriter. Isha shumë kërkues ndaj vetes, studioja nga 4 orë në ditë në bibliotekë dhe vazhdoja studimin edhe në shtëpi. Kishim një pedagog të përsosur, Abdurrahim Myftiu, një nga përkthyesit e gjuhëtarët më të mirë që kemi pasur, i cili vinte dy herë në javë na jepte mësim. Ishim një grup prej 20-30 oficerësh, nga të cilët e mbaruam rreth 10-12 oficerë. Ishte kurs që zgjati 4 vjet, kisha ndihmë edhe kunatin, i cili studioje në Institutin e Gjuhëve të Huaja. Më ka shërbyer shumë njohja e gjuhës angleze, edhe kur u riktheva në ushtri në Shtabin e Përgjithshëm. Aty më duhej komunikimi në gjuhën angleze, sepse isha edhe shef delegacioni për sportet ushtarake i CISM-it, ku kam qenë prezent nëpër të gjithë kongreset e konferencat e CISM-it, të organizuara jashtë Shqipërie nga viti 1997 deri në 2006, në konferencat europiane etj. Unë iniciova një konferencë rajonale, duke marrë shkas nga iniciative a Detit të Zi, me Turqinë e Azerbajxhanin. Kur ishim në Moskë, në një konferencë ngrita idenë që të duhet të krijonim edhe ne një institucion ballkanik,

duke përfshirë edhe Turqinë, sepse ne nuk mund të shkonim deri në Finlandë për shembull, për të bërë qitje, por mund t'i organizonim në rajon, ku rezultatet mund të ishin të matshme e të krahasueshme. E pëlqyen shumë idenë, turqit sidomos. Nëpër konferencat që bëmë ne në vitet në vijim, turqit më përmendnin herë pas here: "babai i CISM-it në rajonin tonë është Bashkim Likaj", turqit i ndjekin dhe u japin shumë rëndësi këtyre lloj organizimesh e konferencash. Ky lloj iniciative ka vazhduar aktivitetin dhe unë kam qenë pjesë herë pas here e këtyre takimeve. Njeriu që guxon ecën, sistemi atëherë donte guximtarë për të pasur arritje, po ashtu edhe sot duhet shumë punë e vullnet për të arritur objektivat.

Njerëz si ju kanë çfarë thonë dhe ju keni një jetë që keni investuar dhe keni punuar me shumë dashuri...

...Me pasion të madh, sidomos kur u riktheva në vitin 1997, pasi na larguan në vitin 1992, kur u bë reforma politike, isha shef katedre atë kohë, u riktheva në SHP për sportet. Kemi marrë pjesë në ringritjen e ushtrisë, ne ishim nga drejtoria operative, pra drejtoria kryesore, ishte një heroizëm i vërtetë i ushtarakëve që e ringritën ushtrinë aq shpejt. Ambasadorët e atashetë ushtarakë, kur mermin pjesë në stërvitjet tona, çuditëshin si e ringritëm ushtrinë aq shpejt, "çfarë aftësish kanë ushtarakët shqiptarë që e ringritën ushtrinë me kaq dashuri e heroizëm". Ne bëmë disa stërvitje në atë kohë për kalimin me pengesa ujore, bëmë edhe një stërvitje në Korçë, në Brigadën e Tankeve, habiteshin si ishte e mundur, me tanket që i kishin marrë fshatarët, që me vështirësi i mblodhëm... Mirëpo ishte çudi e madhe edhe për programin. Unë përgatita programin, fillimisht për një aktivitet futbollit, dhe drejtori operativ ishte shumë mosbesues, për mungesa të pajisjeve etj., gjithsesi unë këmbëngula. Fillova me një aktivitet futbollit, pastaj shtuam një aktivitet për qitje, vazhduam me mundjen, atletikën deri sa arritëm të bëmë me dhjetëra aktivitete në rang ushtrie. Këto ishin shumë të guximshme për kohën dhe duhej patjetër të njiheshin disa koncepte, sepse kishte edhe mosbesim, duke filluar nga drejtori, të cilin i dukeshin shumë.

Ishte bërë një stërvitje në Laç dhe e gjithë Drejtoria Operative kishin shkuar aty, unë ndiqja kampionatin e futbollit në atë kohë dhe 5-garëshin ushtarak në Korçë. Në Korçë shkuan edhe rreth 200 veta, që duheshin sistemuar në vendin ku do të bëheshin aktivitetet: futbollit veç, 5-garëshi ushtarak veç, ndërsa notin e bëmë në Prespë. Unë nuk kisha qenë në Prespë, s'kishte ujë ku të bënim notin, noti ishte element i 5-garëshit. U nisëm me autokolonë të rregullt dhe i çuam në Prespë. Kur hipëm në qafë, që dukej në njërin krah fusha e Korçës dhe në krahun tjetër dukej honi i Prespës pak me mjegull. Ishte një pamje magjike, u çuditëm me bukuritë që ka Shqipëria, aq sa një ushtar i cili ishte nga Vlora u shpreh: "O shef, por unë mendoja që vetëm Vlora ishte e bukur, por qenka e gjithë Shqipëria!", - "Po ne prandaj ju sjellim nëpër aktivitete, që edhe stërviteni, por edhe të shihni se kemi Atdheun më të bukur!", - i thashë. Dhe me të vërtetë, Atdhe më të bukur se i yni nuk ka. Unë kam parë botën nga sipër, që në vitin 1971, 1972 deri në 1980, kur ishte shumë e vështirë për të dalë jashtë shtetit. Por kur vinim në Shqipëri, s'kishte vend më të bukur se Shqipëria, ka qenë si e qëndisur, s'kishte tokë pa punuar, madje edhe sot duken gjurmët... Duhet të jemi krenar për këtë vend që kemi!

Edhe ne krenohemi me njerëz si ju, për vlerat dhe kontributet të cilat na kanë bërë krenarë dhe dinjitozë në botën skeptike, për vendin e vogël gjeografikisht, por të madh në vlerat që rrit!
Ju urojmë jetë të gjatë, shëndet e gjithë të mirat në familjen tuaj!
Faleminderit!

INTEGRIMI I STANAG/AP-VE

në botimet doktrinare, faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit të ndërveprimit në FA dhe vendet e Aleancës së NATO-s



MAJOR (R) MSC. AGRON BUKAÇI

Integrimi i STANAG/AP-ve në botimet doktrinare, manualët dhe rregulloret e strukturave të FA-së merr rëndësi të veçantë, sepse vendos standarde të reja veprimi në përputhje me zhvillimet aktuale, të së ardhmes në të gjitha komponentët, kjo do t'i shërbente qëllimit të arritjes së ndërveprimit me Aleancën, mbajtjen në nivelet e kërkuara të ndërveprimit në fushat operacionale, materiale dhe administrative midis llojeve të forcave në FA, si dhe me forcat e shteteve të tjera të Aleancës së NATO-s. Rritja e nivelit të ndërveprueshmërisë, është qëllimi përfundimtar i standardizimit, ku vendet e Aleancës të punojnë me njëri-tjetrin, duke përdorur mjete të teknologjisë të lartë dhe të njohura nga të gjithë anëtarët e Aleancës. Integrimi i STANAG/AP-ve në botimet doktrinare, manualët dhe rregulloret e strukturave të FA-së, do të vlerësohej si realist, nisur nga niveli i evidentimit, niveli i ratifikimi të STANAG/AP-ve si dhe nga niveli i zbatimi i këtyre STANAG/AP në FA të RSH. Këto STANAG/AP në vetvete përmbajnë standarde të pranuar për t'u zbatuar nga vendi ynë në të cilat përfshi-

Integrimi i STANAG/AP-ve duhet t'i shërbejë stërvitjes, ku nëpërmjet krijimit dhe zgjerimit të kapaciteteve ushtarake në FA në të gjithë spektrin e misionit të saj, të sigurojë integrimin efektiv e të ndërveprueshmëm brenda forcave të veta dhe me forcat e vendeve aleate në operacione në përgjigje të krizave të drejtuara nga NATO.

hen 9 komponentët e kapaciteteve operacionale të deklaruar për Aleancën, si: Doktrina, Organizimi, Stërvitja, Materialet, Pajisjet, Udhëheqja, Edukimi, Personeli, Infrastruktura.

Integrimi i STANAG/AP-ve duhet t'i shërbejë stërvitjes, ku nëpërmjet krijimit dhe zgjerimit të kapaciteteve ushtarake në FA në të gjithë spektrin e misionit të saj, të sigurojë integrimin efektiv e të ndërveprueshmëm brenda forcave të veta dhe me forcat e vendeve aleate në operacione në përgjigje të krizave të drejtuara nga NATO. Përcaktimi dhe standardizimi i radhës së punës për komandat e Forcave/Drejtoritë në SHPPFA dhe repartet mbështetëse të FA-së në iniciimin, dhe përgatitjen e gjithanshme për integrimin e STANAG/AP-ve në botimet doktrinare, manualët dhe rregulloret e këtyre strukturave të FA-së, më qëllim që doktrinën, manualët dhe rregulloret e përgatitura nga grupet e punës të ngritura nga vetë këto struktura të jenë në përmbajtjen e tyre sa më përafërta me

doktrinën, manualët dhe rregulloret e vendeve anëtare të NATO-s, dhe me vlera produktive dhe aplikative të dobishme, në funksion të misionit të FARSH-së.

Çfarë kuptojmë me termin standardizim, sipas konceptit të Aleancës së NATO-s?

Aleanca e NATO-s e përkufizon një STANAG si një "dokument, i krijuar me konsensus dhe i miratuar nga një organ i njohur, që ofron për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, rregulla, udhëzime ose karakteristika për aktivitetet ose rezultatet e tyre, që synojnë arritjen e shkallës optimale të qëllimit në një kontekst të caktuar". Ka shumë STANAG që mbulojnë një gamë të gjerë temash, duke përfshirë komunikimin, logjistikën, inteligjencën, trajnimin etj., për shembull STANAG 4586, përcakton standardet për ndërveprimin e sistemeve të të dhënave ushtarake.

Marrëveshja e Standardizimit të NATO-s (STANAG) luan një rol jetik në suksesin dhe efektivitetin e Aleancës së NATO-s, duke lehtësuar ndërveprueshmërinë dhe

përputhshmërinë midis forcave ushtarake të vendeve anëtare dhe është një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit, si dhe për arritjen e nivelit të kërkuar të sigurisë dhe besueshmërisë së pajisjeve ushtarake. Aftësia për të punuar së bashku në mënyrë efektive dhe efikase është themeli i suksesit të NATO-s, duke i dhënë Aleancës forcë dhe aftësi të pjesëve të saj. Për të kryer operacione shumëkombëshe, vendet duhet të ndajnë një sërë standardesh të përbashkëta, rregulla ose udhëzime që sigurojnë mirëkuptim të ndërsjellë dhe funksionalitet praktik që mbulojnë çdo gjë, nga përmasat e municioneve, mjetet e blinduara, tanket, avionët, logjistika, ndërlihdja e deri te gjuha e komunikimit që trupat përdorin për të komunikuar me njëri-tjetrin.

Qëllimi i STANAG-ve

“Qëllimi i STANAG-ve është të lehtësojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet vendeve anëtare të NATO-s, veçanërisht në kohë krize ose konflikti”. Standardizimi i NATO-s është zhvillimi dhe zbatimi i koncepteve, doktrineve dhe procedurave, për të arritur dhe ruajtur nivelet e kërkuara të përputhshmërisë, këmbyeshmërisë ose të përbashkëtave të nevojshme për të arritur ndërveprueshmërinë. Aleanca e NATO-s, ku bën pjesë edhe vendi ynë është një Aleancë politiko-ushtarake e themeluar mbi vlera të përbashkëta dhe e bazuar në konsensusin e vendeve anëtare të saj. NATO, për të përmbushur misionin e saj si strukturë e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive, punon vazhdimisht për arritjen dhe zbatimin e politikave, ngushtësisht dhe në mënyrë korrekte midis strukturave, forcave dhe burimeve kombëtare, shumëkombëshe dhe të vendeve anëtare. “Marrëveshja e Standardizimit të NATO-s (STANAG) është një grup standardesh dhe proce-

durash që përdoren nga vendet anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) për të garantuar ndërveprimin dhe përputhshmërinë midis forcave të tyre ushtarake, me synim përfundimin e një detyre ose një serie detyrash”. Kjo i ndihmon ata që janë të përfshirë në detyrë të kuptojnë mënyrën më të mirë për ta përfunduar atë. Standardizimi u lejon vendeve të ndryshme të punojnë me njëri-tjetrin, duke përdorur mjete të një standardi dhe të njohura nga vendet e përfshira në operacion.

Standardizimi ndihmon forcat e aleatëve dhe partnerëve të NATO-s të arrijnë ndërveprueshmërinë, duke lejuar përdorimin më efikas të burimeve të mbrojtjes, si dhe duke rritur efektivitetin operacional të Aleancës. Në terma praktikë, standardet u mundëso-

Standardizimi

Standardizimi është procesi i zhvillimit, promovimit dhe mundësisht detyrimit të teknologjive dhe proceseve të bazuara në standarde dhe të përputhshme brenda një industrie. Standardet e teknologjisë fokusohen në sigurimin e cilësisë, qëndrueshmërisë, përputhshmërisë, ndërveprueshmërisë dhe sigurisë.

Standardizimi përfshin normalizimin e qasjeve të personalizuar më parë ose të ndryshme ndaj proceseve dhe teknologjisë.

Ai ofron rregulla, procese, udhëzime, shabllone, statistika dhe të dhëna të tjera për të vendosur dhe zbatuar cilësi dhe konformitet të qëndrueshëm në mënyrën se si duhet të ndodhin aktivitetet specifike brenda një mjedisi. Standardet përdoren pothuajse me të gjitha teknologjitë, ata



jë njerëzve nga një shumëllojshmëri e gjerë vendesh të ndryshme të kenë pajisje të përputhshme, të kuptojnë metodat dhe procedurat e njëri-tjetrit dhe të funksionojnë pa probleme edhe nëse sapo kanë filluar të punojnë së bashku. Kjo quhet ndërveprueshmëri, që është edhe qëllimi përfundimtar i standardizimit.

sigurojnë që të gjithë lojtarët në një industri të ndërtojnë produkte dhe shërbime dhe të kryejnë aktivitete në mënyrë të vazhdueshme dhe në përputhje me rregullat dhe udhëzimet specifike. Standardizimi është inovacion, duke e konsideruar të tillë ka sjellë dhe do të sjellë risi në FA, duke rritur kështu performancën e strukturave

tona të FA.

Në këtë kontekst, ndërveprimi dhe standardizimi i forcave të vendeve të Aleancës për misione të përbashkëta përbën një çështje të rëndësishë prioritare. Duke qenë se Aleanca përbëhet nga 30 vende anëtare dhe se ajo shkon në operacione edhe së bashku me vendet të tjera të iniciativës PfP dhe partnerë të tjerë globalë, një nga elementet kryesore të suksesit të saj edhe në të ardhmen mbetet ndërveprimi i forcave ushtarake në operacione. Aleatët duhet të jenë të ndërveprueshëm me njëri-tjetrin dhe, kur kërkohet kjo me vendet partnere, me shtetet e tjera, si dhe me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare dhe departamentet tjera qeveritare (departamente jo të mbrojtës) e bazuar në doktrinat dhe rregullat e përbashkëta të vendeve anëtare të saj.

Ky ndërveprim i forcave të Aleancës arritet nëpërmjet procesit të përafrimit nga vendet anëtare të saj në fushën e doktrinae, të organizimit, të trajnimit dhe stërvitjes, të arsimimit, të pajisjeve dhe sistemeve, strukturave dhe infrastrukturave, si dhe aspekteve të shumta të veprimtarisë së Aleancës.

Arritja e objektivave të Aleancës varet gjithnjë e më shumë nga bashkëpunimi si një nga rrugët kryesore për arritjen e ndërveprimit të forcave të vendeve të NATO-s të cilat realizohen nëpërmjet procesit të standardizimit.

Një përshkrim i përgjithshëm për standardizimin dhe gjithçka e procesit në FA

Procesi i standardizimit në FA të RSH është procesi nëpërmjet të cilit FA-të zhvillojnë dhe mbajnë kapacitete operacionale të ndërveprueshme midis forcave dhe njësisve të tyre si dhe me njësitë e vendeve të NATO-s në fushat e operacioneve, të procedurave, të materialeve si dhe ato teknike dhe administrative. Në këtë kontekst, standardizimi është një nga shtyllat kryesore të suksesit të operacioneve të FA dhe i operacioneve të drejtuara nga Aleanca.

Është synuar zhvillimi i një sistemi funksional të standardizimit në FARSH. Nëpërmjet këtij sistemi eficient të stand-



Çfarë kuptojmë me termin standardizim, sipas konceptit të Aleancës së NATO-s?

Aleanca e NATO-s e përkufizon një STANAG si një “dokument, i krijuar me konsensus dhe i miratuar nga një organ i njohur, që ofron për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, rregulla, udhëzime ose karakteristika për aktivitetet ose rezultatet e tyre, që synojnë arritjen e shkallës optimale të qëllimit në një kontekst të caktuar”.

ardizimit në FA synohet që të orientohen autoritetet e komandim-drejtimit dhe komunitetin e standardizimit në FA, për zbatimin e rregullave standarde të përbashkëta në procesin e inicimit, vlerësimit, ratifikimit, zbatimit dhe rishikimit të standardizimit në FA, sipas përvojës në interes të realizimit të misionit të FA-ve si dhe arritjen e një ndërveprueshmërie sa më të mirë me vendet e Aleancës.

Standardizimi është një proces kompleks dhe gjithëpërfshirës. Për ta zhvilluar në mënyrë të konsoliduar standardizimin në FA është e domosdoshme një bazë ligjore, ku do të bazohet ecuria e procesit të standardizimit në FA.

Dokumenti bazë në nivelin e zhvillimit të politikave të standardizimit për ngritjen e një sistemi funksional të standardizimit në FA është Direktiva e Standardizimit në FA, e miratuar nga Ministri i Mbrojtjes. Direktiva e Standardizimit në FA bazohet në Politikën e NATO-s për Standardizimin, në kuadrin ligjor dhe dokumentet bazë kombëtare të standardizimit. Direktiva e Standardizimit në FA shpreh qëllimin, objektivat dhe përparësitë e standardizimit në FA për arritjen e standardizimit në fushën operacionale, materiale dhe administrative. Ajo orienton gjithashtu komponentët e saj, fushat kryesore, nivelet, si dhe statuset e standardizimit të pranuar në FA. Dhe së fundi, ajo jep strukturat përgjegjëse të përhershme dhe ad-hoc, si dhe detyrat e tyre në funksionimin e sistemit të standardizimit.

Përafrimi me standardet e NATO-s do të arrihet nëpërmjet ratifikimit, pranimit dhe zbatimit të STANAG/AP-ve, ratifikimi dhe pranimi i çdo STANAG/AP për t'u zbatuar

në FA shoqërohet me implikime në personel, në doktrina, manuale dhe rregullore, në strukturat e FA-së, infrastrukturës, trajnimit, pajisjeve dhe sistemeve.

Procesi i standardizimit në FA ka kaluar në disa faza vit pas viti. Në vitin 2009 filloi ngritja e sistemit të standardizimit në FA të RSH, për këtë qëllim u ndërmorën disa hapa si: U përgatit dhe u miratua Direktiva e Standardizimit, Manuali i Standardizimit në FA; U ngritën strukturat dhe filloi trajnimi i personelit, i cili do të menaxhonte procesin e standardizimit në FA; U miratua ngritja e Bordit të Standardizimit në FA; U bënë plane vjetore dhe afatmesme 2009-2015, ku u planifikua miratimi i një pakete prej 200 STANAG/AP prioritar.

Viti 2010 shënon fillimin e ratifikimit dhe zbatimit të STANAG/AP-ve, ku u parashikua ratifikimi i 30 STANAG/AP-ve prioritar për FA-të, ku prioritet ka qenë ratifikimi i STANAG/AP-ve që lidhen me Objektivat Afatmesme të Forcës (FG) dhe të Grup Batalionit për pjesëmarrje në operacionet e drejtuara nga NATO.

Procesi i standardizimit në FA ka vazhduar ecurinë e tij vit pas viti, duke ratifikuar STANAG/AP nga Bordi i Standardizimit në FA bazuar në kërkesat e strukturave të FA për ratifikim të STANAG/AP-ve në interes të përbushje së misionit të tyre.

Sistemi i standardizimit në Forcat e Armatosura dhe komponentët e tij:

- Komponentët e sistemit të standardizimit
- Nivelet e standardizimit në FA
- Fushat e standardizimit
- Statuset e ratifikimit të STANAG/AP-ve
- Zgjerimi i informacionit
- Zbatimi dhe rishikimi i STANAG-ut
- Gjuha e STANAG/AP-ve

LOGJISTIKA E KONTESTUAR



KOLONEL ARBEN DHULI, IKSHU

Termi logjistikë e kontestuar nënkupton që ushtria amerikane dhe partnerët e saj u mësuan me logjistikën e pa-kontestueshme gjatë periudhës së konfliktit të armatosur pas 11 shtatorit. Logjistika e kontestuar, në fakt, nuk është asgjë e re. Përkundrazi, është gjendja standarde e logjistikës në konfliktet e armatosura në shkallë të gjerë midis shteteve të industrializuara; nocioni se logjistika mund të mos kontestohet është një tjetër ndikim negativ i luftërave të pas 11 shtatorit në të menduarit ushtarak.

Sigurisht, heqja e linjave të furnizimit nga gjenerali William Sherman gjatë Luftës Civile në SHBA është një shembull i logjistikës së kontestuar në nivel kontinental. Në shkallë globale, ushtria gjermane përdori luftë të pakufizuar me nëndetëse dhe metoda të tjera, gjatë Luftës së Parë Botërore kundër Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj për të prishur logjistikën strategjike. Më tej, gjatë Luftës së Dytë Botërore, në betejën për kontrollin e Oqeanit Atlantik, në të cilën personeli dhe pajisjet ushtarake të vendosura në Afrikën e Veriut dhe Evropë luajtën një rol kritik në logjistikën e kontestuar. Më tej, gara ndërmjet Aleatëve dhe Boshtit për kontrollin e Detit Mesdhe ishte një çështje e rëndësishme për fitoren përfundimtare të aleatëve në Afrikën e Veriut, Itali dhe luftën në tërësi.

Në thelb, kontrolli i Mesdheut ishte jetik për të dy koalicionet kundërshtarë si një rrugë thelbësore tranziti në një luftë globale. Për aleatët, ajo ishte një arterie jetike midis lindjes dhe perëndimit, duke lejuar një metodë relativisht të shpejtë dhe efikase të transferimit të njerëzve dhe materialeve midis teatrove të ndryshëm të luftës. Për fuqitë e Boshtit, duke hequr kontrollin e Mesdheut nga aleatët, apo edhe thjesht duke e kontestuar atë.

Rezultati i fitores së Boshtit në Mesdhe do të ishte kufizimi i një prej pikave më të forta të Aleatëve: lëvizshmëria e tyre globale. Është e rëndësishme të kuptohet se logjistika e kontestuar nuk është një rrudhë e re e luftës moderne, por një problem me të cilin planifikuesit, strategët dhe industria kanë luftuar në të gjithë thellësinë dhe gjerësinë e konfliktit të armatosur.

I vetmi ndryshim domethënës sot nga koha në të cilën U-skaftet gjermane ecnin në Oqeanin Atlantik, për shembull, janë teknologjitë e disponueshme për të zbuluar lëvizjet e logjistikës, dhe përkatësisht, teknologjia e disponueshme për të goditur rrjetin logjistik të një shteti nga një rreze e gjerë. Më tej, sukcesi në Jugun Amerikan, Atlantik dhe Detin Mesdhe duhet të sigurojë pikënisjen nga e cila mund të identifikohet problemi që koncepti bashkëkohor i logjistikës kontestuese po përpiqet të zgjidhë. Vetë problemi - si të kryhet logjistika në distanca të mëdha në një mjedis në të cilin një luftëtar armik po përpiqet në mënyrë aktive ta mohojë atë përpjekje - ka zgjidhje teknologjike dhe zgjidhje jo-teknike.

Ky artikull nuk synon të japë përgjigje për logjistikën e kontestuar, por përkundrazi të ofrojë informacion që nxit individët me mendje të njëjtë të mendojnë për problemin në mënyrë holistike. Së pari, ai shqyrton problemet që lidhen me logjistikën e kontestuar. Këto probleme fokusohen në sfidat e paraqitura nga kërcënimi, nga mjedisi dhe nga vetja. Në shqyrtimin e këtij problemi, artikulli përdor një dislokim imagjinar të Divizionit të Parë të Kalorësisë së Ushtrisë për të ndihmuar në ilustrimin e ideve në të. Së dyti, artikulli shqyrton veçantinë e operacioneve ushtarake të SHBA-së në lidhje me veprimin në një mjedis të kontestuar. Ai zbulon se logjistika e siguruar është një nënprodukt i lëvizjes së siguruar dhe të dy këta elementë janë konsiderata kryesore kur shqyrtohet logjistika e kontestuar.

Së treti, ky artikull ofron një pasqyrë të asaj që drejtuesit e lartë të Ushtrisë thonë se janë konsiderata të rëndësishme për të vepruar në fushat e ardhshme të betejës, në të cilat logjistika nuk është aspak e sigurt. Së fundi, ky artikull përfundon me një pyetje të përgjithshme për të ndihmuar në ofrimin e një abetare për ata që janë të interesuar të kuptojnë sfidat e logjistikës kontestuese dhe çfarë mund të kërkohet për t'i kapërcyer ato. Koncepti i logjistikës së kontestuar përpiqet të zgjidhë një sërë sfidash që mund të kategorizohen si sfida të kërcënimit,

mjedisit dhe vetvetes. Nga pikëpamja e kërcënimit, përpjekjet e kontestuara të logjistikës për të trajtuar aftësitë sulmuese dhe synimet e panjohura të një luftëtari armik. Si rezultat, logjistika e kontestuar varion nga administrimi i sigurt i prodhimit të stacioneve shtëpiake deri tek shpërndarja përpara tek ekipet e integruara të tankeve dhe këmbësorisë njerëzore-makinë në vijat e para të fushëbetejave të ardhshme. Për më tepër, logjistika e kontestuar duhet të llogarisë të ardhmen e luftës, në të cilën mençuria konvencionale sugjeron se grupet e pasura të sensorëve, zjarret me rreze të gjatë, goditjet precize dhe dronët e të gjitha llojeve dhe qëllimeve do të mbizotërojnë fushën e betejës. Ose, duke e inkuadruar këtë ide, duke përdorur zhargonin e modës të ushtrisë, logjistika e kontestuar duhet të marrë parasysh tiparet dhe sfidat e një fushëbeteje transparente.

Nga pikëpamja mjedisore, logjistika e kontestuar kërkon të kapërcejë tiraninë e distancës dhe kostot e lidhura me të. Dërgimi i një divizioni të blinduar si Divizioni i Parë i Kalorësisë ose Divizioni i Parë i blinduar në të gjithë globin është përdorim intensiv i burimeve, kërkon kohë intensive dhe është i ngadalshëm. Më tej, lëvizje të tilla sigurojnë një luftëtar vigjilent armik me një pararojë të aktiviteteve të ardhshme ushtarake dhe skemën përmes së cilës forcat amerikane mobilizohen, dhe nisen për konflikt të armatosur. Shkurtimisht, armiku merr inteligjencë që mund t'i përdorë për qëllime shënjestrimi në çdo moment gjatë procesit. Mjedisi pasqyron sfidat që kanë të bëjnë me veten. Një forcë e dislokuar nën një fushëbetejë transparente, në të cilën kërcënim i posedon zjarre me rreze të gjatë, mbikëqyrje të pandërprerë dhe aftësi për të goditur me saktësi forcat e Ushtrisë në çdo moment përgjatë mobilizimit deri në nisjen e teatrit, kërkon shumë aftësi të pavarura. Fillimisht, kjo forcë kërkon aftësi mbrojtëse që nuk gjenden normalisht brenda formacioneve taktike, për të përfshirë një sërë sitemesh kibernetike, aftësi të mbrojtjes ajrore dhe mjete mashtrimi për të ndihmuar në mbrojtjen, maskimin dhe mbulimin e lëvizjes së saj përgjatë shtegut të rrezikshëm nga pikënisja deri te hipja në teatër.

Prandaj, është e kujdesshme që ushtria amerikane të gjejë mënyra dhe mjete për të anashkaluar veprimet kundërshtarë për të ndërprerë procesin e tubacionit logjistik. Zhvillimi i metodave për të gjeneruar vetë furnizimet bazë - ushqim, ujë, karburant, municione, furnizime mjekësore, pjesë riparimi - është hapi i parë në këtë proces. Më tej, zhvillimi i lëndëve djegëse jo-fosile për të fuqizuar pajisjet ushtarake është një hap tjetër racional. Përveç burimeve alternative të karburantit, zhvillimi i burimeve të karburantit të rinovueshëm dhe të rikarikueshëm është një mënyrë tjetër për të shmangur sfidat e orientuara nga karburantet fosile. Pavarësisht se sa racionale janë shumë nga këto ide, sfidat e shndërrimit të ideve në aftësi, d.m.th., gjëra që mund t'i bëjnë idetë realitet, nuk janë të parëndësishme.

Në thelb, logjistika e siguruar supozon se industria mund të

qëndrojë në krah të kërkesës, dhe për këtë arsye, problemi thelbësor është ai i lëvizjes. Prandaj, ushtria amerikane ka nevojë për lëvizje të sigurt nga Shtetet e Bashkuara kontinentale, përgjatë linjave ajrore, tokësore dhe detare të furnizimit. Kjo është lëvizje ndër-teatrore. Brenda një teatri konflikti, lëvizja e sigurt është aftësia për të lëvizur në distanca operacionale dhe taktike, dhe gjithashtu varet nga linjat ajrore, tokësore dhe detare të furnizimit. Kjo është lëvizje brenda teatrit.

Lëvizja në një mjedis kontestues nuk mund të kryhet në mënyrë të izoluar. Për sa i përket aftësive (d.m.th., gjërave të prekshme), lëvizja në mjedise kontestuese kërkon mbrojtje dhe tepëri për të siguruar transport të sigurt nga pika A në pikën B. Në teori, mbrojtja mbetet konstante midis lëvizjes ndër- dhe infra-teatrore; megjithatë, në praktikë, ato ndryshojnë. Për lëvizjen ndër-teatrore, linjat e gjata të furnizimit dhe anijet që transportojnë mallra, duhet të mbrohen nga sulmet me shumë fusha. Në mënyrë të veçantë, këto linja furnizimi duhet të mbrohen nga sulmet kibernetike, efektet kumulative të një rrjeti të gjerë multimodal, multidomain, sensor-qitës dhe kundër sulmeve të orientuara nga gërryerja nga toka, deti dhe ajri, pavarësisht nga platforma aktuale që jep goditjen.

Për lëvizjen brenda teatrit, linjat e furnizimit mund të jenë ende të gjata, por, si rregull, ato janë dukshëm më të shkurtra se ato në nivelin ndër-teatror. Për më tepër, municionet e shkëlqyera janë të shtrenjta dhe shpesh me mungesë. Prandaj, ata kanë më pak gjasa të bashkëveprojnë me formacione taktike. Si rezultat, mbajtja e logjistikës së sigurt përmes lëvizjes kërkon sisteme me shumë domene, por ato të orientuara në mënyrë specifike për të vepruar në hapësira më të ngushta.

Për sa i përket formave të funksionimit, lëvizja në mjedise kontestuese kërkon zbulim, mashtrim dhe ndërhyrje. Këto ide nuk janë të reja, ato kanë qenë bazat e operacioneve ushtarake në mjedise të kontestuara për aq kohë sa forcat ushtarake kanë luftuar kundër forcave të tjera ushtarake. Megjithatë, teknologjia dhe metodat e përdorura duhet të evoluojnë për të mbajtur ritmin me gjurmën që kanë operacionet me shumë domene në aktivitetet moderne (dhe të ardhshme) ushtarake. Zbulimi dhe ndërhyrja, për shembull, nuk është më një formacion kalorësie që vepron përpara një force tokësore dhe që përpiket të identifikojë rrugë të sigurta, të lokalizojë formacionet kundërshtarë dhe të kryejë zjarre ngacmuese dhe mashtrime për të ndërhyrë në planin e një armiku. Sot, zbulimi, mashtrimi dhe ndërhyrja duhet të hyjnë në dhe përmes rrjetit të gjerë të sensorëve të kundërshtarit. Ai duhet të punojë në mënyrë kohezive përgjatë një shtegu përmes rrjetit të sensorëve të armikut për të gjeneruar informacion të korruptuar dhe të gabuar, për të bërë që kundërshtari të dyshojë në të dhënat që ata marrin nga rrjeti i tyre. Nga ana tjetër, ky dyshim do të ndihmojë në ngadalësimin e vendimmarrjes dhe operacioneve të lidhura me kundërshtarin, duke mbrojtur kështu lëvizjen logjistike.

Nëse elementi i lëvizjes mund të hiqet ose të reduktohet nga



ekuacioni, atëherë aftësia e një kundërshtari për të kontestuar logjistikën zvogëlohet, ndërsa aftësia e një force të ushtrisë për të operuar pa ngarkesë rritet, duke i bërë operacionet e tyre më efikase dhe më të vlefshme për komandantët për të cilët ata shërbejnë. Heqja ose zvogëlimi i kërkesës për lëvizjen e logjistikës nga nyja në nyje mund të tejkalohet duke zhvilluar metoda për të krijuar nevoja logjistike në vend, ose të paktën më afër pikës së nevojës. Prandaj, hulumtimi duhet të fokusohet në atë se si ta bëjmë atë realitet. Përveç sistemeve krejtësisht të reja të armëve - d.m.th., tanke, automjete luftarake etj., - shumë lloje të furnizimeve teorikisht mund të jenë në gjendje të prodhohen në skajin taktik të konfliktit, duke reduktuar kështu kërkesën për t'i lëvizur ato.

Shumë drejtues të ushtrisë e kanë kategorizuar logjistikën e kontestuar si një nga sfidat më të mëdha luftarake me të cilat do të përballlet ushtria amerikane në konfliktin e armatosur të ardhshëm. Përpara se të vazhdohet, një paralajmërim i rëndësishëm për t'u marrë parasysh është se megjithëse një pjesë e madhe e dialogut në lidhje me logjistikën e kontestuar është e përqendruar në Kinë, sfida vlen për çdo kërcënim që është në gjendje të godasë njëkohësisht: (a) të godasë Shtetet e Bashkuara; (b) ndërprerjen e lëvizjes së personelit, pajisjeve dhe logjistikës tjetër nëpërmjet ajrit, detit dhe tokës; (c) mohimi i aftësisë së SHBA-ve për të operuar portet dhe fushat ajrore; (d) mohimi i aftësisë së SHBA-ve për të kryer hyrje të përbashkët me forcë; dhe (e) shënjestrimin e nyjave logjistike të SHBA-ve dhe linjave të komunikimit kur janë në teatër. Kështu, logjistika e kontestuar nuk është vetëm një problem i Kinës, apo në të vërtetë ndonjë sfida specifike teatri-aktor. Përkundrazi, është një sfida e bazuar në aftësi dhe qëllime.

Ushtria amerikane - për të përfshirë ushtrinë - është ekspeditare. Prandaj, në thelb posedon tubacione të gjata furnizimi. Këto tubacione, nga vendet e prodhimit të njësitë taktike në vijën e parë të luftimit, janë dobësi kritike në një mjedis të kontestuar. Kundërshtarët inteligjentë, veçanërisht duke lëvizur në të ardhmen, do të përdorin rrjetet globale të sensorëve për të identifikuar vendndodhjet e prodhimit të logjistikës, pozicionet modale të transportit, rrugët drejt dhe nga ato nyje dhe vendndodhjet specifike të imbarkimit për teatrin. Për më tepër, kundërshtarët që zotërojnë aftësitë dhe synimet mund të sulmojnë kudo, ose ndoshta edhe kudo, përgjatë atij tubacioni të gjatë logjistik. Kështu, forcat e ushtrisë, si dhe politikë bërësit, praktikuesit e tjerë ushtarakë dhe studiuesit duhet të vazhdojnë të eksperimentojnë me idetë, si dhe me forcat nocionale dhe materialet e mundshme, për të reduktuar dobësitë kritike që ekzistojnë brenda tubacionit logjistik. Siç u përmend më parë, drejtuesit e ushtrisë tashmë po punojnë për të zhvilluar zgjidhje të lidhura me teknologjinë për disa nga sfidat e logjistikës së kontestuar. Për ata që nuk janë të angazhuar drejtpërdrejt në punën e vazhdueshme të Ushtrisë në logjistikën e kontestuar, të menduarit se si të adresojnë logjistikën e kontestuar mbetet një mekanizëm i zbatueshëm për ndihmën "nga poshtë-lart" ose ndoshta edhe anësore. Pyetja e mëposhtme, siç u përmend më lart, është e dobishme në këtë përpjekje: Si e sigurojnë logjistikën ushtria dhe forcat ushtarake shtetërore partnere, në një mjedis kundërshtar të dominuar nga aftësia e gjithë-pranishme për të identifikuar globalisht dhe më pas sulmuar ato objektiva pothuajse realisht në kohë, nga territori i mbrojtur dhe/ose sovran i kundërshtarit, duke e bërë kështu problematik kundërsulmin strategjik?

“Proxy”, një komponent i nënvlerësuar i luftës



KOLONEL HYSNI GJERGJI

“Një luftë, është një konflikt i armatosur, qoftë konflikt i armatosur ndërkombëtar ose konflikt i armatosur jo ndërkombëtar, kur njëra palë (ose më shumë) përdor një ndërmjetës si forcën e saj kryesore luftarake për të arritur qëllimet e saj strategjike. Brenda luftërave “Proxy”, ekzistojnë pesë marrëdhënie strategjike bazë: shtrënguese, shfrytëzuese, transaksionale, kulturore ose kontraktuale.

*M*egjithëse shpesh anashkalohet ose keqinterpretohet, lufta “proxy” është një komponent i rëndësishëm i konfliktit të armatosur. Politikë bërësit dhe ushtarakët duhet të kuptojnë nuancën e luftës “proxy” për të shmangur gabimet në politikë dhe në praktikën ushtarake luftarake. Një luftë “proxy” mund të

marrë formën e modelit tradicional më të njohur ose të modelit të përhapjes së teknologjisë. Në modelin tradicional, një aktor kryesor “palë e parë” përdor një palë “të tretë” për ashpërsi të luftimit kundër një armiku që është “pala e dytë”. Por në modelin e përhapjes së teknologjisë, një aktor kryesor i siguron agentit të tij financim, armë, trajnime dhe pajisje. Njohja e nënkategorive të luftës “proxy” dhe mos identifikimi i tyre i gabuar si koalicion apo aleancë, është thelbësore për hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe doktrinës. Në shumë raste, lufta me prokurë, ose “proxy” është lënë jashtë diskutimeve të konfliktit të armatosur ndërkombëtar, duke u zhvendosur në konflikt të armatosur jo ndërkombëtar dhe në sferën e aktorëve jo shtetërorë. Kjo shmangie është e pasaktë, sepse ajo anashkalon mënyrat në të cilat aktorët shtetërorë përdorin aktorë të tjerë shtetërorë, përveç aktorëve jo shtetërorë, për t’u përfshirë në luftë me prokurë pra “proxy”.

Ushtritë dhe ekspertët perëndimorë priren ta vendosin luftën me “proxy”, në një kategori jashtë kufijve të praktikës së pranueshme. Në vend të kësaj, ata shpesh e etiketojnë luftën me prokurë një aktivitet të “pisët” të kryer nga aktorë strategjikë dhe cinikë. Lufta ruso-ukrainase në vazhdim u ofron komuniteteve të studimeve të mbrojtjes si dhe studentëve tanë në AFA, apo Kolegjin e Sigurisë, një mundësi për të rishikuar të kuptuarit e tyre të luftës “proxy” dhe për të korrigjuar mospërputhjet. Lufta Ruso-Ukrainase tregon se luftërat “proxy” nuk janë vetëm veprim i aktorëve cinikë, revanshistë që veprojnë përmes aktorëve jo shtetërorë. Përkundrazi, Ukraina është një shembull se si aktorët shtetërorë luftojnë luftërat “proxy” përmes aktorëve të tjerë shtetërorë. Për këtë qëllim, shumë vende perëndimore janë të angazhuara në një luftë “proxy” kundër Rusisë për të mbështetur dhe mbrojtur idealet demokratike, sundimin e ligjit dhe sistemin ndërkombëtar. Megjithatë, për të parë përtej dyshimeve të luftës ndërmjetëse, kërkohet një bazë mbështetëse teorike. Ky punim bazohet në këto dy forma të luftës “proxy” dhe pranon se çdo formë përmban dy nënkategori: aktor shtetëror



dhe aktor jo shtetëror. Shkurtimisht, ky punim i shtohet literaturës ekzistuese mbi luftën “proxy”, duke injektuar katër subjekte të reja të emërtuara dhe të kategorizuara për të kapërcyer mangësitë teorike të luftës me përfaqësues.

Një luftë, është një konflikt i armatosur, qoftë konflikt i armatosur ndërkombëtar ose konflikt i armatosur jo ndërkombëtar, kur njëra palë (ose më shumë) përdor një ndërmjetës si forcën e saj kryesore luftarake për të arritur qëllimet e saj strategjike. Brenda luftërave “Proxy”, ekzistojnë pesë marrëdhënie strategjike bazë: shtrënguese, shfrytëzuese, transaksionale, kulturore ose kontraktuale. Modeli tradicional i luftës “proxy” rezulton kur një aktor kryesor që përdor një “proxy” për ashpërsinë dhe paligjshmërinë e ligjit të luftës, kundër një armiku. Kjo është forma më e zakonshme e luftës me përfaqësues dhe ajo që shumica e njerëzve përfytyrojnë kur përmendet “proxy”. Përdorimi i këshilltarëve luftarakë, veçanërisht në nivelin taktik, është një nga treguesit kryesorë të kësaj forme të luftës me prokurë. Përdorimi nga Irani i grupeve të milicisë shiite me bazë në Irak për të luftuar ushtrinë amerikane gjatë operacionit “Liria e Irakut” dhe operacionit “Vendosja e brendshme”, janë shembuj të fundit të kësaj forme të luftës me përfaqësues. Dy nënkategori ekzistojnë brenda modelit tradicional. Nënkategoria e parë ndodh kur një aktor shtetëror përdor një aktor jo shtetëror si përfaqësues të tij. Nënkategoria e dytë është më pak e zakonshme rezulton nga një aktor shtetëror që angazhon një aktor tjetër shtetëror si përfaqësues të tij, qoftë në mënyrë eksplicite apo të nënkuptuar, për të luftuar kundër një armiku të përbashkët. Mbështetja luftarake shpesh vjen në formën e planifikimit, inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit (ISR), shënjestrit, goditjes dhe logjistikës. Kjo kategori karakterizohet gjithashtu edhe


“ Ushtritë dhe ekspertët perëndimorë priren ta vendosin luftën me “proxy”, në një kategori jashtë kufijve të praktikës së pranueshme. Në vend të kësaj, ata shpesh e etiketojnë luftën me prokurë një aktivitet të “pisët” të kryer nga aktorë strategjikë dhe cinikë. Lufta ruso-ukrainase në vazhdim u ofron komuniteteve të studimeve të mbrojtjes si dhe studentëve tanë në AFA, apo Kolegjin e Sigurisë, një mundësi për të rishikuar të kuptuarit e tyre të luftës “proxy” dhe për të korrigjuar mospërputhjet. Lufta Ruso-Ukrainase tregon se luftërat “proxy” nuk janë vetëm veprim i aktorëve cinikë, revanshistë që veprojnë përmes aktorëve jo shtetërorë.

nga përdorimi i këshilltarëve luftarakë, megjithëse shumë nga ata këshilltarë janë shumë më afër frontit, pra përmbushin një rol të dyfishtë, si këshillues ashtu edhe duke kryer mbështetje luftarake. Modeli tradicional është forma më e zakonshme e luftës me përfaqësues “proxy”. Brenda këtij modeli, ekzistojnë dy nënkategori - njëra në të cilën një aktor shtetëror lufton përmes një aktori jo shtetëror dhe tjetra në të cilën një aktor shtetëror lufton përmes një aktori shtetëror. Është e rëndësishme të mbajmë mend se nënkategoria e aktorit shtetëror/aktorit jo shtetëror mund të ngatërrohet si një koalicion ose një aleancë, por marrëdhëniet e përfaqësuesve dallohen, nga shkalla në të cilën pjesëmarrësit në luftë ndajnë rrezikun taktik. Në situatat në të cilat rreziku i ngarkohet njërit

aktor, dhe aktori (ose aktorët) tjetër mbetet relativisht i pastër nga rreziku, situata ka të ngjarë të jetë një luftë “proxy” dhe jo një koalicion apo aleancë. Modeli i difuzionit të teknologjisë është forma e dytë e luftës “Proxy”. Ky model rezulton nga fakti që drejtuesi i luftës i siguron agjentit të tij financim, armë, trajnime dhe pajisje në vend që të luftojë në mënyrë indirekte përmes përfaqësuesit. Ky model është shpesh reagimi pragmatik i një aktori të palës së tretë ndaj veprimeve të një shteti agresor kundër një aktori më të dobët. Më tej, kjo formë e luftës me “proxy” është e dobishme për principet oportunistë të interesuar të shohin që një aktor shteti kundërshtar të dështojë në një konflikt të palëve të treta. Modeli i përhapjes së teknologjisë shpesh kryhet nga këshillimi luftarak operativ dhe strategjik, por edhe nga përdorimi i këshilltarëve teknikë. Këshilltarët teknikë shpesh veprojnë në vende të palëve të treta dhe trajnojnë dhe edukojnë përfaqësuesin për përdorimin e pajisjeve dhe armëve të furnizuara nga jashtë. Modeli i përhapjes së teknologjisë gjithashtu ka dy nënkategori. Nënkategoria e parë është rezultat i një aktori që i siguron një aktori jo shtetëror financime, armë, trajnime dhe pajisje të tjera për të luftuar një armik, por duke mos marrë një rol aktiv në vetë luftimet. Kjo nënkategori është mjaft e zakonshme. Nga ana tjetër, nënkategoria e dytë rezulton nga parimi që i siguron një aktori tjetër shtetëror financim, armë, stërvitje dhe pajisje të tjera për të luftuar një armik, por jo duke marrë një rol aktiv në luftime. Lufta Ruso-Ukrainase në vazhdim është një ilustrim më i prekshëm i kësaj nënkategorie. Nga pikëpamja e përhapjes së teknologjisë, Shtetet e Bashkuara i kanë ofruar Ukrainës ndihmë ushtarake disa miliardë dollarë që nga shkurti 2022. Deri më 31 maj 2024, Presidenti Biden përsëriti angazhimin e Shteteve të Bashkuara për mbijetesën e Ukrainës dhe, anasjelltas, pengimin e politikës së Moskës që synon në Ukrainë. Për më tepër, këshilltarët luftarakë amerikanë trajnuan ushtarët ukrainas në Gjermani për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve luftarake të ofruara nga SHBA-të, për të përfshirë artilerinë e saj të tërhequr. Gjatë agresionit serb në Kosovë, serbët përdorën “proxy” pasi rekrutuan mercenarë ushtarakë rusë profesionistë kryesisht të ndërlidhjes me radio, si dhe njohës të raketave kundërajrore, që të qëllonin avionët e NATO-s. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare në Beograd, mercenarët rusë dhe paramilitarët serbë të Bosnjës kanë qenë aktivë në rajonin e Rahovecit në Kosovë, gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s më 1999. Gazetari amerikan Roy Gutman, që punonte për gazetën “Newsday” të Nju-Jorkut, raportonte se kishte parë vullnetarë rusë, në vijat e frontit të vrasjeve që u bënë në fshatrat Krushë e Madhe, Piranë, Samodrazhë, Korishë, Bellacërkë, Pustosellë dhe Drenoc. Në prill të 1999 në afërsi të Pashtrikut, UÇK-ja kishte zënë rob dhe ia kishte dorëzuar NATO-s, një mercenar rus. Po ashtu, gazeta e përditshme ruse “Novje Izvestia” raportonte për arritjen e një kufome në Moskë, që ishte trupi i pjetë i rusit 34-vjeçar Fjodor Shulga. Në fund të majit 1999, UÇK-ja ia dorëzoi Kryqit të Kuq kufomën e një mercenari rus, 33-vjeçarit Toger Vitali Bukharin (apo Bulakh). Në Gjakovë, një mercenar rus, pjesëtar i brigadës 549 të motorizuar, ka vrarë tre burra shqiptarë, sipas dëshmisë së nënës së shqiptarit që ishte me kombësi ruse, e cila e kishte kuptuar shumë

Modeli tradicional i luftës “proxy” rezulton kur një aktor kryesor që përdor një “proxy” për ashpërsinë dhe paligjshmërinë e ligjit të luftës, kundër një armiku. Kjo është forma më e zakonshme e luftës me përfaqësues dhe ajo që shumica e njerëzve përfytyrojnë kur përmendet “proxy”.

mirë gjuhën e mercenarit. Njësia më famëkeqe luftarake e mercenarëve rusë që luftuan për serbët ishte “çeta e ujçërve”, e përbërë nga ish-ushtarë të forcave speciale. Këto mercenarë paramilitarë, vrisnin, përdhunonin, vidhnin dhe plaçkitnin familjet shqiptare. Ka rreth 20 mijë denoncime nga gratë e përdhunara kosovare të vdekura dhe të gjalla, si viktime të paramilitarëve serbë dhe rusë. Është theks fakti i fundit, ku, më 3 tetor 2022, një gjykatë në Serbi, kërkon dëmshpërbim në mijëra euro të paramilitarëve serbë “uqërit”, pasi janë diskriminuar në pagesa, gjatë luftës së 1999. Po t’i rikthehemi analizës së sulmit terrorist serb në Banjëckë një vit më parë, ai ishte një “proxy”. Komandoja serbe përdorte armë të ushtrisë serbe, kishte paramilitarë nga komuniteti serb, drejtohej nga një përfaqësues i partisë kryesore serbe, ndërsa presidenti Vucic nuk pranonte kurrësi përfshirjen e Beogradit në këtë aktivitet “proxy”. Grupi prej 49 mercenarësh, nga të cilët aktualisht 37 janë në kërkim ndërkombëtar, vepronte nën pretekstin e mbrojtjes së serbëve etnik, nga “represioni” i qeverisë së Kosovës. Milan Radoičić, ish-nënkryetar i “Listës Serbe”, partisë më të madhe të serbëve të Kosovës që mbështetet nga Beogradi, mori përgjegjësinë për përgatitjen dhe udhëheqjen e grupit të armatosur dhe vazhdon përgatitjet në katër baza të Serbisë për t’u stërvitur që të sulmojë përsëri Kosovën. Është e rëndësishme të theksohet se dhurimi i parave, pajisjeve dhe armëve nuk barazohet domosdoshmërisht me një aktor që angazhohet në luftë “proxy”. E deklaruar ose e padeklaruar, përfshirja e një aktori plotëson kriteret e luftës “proxy” kryesisht bazuar në qëllimin që qëndron pas kontributeve të tij dhe shkallën e mbështetjes së tij. Është gjithashtu e rëndësishme të mbajmë mend se njoftimet për shtyp, dokumentet me burim të hapur dhe doktrinën shpesh errësojnë qëllimin dhe metodat dhe në vend të kësaj fokusohen në komunikimin e një narrative. Për këtë qëllim, për shkak se një aktor shtetëror nuk po përdor shprehjen “luftë me prokurë” nuk do të thotë se ai nuk është i angazhuar në atë aktivitet. Në të dyja rastet, angazhimi i burimeve dhe qëllimi - jo fjalët - janë mënyra më e sigurt për të dalluar nëse një aktor është angazhuar në një luftë me përfaqësues, ose nëse ai



thjesht po i ofron mbështetje një aktori ndërkombëtar në nevojë. Luftërat “proxy” duhet të jenë gjithmonë në krye të studimeve të luftës, sepse ato dominojnë si konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu edhe ato jo ndërkombëtare. Më tej, nuanca e luftës së ndërmjetme është e rëndësishme për t’u kuptuar, sepse keqkuptimet mund të sjellin hapa të gabuar, nga niveli i politikave e deri te niveli taktik i luftës. Duke parë nga e ardhmja, ndërsa sistemi ndërkombëtar vazhdon të mbështetet në një rend ndërkombëtar të bazuar në rregulla, studenti i AFA-së apo i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, duhet të presë të shohë disa tendenca në luftën e ardhshme. Së pari, në rastet kur aktorët e keqdashës shtetërorë tentojnë pushtimin territorial kundrejt një shteti tjetër, duhet parashikuar një përgjigje pragmatike nga aktorët e palëve të treta. Nëse pala e tretë zgjedh një strategji të luftës me përfaqësues, duhet pritur që ajo të përdorë modelin tradicional kundër kundërshtarëve që ajo pret t’i mposhtë relativisht shpejt. Megjithatë, nëse pala e tretë vlerëson një luftë më të gjatë dhe më të kushtueshme, por shkon me një strategji “Proxy”, duhet të parashikohet modeli i përhapjes së teknologjisë. Së dyti, metoda e identifikimit të një përfaqësuesi është më pak një proces përzgjedhjeje sesa është vlerësimi i aktorëve të disponueshëm dhe vlerësimi i aftësisë së dikujt për të krijuar një përfaqësues nga grupet e luftëtarëve, partizanëve ose njerëzve me mendje të njëjtë, duke qenë në gjendje ta shndërrojë atë në një sistem koherent, forcë që mund të vihet në terren për të luftuar një kundërshtar. Në



Modeli i përhapjes së teknologjisë shpesh

kryhet nga këshillimi luftarak operativ

dhe strategjik, por edhe nga përdorimi i

këshilltarëve teknikë. Këshilltarët teknikë

shpesh veprojnë në vende të palëve të treta

dhe trajnojnë dhe edukojnë përfaqësuesin

për përdorimin e pajisjeve dhe armëve të

furnizuara nga jashtë.

shumicën e rasteve, përzgjedhja e përfaqësuesve është pragmatike dhe dinamike - bazohet në mënyrën se si burimet e disponueshme lejojnë zgjidhjen më të shpejtë. Më në fund, studenti i AFA-së apo i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë duhet të presë që luftërat “proxy” të vazhdojnë në një klip të rregullt në ciklin e dhunës që përshkon botën moderne. Lufta “proxy” u ofron politikë-bërësve, strategëve dhe praktikuesve opsione të shpejta, relativisht të lira dhe me rrezik të ulët (për veten) për vazhdimin e synimeve të politikës. Fleksibiliteti i strategjive të luftës me përfaqësues do të thotë se ato do të mbeten në ballë të konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe jo ndërkombëtare për të ardhmen e parashikueshme.

Pushtimi i Kurskut, ndër 3 poshtërimitet e mëdha të Putinit në Ukrainë!



**GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ,
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-N,
ZV/PRESIDENT I KËSHILLIT TË ATLANTIKUT**

Në kapacitetin e Ekspertit në fushën e Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO-s, kam ndjekur me përgjegjësi shtesë dinamikën e 900 ditë/net luftime të përgjakshme në fushëbetëjën për/me Ukrainën: “10-ra konferenca të Këshillit të Atlantikut, Institutit të Luftës dhe panele të ekspertëve/kolegëve elitarë të sigurisë në SHBA, Bruksel, Qendrën Marshall, Gjermani, Londër, Kolegjin e NATO-s Romë; si dhe 3 Samitet e fundit, reciprokisht Madrid-2022, Vilnius-2023, Uashington 2024, etj.”! Përfito nga ky rast, të sjell në vëmendjen publike se në dhjetëra vlerësime strategjike (të publikuara brenda dhe jashtë vendit), në mënyrë konstante në 2.5 vjet çmuar/optimist-izuar se: “herët ose vonë, Rusia-Putiniste do ta humbasë me turp luftën për gjunjëzimin ose pushtimin e Ukrainës martire si dhe përballjen me vlerat perëndimore dhe fuqinë e pamposhtur ushtarake të Aleancës Transatlantike (SHBA/NATO/MB/BE)”!

Dhe fatmirësisht ja ku jemi. Mbas 2 vjet gjysmë përballje stoike, më 6 gusht 2024, ushtria ukrainase ka ndërmarrë një sulm ushtarak (në 42 km front) të paparashikuar në asnjë nga skenarët edhe më optimistë (përfshi autorin), pra: “një sulm ushtarak i organizuar në befasi të plotë strategjike, duke arritur të pushtojë rajonin e Kursk-ut (afërsisht sa sipërfaqja e qytetit të Nju Jorkut ose e qarkut të Tiranës), terror brenda Rusisë që ka shërbyer si nyje me peshë kritike për mbështetjen e makinerisë kriminale të luftës në Ukrainë”.

Mbetet ende herët, për të peshuar rëndësinë e plotë të ndërhyrjes ushtarake të Ukrainës në rajonin e Kurskut, e cila gjithsesi shënon herën e parë që nga Lufta e Dytë Botërore që trupat e huaja kanë pushtuar territor rus. Por, konsideruar edhe reagimin fillestar të Putinit dhe zyrtarë të tjerë të lartë, të cilët po vijnë të sforcohen për të minimizuar peshën e ofensivës së suksesshme të FA-ve të Ukrainës në Kursk, duke e cilësuar atë si: “një sulm terrorist dhe një provokim të armatosur ndaj sovranitetit të Rusisë”, pothuaj të gjithë strategët e pranojnë se pesha gjeostrategjike, tejkalon shumë përtej rëndësisë ushtarake.

Prandaj më duhet po ashtu ta nënvizoj fort, atë çka është konfirmuar edhe nga Kievi Zyrtar, se: “Ukraina nuk ka patur kurrë

dhe nuk ka kurrësi qëllim në vetvete pushtimin e Kurskut dhe as një meter² të territorit të Rusisë, por mbetet në të drejtën e doktrinës së mbrojtjes sovrane që të shkatërrojë (me çdo mjet) si dhe të marrë nën kontroll një nga nyjet nevralgjiqe të infrastrukturës për mbështetjen ushtarake dhe logjistike të armikut (Rusisë – Putiniste) kundër sovranitetit territorial të Ukrainës”.

Gjithsesi, në vijim, po paraqes një përmbledhje strategjike: “pse Pushtimi i Kurskut, përbën një ndër tre turpërimitet, ose 3 poshtërimitet e mëdha që Rusia-Putiniste ka pësuar nga 24 Shkurti 2022 – Gusht 2024”:

Poshtërimi i parë (shkurt-shtator 2022)

Dështimi i sulmit të forcave ruse, ose makinerisë Putiniste u shënua që në nisjen e luftës për pushtimin e Ukrainës. Tërheqja e turpshme e forcave ruse nga rrethinat e kryeqytetit Kiev, në mars 2022, ose në më pak se një muaj pas fillimi të ofensivës neonaziste, u pasua me humbje të tjera ushtarake për Kremlinin, duke përfshirë fundosjen e “nëndetësës Moskva”, ose krenaria e flamurit të Flotës Ruse në Detit të Zi, më 14 prill 2022! Nuk mund të kishte turpërim më të madh për Rusinë sesa humbja e nëndetësës me peshë gjeostrategjike në luftën ndaj një vendi me marinë, ose forca detare të limituara/modeste!

Po në shtator dhe tetor 2022, Ukraina nisi kundërofensivën për të rimarrë iniciativën strategjike të luftës, duke çliruar pjesë të territorit të pushtuar nga Rusia, si rajonet Kharkiv dhe Kherson, të vetëshpallura nga Putini me “referendume nën bajoneta si pjesë jetike e sovranitetit të mëmës Rusi”.

Për më tepër, rezultati i poshtërimit të parë të madh ishte, edhe izolimi dhe diskreditimi i Putinit në arenën ndërkombëtare. Kështu kur Rusia nisi luftën për pushtimin e Ukrainës, më 24 shkurt 2022, vetëm Kim-Jongu dhe 4 shtete terroriste e mbështetën, ndërsa shumica e analistëve besonin se lufta do të përfundonte brenda pak javësh ose maksimumi më 9 maj “fitorja e madhe do celebruhej me lule, kënge dhe valle në Kiev”. Por nga fundi i vitit 2022 (edhe sot), makineria e luftës ruse “po zvarritej/t e përgjakur dhe rraskapitur”, duke pushtuar më pak se 19 % të territorit Ukrainas”. E thënë ndryshe, Rusia nuk dukej/t më e pathyeshme, ndërsa Putini dukej/t edhe me i vockël/shkurtër se sa është në realitet.

Përtej izolimit stalinist, propagandës neo-bolsheveke dhe mendjeve të ndryshkura, jo vetëm në Mosk dhe Beograd, performanca e fuqisë ushtarake ruse që në fundin e vitit 2022 e dobësoi ndjeshëm Putinin.

Ndërsa shumë të zhgënjyer mbetën edhe kleptokratët e Ukrainës, të cilët ëndërronin të ktheheshin në status quo-në e paraluftës. Me fjalë të tjera, Ukraina e ndali me sukses pushtimin e vendit, ndërsa Kremli vazhdoi të izolonte dhe varfëronte vendin, çka shtroi transhenë për poshtërimin e madh të radhës edhe të mbi-Pushtetit të Putinit.

Poshtërimi i dytë (qershor-gusht 2023)

Poshtërimi i dytë i madh i Rusisë - Putiniste nuk erdhi vetëm nga rezistenca stoike e Ukrainës dhe mbështetja e pakushtëzuar e



Nga dorëzimet masive të trupave ruse dhe evakuimi kaotik i civilëve, deri të përparimet e forcave ukrainase më thellë (rreth 25 km) në territorin rus, operacioni Kursk-ut ekspozoi dobësinë jo vetëm të FA-ve dhe të shtetit Rus, por edhe si paralajmërim për fundin e perandorisë së Rusisë – Putiniste. Gjatë sundimit të tij (Putinit) prej rreth çerek shekulli, kontrata e regjimit të Putinit me solidaritetin e shoqërisë dhe kohezionin e kombit rus ka qenë e bazuar në rivendosjen e madhësisë dhe ambicieve perandorake të humbura mbas viteve 1990. Por bashkë me “pushtimin e Kurskut” duket se qeveria/regjimi i Putinit ka (keq) dështuar në përmbushjen e përgjegjësiave themelore të çdo shteti normal: “mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe qytetarëve të tij nga pushtimi i huaj”. Ndërsa fakti që Putini ka ngarkuar një nga ish-truprojtë e tij, Aleksei Dyumin (të cilin mediat ruse e quajnë “ministri i mbrojtjes në hije” i Rusisë), për t’i dhënë fund ofensivës së Ukrainës, demonstroi panikun si dhe fatin e ministrit të mbrojtjes të emëruar së fundmi (Belousov), i cili duket se e (keq) zhgënjeu Kremlinin: “pasi nuk u

Perëndimit, por edhe nga brenda makinerisë kriminale të Kremlinit. Rebelimi në qershor 2023 i Prigozhit dhe ushtrisë së mercenarëve rreth tij (Grupi Wagner), ekspozoi çarje të thella në elitën politike dhe kohezionin të kombit rus rreth luftës; demonstroi kalbëzimin e moralit të ushtrisë si dhe brenda zinxhirit të komandimit të Forcave të Armatosura Ruse.

Fakti që Prigozhin, një mik i ngushtë i Putinit që nga 1990, do të niste një rebelim kundër Kremlinit, ilustroi rreziqet e “politikës së sipërmarrjes”, pra i kalimit të përgjegjësiave të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, aktorëve të sektorit privat, ose oligarkisë Putiniste. Këto struktura paramilitare (jo-zyrtare), do të kishin mirë funksionuar vetëm nëse lideri rus do të vazhdonte të ishte i fortë. Ndërsa ky rast tregoi se Putini ishte i dobët, prandaj situata doli jashtë kontrollit deri sa degradoi te rebelimi i Prigozhinit (Grupit Wagner).

Dhe fakti që Prigozhin mund të mernte kontrollin e qytetit të Rostov-on-Don, për t’u mirëpritur si hero si dhe të marshonte me mercenarët e tij në veri, deri në periferi të Voronezh, afërsisht 300 milje nga Moska, e shpoi edhe më shumë anijen e (pa) plotfuqishmërisë së Putinit.

Prigozhin, natyrisht e pagoi çmimin e rebelimit, duke mbetur i vdekur në një “aksident ajror” së bashku me shtabin e ngushtë (9 vetë), përfshi bashkëthemeluesin e Wagner, Dmitry Utkin, më 23 gusht 2023. Por sipas burimeve perëndimore të inteligjencës, përplasja nuk ishte aksident, por një atentat i mirë-organizuar nga ndihmësi i vjetër i Putinit, Nikolai Patrushev. Sidoqoftë kjo histori i turpëron të dy palët.

Kështu, poshtërimi i dytë i madh i Putinit nuk thelloi vetëm ndarjet në elitën politike dhe qeverisëse të Rusisë të ekspozuara nga mos-pushtimi i Ukrainës, por edhe dobësinë themelore të forcave të armatosura në përmbushjen e misionit kushtetues: “mbrojtjen e atdheut”! Kjo, nga ana tjetër, krijoi terrenin edhe për poshtërimin e radhës, sigurisht më të madhin por jo të fundit të Rusisë - Putiniste.

Poshtërimi i tretë i madh (6 gusht 2024)

Operacioni i pushtimit të rajonit të Kurskut nga FA-të e Ukrainës, ishte i planifikuar dhe u ekzekutua në fshehtësi të rreptë strategjike, duke sjellë edhe një tronditje të madhe për fatet e luftës. Në vend të zhurmës së vazhdueshme të medias (dezinformuese) për disa fitore operacionale të ushtrisë Ruse në Donbas, “New York Times” me sarkazëm pushtimin e Kurskut, e cilësoi si: “mashtim dhe bixhoz i trupave ukrainase”.

tregua në lartësinë e detyrës”!

Gjithsesi, rrethanat, përmasat dhe pasojat ushtarake të sulmit/pushtimit të guximshëm të Kurskut nga Ukraina janë ende të paplota. Mund edhe të rezultojë, siç e komentoi ish-ndihmës sekretari amerikan i shtetit, Daniel Fried: “një George Washington që kapërcen lumin Delaware (1776)”.

Ndërsa në një postim të zgjuar Gjeneral (R) Australian Mick Ryan vuri në dukje se “mbas këtij inkursioni të suksesshëm, Ukraina ka 2 opsione: (a) të përpiqet të mbajë territorin që ka kapur brenda Rusisë (Kurskun), ose (b) të tërhiqet në Ukrainë pasi e ka arritur qëllimit politik për ta poshtëruar epërsinë strategjike të Kremlinit në luftë”. Nga ana tjetër edhe Putini, po përballet me një zgjedhje shumë të vështirë nëse do t’i duhet të tërheqë (siç në fakt po ndodh) trupat tokësore nga fronti në Ukrainën lindore për të rimarrë territorin rus në rajonin e Kurskut?

Pavarësisht skenarëve ushtarakë, dëmi politik është shkaktuar dhe i ka rrënjët jo vetëm te pa-fuqia ushtarake, por pikësisht në politikën neo-staliniste të Kremlinit. Thënë këto, shteti rus “nën pushtimin e Putinit (KGB-së)” ngjason në thelb me tiparet e një organizate të krimit të organizuar, pasi si strategjia, përqsja, armatimet dhe kërcënimet ushtarake, janë po njësoj me ato të një familjeje mafioze. Ndërsa siç njihet momenti më destabilizues si dhe i sjelljes si “bishë e plagosur”, për një bandë kriminale është kur bosi i mafies duket i dobët...!

E parë sa më sipër, e përsërisim se fushëbeteja e Kursk-ut, nga ajo e lavdisë se ushtrisë së kuqe, 81 vite më parë (12 korrik 1943), këtë radhë (6 gusht 2024) do të shënojë jo vetëm fillimin e rrokullimës drejt humbjes turpëruese të luftës që e pret Putinin në Ukrainë (një komb martirësh dhe vend sovran), por edhe të gjunjëzimit dhe poshtërimit në përballjen me fuqinë ushtarake si dhe me vlerat demokratike, kredibilitetin dhe interesat gjeopolitike të Aleancës Transatlantike (SHBA/NATO/BE)!

Në shtesë, do ishte e padrejtë të mos përsëritet përpjekjet relevante të Shqipërisë, si rrjedhojë e përfaqësimit krah SHBA-ve në Këshillin e Sigurimit/OKB; rolin aktiv dhe mbështetjen e pakushtëzuar të vendimmarrjeve të NATO-s, si dhe kontributet më shumë se modeste që RSH i ka dhënë gjatë 30 muajve Ukrainës në këtë përballje “për jetë a vdekje” me të keqen e përbashkët.

Zoti e bekoftë fitoren në Ukrainë, fuqinë ushtarake të NATO-s, vlerat demokratike si dhe ardhmërinë Euroatlantike të Kombit Shqiptar si SHBA dhe gjithë Europa.



“MOSMIRËNJOHJA, thelbi i poshtërsisë”



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Përgjatë itinerarit të jetës sonë, ne përballemi me situata dhe njerëz që nuk njohin skrupuj, narcistë delirantë që veç unit të tyre dhe makutërisë nuk njohin vlera dhe ndjenja solide, siç është dhe një prej më të rëndësishmeve ndjesi humane, mirënjohja.

Mirënjohja, vlerë në zhdukje

Mirënjohja po e humbet forcën e saj, atë vlerë prej së cilës kemi përftuar shumë në të qenit Njeri sot. Sepse mirënjohja nuk është thjesht një akt falënderimi, por mbi të gjitha mirësjelljeje. Për shkak të nxitimit apo mungesës së vëmendjes, por edhe më shumë se kaq, cinizmit duke përdorur rrengje për të përfituar, harrojmë ose

injorojmë atë që është e vlefshme.

Ndryshimet reflektohen dukshëm në shoqërinë e sotme. Dukshëm në ambiente të ngushta, marrëdhënie në komunitet, punë... e më gjërë se kaq në rrjetet sociale. Nis nga përdorimi i një gjuhe tejet të dëmshme, e cila reflekton gjithashtu një ndalesë kulturore. E këtu nuk përjashtohet as emancipimi, një tjetër vlerë që për shkak të rendjes së një modernizimi pa krye, cenohet dhe fundoset çdo ditë.

Po humbasim një varg cilësish të kultivuara herët, mirënjohjen, të ndërtuara mbi ndjenjat bazë që sjellin ngrohtësi, afritet, mbështetje, dashuri dhe lumturi.

Është mirënjohja ajo që na jep një shkëndijë lumturie, një plotësi e madhe që ka të bëjë më të ndjerit i përmbushur.

Edhe lumturia është faktor, aq sa mungesa e saj të të tjetërsojë si individ, e kjo ka si pasojë mungesën e mirënjohjes. Në jetën e përditshme duket se është shndërruar në një fenomen. Nuk ka takt në të shprehurit apo të kërkuarit të asaj që të takon. Ka ndryshuar forma e shprehjes së etikës, sjelljes. Ka vulgaritet që në mënyrën e të menduarit. Ka shumë që, pasi ia hedhin lumit, pengesave apo vështirësive me të cilat jeta i ka përballur, e harrojnë shumë shpejt 'Dorën që i dha mundësinë për t'u ngritur, ringritur...'. Ka nga ata që guxojnë deri aty sa, mbi parimet dhe fjalorin tënd, të të kundërvihet e të të bëjë leksione moralizmesh shoqërore apo profesionale. Shkurt, të të japë mend kur vetë nuk e kanë sasinë e duhur të lëndës. Ka nga ata që thyjnë çdo normë shoqërore, sepse realiteti i ndërtuar nga duart e veta nuk i përmbush, se zgjedhjet e bëra i kanë rezultuar fataliste dhe i duket se e gjitha bota është kundra tij.

Meskinët mirënjohjen e shohin si nënshtrim

Mirënjohja nuk është nënshtrim, është 'akt', është altruizëm kur dikush, qenie hyjnore a tokësore në qoftë ai, të ndihmon pa interes, pikërisht atëherë kur nuk e ke veten në dorë.

Mirënjohja është në nderin e atij që çliron atë dhe nuk e mban të ndrydhur e ngujuar. Pakënaqësitë po e dobësojnë çdo ditë mirënjohjen.

Të jesh mirënjohës është më shumë se një formë edukimi, është një mënyrë për të kapërcyer kufijtë dhe për të arritur një dimension më emocional, personal dhe madje edhe shpirtëror.

Ndaj, pse të mos jemi mirënjohës për jetën që na është dhënë? Pse të mos jemi mirënjohës për çfarë na rrethon? Pse të mos jemi mirënjohës edhe për ata që i kanë këto karakteristika? Dhe përsëri, pse të mos falënderojmë veten për integritetin, guximin dhe forcën tonë?

Të qenit mirënjohës do të thotë të njohësh, të veprosh me përlulësi dhe pa mjeshtëri, të mësosh të vlerësosh atë që është vërtet e

“ Mirënjohja po e humbet forcën e saj, atë vlerë prej së cilës kemi përftuar shumë në të qenit Njeri sot. Sepse mirënjohja nuk është thjesht një akt falënderimi, por mbi të gjitha mirësjelljeje.



rëndësishme në jetë.

Populli shqiptar ndër breza ka treguar mençuri të lindur e të kultivuar siç janë fjalët e urta si melhem për plagët, ku për të përcaktuar këtë anti-vlerë njerëzore të cilën e paskëshim pasur mes nesh në të gjitha kohërat ka thënë: "Të zëntë sytë bukë e shkalur".

Mosmirënjohja është bijë e krenarisë dhe është një nga mëkatet më të mëdha që ekzistojnë në botë. Nëse do të njohësh karakterin e dikujt vendosi në provë mirënjohjen. Sjellja jonë e mirë është provë për ta, teston shpirtin e tyre dhe na tregon në fund sesa të aftë janë njerëzit për të qenë mirënjohës.

Mosmirënjohja është përfaqësimi më i dështuar i vetes!



Forca Tokësore, 24 vite mbrojtje e sovranitetit, pjesëmarrje në operacione humanitare dhe luftarake në mbështetje të paqes

Forca Tokësore është njësi prioritare në strukturën e Forcave të Armatosura. Forca Tokësore u krijua më datë 29 gusht 2000, duke përfshirë në radhët e saj njësi dhe reparte me traditë me një veprimtari të pasur shumëvjeçare, të përhapura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2000 në përbërje të Forcës Tokësore ishin 5 divizione këmbësorie me rreth 55 brigada dhe 300 batalione të përhapur në 167 rajone të ndryshme të vendit.

Gjatë reformimit të vazhdueshëm, Forca Tokësore pësoi ndryshime të reja. Në vitin 2006, suprimohet Forca Tokësore dhe krijohet Komanda e Forcës së Bashkuar.

Misioni

Mbrojtja e pavarësisë, sovranitetit, tërësisë territoriale të Republikës së Shqipërisë, pjesëmarrja në operacione humanitare, luftarake, jo luftarake dhe ato të mbështetjes së paqes.

Detyra të veçanta

Ruajtja dhe zhvillimi i kapaciteteve për të siguruar nivel të lartë gatishmërie; Trajnim të vazhdueshëm dhe të mirë për aktivizimet në detyrat që mund t'i jepen; Ndiemon komunitetin në rast emergjencash humanitare; Mbështet kërkimet tokësore dhe operacionet e shpëtimit; Bashkëpunon me institucione të

tjera kombëtare në ndalimin e trafikimit ilegal të kontrabandës, personave, armëve konvencionale, në Shqipëri; Trajnon, stërvit dhe merr pjesë me trupa në misionet e mbështetjes së paqes në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.





Në kuadër të transformimit të vazhdueshëm të Forcave të Armatosura bazuar edhe në konceptin e një ushtrie sa më të vogël në numër dhe sa më operacionale e profesionale, më 9 dhjetor 2009, u dekretua rikrijimi i Forcës Tokësore mbi bazën e Brigadës së Reagimit të Shpejtë dhe Regjimentit Komando.

Bazuar në misionin kushtetues, Forca Tokësore u përfshi në një proces transformimi të thellë e të gjithanshëm sipas koncepteve të ushtrive perëndimore. Me kalimin tërësisht të strukturave të kësaj force, nga një ushtri e shërbimit të detyrueshëm në një ushtri profesionale është rritur niveli i operacjonalitetit. Strukturat e Forcës Tokësore kanë pasur angazhime në Operacionet e Mbështetjes së Paqes në Bosnje-Hercegovinë, Irak, Çad dhe aktualisht operojnë në Herat, Kandahar, Afganistan. Forca Tokësore mban peshën kryesore në operacionet paqeruajtëse në kuadër të NATO-s, OKB-së dhe BE-së.

Në radhët e Forcës Tokësore drejtojnë kuadro të rinj, të kualifikuar në shkollat e ushtrive të vendeve të NATO-s, si në SHBA, Itali, Turqi, Gjermani, Angli, Austri, etj., me të cilët kemi projekte bashkëpunimi.

Forca Tokësore ka angazhime në operacione të emergjencave civile në ndihmë të komunitetit në rast fatkeqësish natyrore, si

përmbajtje, zhblokim rrugësh dhe shpërndarje ndihmash në rast rënie bore, operacione shuarje zjarresh, etj.

Forca Tokësore nga krijimi deri më sot është drejtuar nga komandantë me eksperiencë.

Në periudhat prej vitit 2000 dhe në vazhdim Forca Tokësore u drejtua nga:

2000 - 2006, gjeneralmajor Kostaq Karoli,

2006 - 2008, gjeneral brigade Shpëtim Spahiu,

2008 - gusht 2012, nga gjeneral brigade Viktor Bërdo.

Nga gushti 2012 deri në nëntor 2015, nga gjeneralmajor Zyber Dushku,

Nga muaji nëntor 2015 deri në janar 2019 nga gjeneralmajor Nazmi Cahani.



Nga shkurt 2019 deri në tetor 2020 nga gjeneral brigade Albert Mullai.

Viti 2020 dhe deri në 2022 drejtohet nga gjeneral brigade Arben Kingji, sot gjeneralmajor, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Sot Forca Tokësore drejtohet nga gjeneralmajor Ilir Xhebexhia.



9 shtator 1996, misioni i parë i FARSH-së në Bosnjë-Hercegovinë

Në kuadër të angazhimeve politike të Republikës së Shqipërisë në luftë kundër terrorizmit, Forcat e Armatosura janë angazhuar dhe marrin pjesë aktive në operacione ndërkombëtare, në misione të ndryshme jashtë vendit, si pjesë e pandarë e operacioneve të drejtuara nga NATO, BE, OKB dhe koalicionet e përbashkëta të partnerëve tanë strategjike.

Më 9 shtator 1996, FARSH-të kanë filluar misionin e parë në Bosnje-Hercegovinë. Numri i trupave pjesëmarrëse në Operacionet e Mbështetjes së Paqes (OMP) është rritur, ashtu siç është rritur edhe gjeografikisht numri i vendeve apo rajoneve ku ato kanë kryer operacione.

Pjesëmarrja e FARSH-së në misione paqeruajtëse dhe luftarake buron nga misioni kushtetues i FARSH-së dhe baza ligjore e përcaktuar për secilin kontribut në misione paqeruajtëse apo luftarake.

Kontribute të FARSH-së, në operacione ushtarake të drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, nga muaji shtator i vitit 1996 dhe deri në muajin dhjetor 2023 janë gjithsej me 8622 ushtarakë.

Ndër vite rreth 100 femra kanë qenë pjesë e kontingjenteve pjesëmarrëse në misione dhe operacione ndërkombëtare. Shqipëria konsiderohet si vendi i dytë në NATO për sa i përket numrit të ushtarakëve të dislokuar në misione, në raport me personelin aktiv të Forcave të Armatosura.

Bosnje-Hercegovinë, angazhimi dhe pjesëmarrja e FARSH-së në misione paqeruajtëse

Sipas burimeve të Ministrisë të Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, kontingjenti i parë i FARSH-së, u angazhua më 9 shtator 1996 dhe vazhdoi deri në dhjetor 2007, gjithsej 21 kontingjente, ku janë angazhuar 1348 ushtarakë. Në prill 2008, në kuadër të operacionit ALTHEA, të kryesuar nga Bashkimi Evropian, vendi ynë ka dërguar në Bosnje-Hercegovinë, një grup AEM (EOD) me 13 ushtarakë, nga të cilët një përfaqësues në Shtabin e EUFOR, gjithsej në këtë mision kanë marrë pjesë 114 vetë.



Ndër vite rreth 100 femra kanë qenë pjesë e kontingjenteve pjesëmarrëse në misione dhe operacione ndërkombëtare. Shqipëria konsiderohet si vendi i dytë në NATO për sa i përket numrit të ushtarakëve të dislokuar në misione, në raport me personelin aktiv të Forcave të Armatosura.

Kontributi i Forcave të Armatosura, nga viti 1996 dhe deri më sot, në Bosnje - Hercegovinë, është 1473 ushtarakë. Aktualisht vazhdon angazhimi, në bazë rotacioni, me 1 përfaqësues në shtabin e EUFOR, në operacionin ushtarak të BE "ALTHEA". Kontingjentet e FA-së morën pjesë në operacionet IFOR dhe SFOR të drejtuara nga NATO dhe operacionin ALTHEA, komanda EUFOR, drejtuar nga BE.

Në shtator - dhjetor 1996, në NATO Implementation Force (IFOR) ishin 37 ushtarakë. Në janar 1997, nëntor 2004, NATO, Stabilization Force (SFOR), 815 ushtarakë. nëntor 2004 - dhjetor 2007, kohë në të cilën misioni përfundoi me sukses detyrën në Bosnje-Hercegovinë, në kuadër të operacionit të ALTHEA, të kryesuar nga Bashkimi Evropian, me 420 ushtarakë.

Gjithsej 21 kontingjente (nga 1 - 4 me 37 ushtarakë dhe nga 5 - 21 me 71 ushtarakë), ku janë angazhuar 1348 ushtarakë në detyra sigurie dhe ruajtje baze, duke qenë në vartësi operacionale dhe në mbështetje të realizimit të detyrave paqeruajtëse të komandës gjermane. Gjithashtu në kuadër të operacionit ALTHEA, të kryesuar nga BE, vendi ynë ka dërguar në Bosnje-Hercegovinë, një grup



AEM (EOD) me 13 ushtarakë (nga të cilët një përfaqësues në Shtabin e EUFOR), në prill 2008, në interes të Shtabit të EUFOR. Kontingjentet AEM (EOD) 1-6 janë të përbërë nga 12 vetë specialistë të armatim-municioneve dhe një oficer, përfaqësues i lartë i palës shqiptare me detyrë oficer shtabi për operacionet në J3 - EUFOR.

Kontingjentet AEM (EOD) 7-8 janë të përbërë nga 10 veta EOD plus 1 përfaqësues në shtab, në total 11 ushtarakë. Kontingjentet AEM (EOD) 9-10 janë të përbërë nga 6 veta EOD plus 1 përfaqësues në shtab, në total 7 ushtarakë. Gjithsej në këtë mision kanë marrë pjesë 114 vetë.

Kontributi i Forcave të Armatosura, nga viti 1996 dhe deri më sot, në Bosnje - Hercegovinë, është 1473 ushtarakë.

Aktualisht vazhdon angazhimi, në bazë rotacioni, me 1 (një) përfaqësues në shtabin e EUFOR, në operacionin ushtarak të BE "ALTHEA".

Bosnje-Hercegovinë, misioni i parë i madh, paqeruajtës i NATO-s

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë gjatë fillimit të viteve 1990, Bosnje-Hercegovina multi-etnike u hodh në një konflikt të përgjakshëm dhe të zgjatur. Sulmet e para serbe në vitin 1992 goditën shumicën e boshnjakëve. Vrasje, përdhunime dhe dëbime u kryen nga forcat serbe për "të pastruar" territoret e

pushtuara. Banorë që jetonin nën bombardime, vetëm me energji elektrike sporadike, në të ftohtin e dimrit madje edhe në vështirësi për t'u ushqyer dhe me dhjetëra familjarë të tyre të dashur të varur. Pasditja e 21 nëntorit 1995, do të përhapte nëpër rrugët e mbuluara me dëborë të Sarajevës, lajmin e marrëveshjes së paqes të arritur në Dejton, Ohajo. Janë 29 vjet që nga fillimi i operacionit të parë paqeruajtës të aleancës. Forca e Zbatimit (IFOR), e udhëhequr nga NATO, u vendos në Bosnje-Hercegovinë, më 20 dhjetor 1995, pas negociatave të suksesshme të marrëveshjes së paqes të Dejtonit.

Angazhimi i NATO-s në Bosnje-Hercegovinë mbetet i paprekur edhe sot. "Ne erdhëm për të ndihmuar sigurimin e paqes në fund të një konflikti të tmerrshëm. Sot, Bosnje-Hercegovina është një vend shumë i ndryshëm, paqësor, i qëndrueshëm dhe duke ecur drejt një të ardhme më të mirë në rrugën drejt integriteteve euro-atlantike", - ka thënë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. "Ne kërkojmë një Ballkan Perëndimor ku njerëzit të jenë në gjendje të jetojnë si fqinjë, në paqe dhe me respektimin e të drejtave të të gjitha komuniteteve".

Misioni i IFOR filloi pas përfundimit të luftës në Bosnje-Hercegovinë, më 21 nëntor 1995, pas arritjes së marrëveshjes së paqes në një bazë të forcave ajrore amerikane në Dejton, Ohajo. Një muaj më vonë, më 20 dhjetor 1995, trupat nën

misionin IFOR, udhëhequr nga NATO u vendosën në Bosnje-Hercegovinë për të zbatuar marrëveshjen. Ky ishte operacioni i parë i NATO-s në një vend jashtë territorit të aleancës. Në kulmin e tij, IFOR përbëhej nga 60 000 trupa të nxjerra nga vendet aleate dhe vendet partnere, përfshirë edhe nga Rusia. IFOR operoi sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, nga i cili rrjedh mandati i tij, nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Detyra kryesore IFOR-it ishte për të ruajtur paqen dhe për të veçuar Forcat e Armatosura të Federatës së Bosnje-Hercegovinës nga ato të Republikës Srpska. IFOR gjithashtu mbikëqyri demarkacionin e vijave kufizuese dhe heqjen e armëve të rënda. Operacioni IFOR u zëvendësua në dhjetor të vitit 1996 nga Forca Stabilizuese, e udhëhequr nga NATO, (SFOR), e cila ishte më e vogël në madhësi dhe që kishte një mandat tjetër. Në vitin 2004, BE mori përsipër rolin e stabilizimit. NATO ofroi planifikim dhe mbështetje logjistike në përputhje me marrëveshjet Berlin Plus, rënë dakord midis dy organizatave. NATO mban një shtab në Sarajevë që i ofron këshilla Bosnje-Hercegovinës në reformën e mbrojtjes, koordinon aktivitetet e partneritetit dhe mbështet përpjekjet e vendit në integrimin euro-atlantik. Bosnje-Hercegovina u bë vend partner i NATO-s në vitin 2006 dhe është aplikant për anëtarësim në NATO. Integrimi në BE është një nga objektivat kryesore politike të Bosnjë-Hercegovinës, ajo ka iniciuar procesin e Stabilizim Asociimit në vitin 2007.

Qëllimi dhe zbatimi i IFOR dhe SFOR

Forca e Zbatimit (IFOR) u vendos në Bosnje-Hercegovinë në dhjetor 1995 me një mandat njëvjeçar. IFOR operoi sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, që rrodhi autoritetin e tij nga Rezoluta e OKB-së Këshillit të Sigurimit (RKSKB) 1031 të 15 dhjetorit 1995. Kjo i dha një mandat jo vetëm për të ruajtur paqen, por edhe, kur është e nevojshme, për të zbatuar atë. Si i tillë dhe në mënyrë rigoroze, IFOR ishte një operacion i zbatimit të paqes, që ishte më zakonisht i referuar si një operacion i mbështetjes së paqes. IFOR-i synoi të mbikëqyrë zbatimin e aspekteve ushtarake të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, marrëveshja i dha fund luftës në Bosnjë. Detyra kryesore ishte për të garantuar fundin e armiqësive dhe të ndante Forcat e Armatosura të Federatës së Bosnje-Hercegovinës, nga njëra anë, dhe të Republikës Srpska, në anën tjetër. IFOR mbikëqyri transferimin e territorit në mes të Federatës së Bosnje-Hercegovinës dhe Republikës Srpska, demarkacionin e kufirit ndërmjet entiteteve dhe heqjen e armëve të rënda në zonat e miratuara. Ndërsa situata në terren ishte përmirësuar, IFOR filloi ofrimin e mbështetjes për organizatat e përfshira në mbikëqyrjen e zbatimit të aspekteve civile të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, duke përfshirë Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Kombeve të Bashkuara.

Ndërsa situata ishte ende potencialisht e paqëndrueshme dhe shumë aspekte të tjera kishin mbetur për t'u realizuar në anën civile, NATO ra dakord për të vendosur një forcë të re Stabilizuese (SFOR) që nga dhjetori i 1996.

Forca e Stabilizimit (SFOR) operoi sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, që rrjedh autoritetin e saj nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1088 të datës 12 dhjetor 1996. Siç ishte rasti për IFOR-in, ky

ishte një operacion i zbatimit të paqes që ishte më zakonisht i referuar si një operacion në mbështetje të paqes. Detyra kryesore e SFOR-it ishte që të kontribuonte për një ambient të qetë dhe të sigurt të favorshëm për rindërtimin civil dhe politik. Në mënyrë të veçantë, SFOR kishte për detyrë të pengonte ose parandalonte rifillimin e armiqësive; për të promovuar një klimë në të cilën procesi i paqes mund të vazhdonte për të ecur përpara; dhe, për të siguruar mbështetje selektive brenda mjeteve dhe aftësive të organizatave civile të përfshira në këtë proces të saj. Aktivitetet për të shkonin nga patrullimi dhe ofrimi i sigurisë në zonën përmes reformës së mbrojtjes mbështetjen dhe mbikëqyrjen e operacioneve të çminimit, për të arrestuar individët e paditur për krime lufte dhe ndihmuar kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre.

Gjatë këtyre misionëve, një total prej 36 vendesh aleate dhe partnere kontribuuan me trupa. Përveç kësaj, ushtarë nga pesë vende që nuk ishin as anëtarë të NATO-s dhe as vende partnere morën pjesë në kohë të ndryshme, siç ishin Argjentina, Australia, Kili, Malajzia dhe Zelande e Re. IFOR, forcë prej 60 000 trupash u vendos për një vit kurse SFOR, fillimisht përbëhej nga 31 000 trupa, deri në fillim të vitit 2001 u reduktua në 19 000, në pranverën e vitit 2002 u mor vendimi për zvogëlimin e trupave në 12 000 deri në fund të vitit 2002, dhe në vitin 2004 arriti në 7 000 trupa.

Në dhjetor 2004, përgjegjësia kryesore për aspektet ushtarake të Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit u dorëzua BE-së, i cili që atëherë po kryen operacionin e EUFOR-it "Althea" në Bosnje-Hercegovinë. NATO i ofron mbështetje EUFOR Operacionit "Althea" sipas Marrëveshjeve të Berlin Plus. Bosnje-Hercegovina iu bashkua programit të Partneritetit për Paqe (PfP) në vitin 2006. Më pas u ftua t'i bashkohej Planit të Veprimit të Anëtarësimit (MAP) në vitin 2010, një program i NATO-s me këshilla, asistencë dhe mbështetje praktike të përshtatur për nevojat individuale të vendeve që dëshirojnë të bashkohen me Aleancën. Pjesëmarrja në MAP nuk paragjykon asnjë vendim për anëtarësimin e ardhshëm. Vendi duhet të vazhdojë të ndjekë reformat demokratike dhe të mbrojtjes për të përmbushur aspiratat e tij euro-atlantike. Për këtë qëllim, nën MAP, Bosnje-Hercegovina prezantoi Programin e saj të parë të Reformës në vitin 2019. Ky program përshkruan reformat që qeveria synon të ndërmarrë dhe lehtëson ofrimin e mbështetjes nga NATO ndaj këtyre përpjekjeve. Në fillim të vitit 2021, Bosnje-Hercegovina themeloi Komisionin për Bashkëpunim me NATO-n, i cili koordinon zbatimin e aktiviteteve reformuese në kuadër të Programit të Reformës.

Në ditën e pushtimit të plotë të Rusisë në Ukrainë në vitin 2022, NATO po rrit mbështetjen e saj për partnerët, përfshirë Bosnje-Hercegovinën, për t'i ndihmuar ata të ndërtojnë aftësitë e tyre dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre. Ministri i Mbrojtjes i Bosnje-Hercegovinës mori pjesë në Samitin e NATO-s 2022 në Madrid. Gjatë këtij samiti, aleatët ranë dakord për një sërë masash shtesë politike dhe praktike për të mbështetur vendin në forcimin e qëndrueshmërisë së tij, duke përfshirë zhvillimin e një pakete të re për Ndërtimin e Kapaciteteve Mbrojtëse (DCB). Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s miratuan paketën e re të DCB-së për Bosnje-Hercegovinën në shkurt 2023.



RRUGËTIMI HISTORIK i strukturës arsimore të mbi 45 mijë ushtarakëve elitë

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Shqipërisë u krijua më 16.08.2001, në përputhje me ligjin Nr.8571 datë 27.01.2000 “Për Politikën e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë” dhe Urdhrin e Komandantit të Përgjithshëm të FA-së, datë 08.04.2000 “Për kalimin në strukturën e re organizative të FA-ve të Republikës së Shqipërisë”. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes organizon dhe drejton përgatitjen, arsimimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të oficerëve, nënoficerëve dhe drejtuesve ushtarakë për të tri llojet e forcave; përpunon dhe sinkronizon koncepte doktrinale bazë të organizimit dhe përdorimit të Forcave të Armatosura në përputhje me Strategjinë e Sigurimit, Politikën e Mbrojtjes dhe Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë, përpunon dhe përmirëson programet, standardet dhe kërkesat për stërvitjen e ushtarëve të nënrepartëve, repartëve e njëjësive në interes të rritjes së aftësive luftarake të Forcave të Armatosura. Komandantët dhe drejtuesit ushtarakë të të gjitha niveleve në Forcat e Armatosura të



Përbushja e misionit të FASH kërkon, në radhë të parë, personel të arsimuar, të mirë stërvitur, por edhe të motivuar. Për këtë qëllim, vëmendje e veçantë t’i kushtohet arsimimit dhe stërvitjes së fokusuar nga misioni, në përputhje me standarde reale, që u përgjigjen nivelit të zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe atyre të NATO-s

Republikës janë përgjegjës për përgatitjen e ushtarëve, detarëve dhe pilotëve të tyre, për të përbushur misionet e ngarkuara në kuadrin e betejave apo luftimeve. Për të qenë të suksesshme, forcat tona duhet të stërviten, fillimisht dhe kryesisht për situatë reale të luftës. Forcat e Armatosura duhet të operojnë e të jenë të suksesshme në të gjitha llojet e operacioneve ushtarake, të

bashkuara/përbashkëta (Joint) dhe shumëkombëshe. Të jetë i trajnuar dhe i gatshëm, është detyra e parë e çdo komandanti në shërbim të FA-së, me qëllim që të planëzojnë dhe zhvillojnë stërvitje efektive dhe kuptimplotë. Individët, shtabet dhe njësitë, në të gjitha nivelet e drejtimit të FA-së, kanë nevojë edhe për udhëzime nga komandantët e tyre. Zhvillimet e shpejta të FASH në rrugën e integritit të plotë në Aleancën Euroatlantike, diktojnë konsolidimin dhe përsosjen e sistemit të arsimit dhe të stërvitjes së integruar, duke i dhënë atij vlera të reja, në funksion të krijimit të përvojave dhe realiteteve të reja bashkëkohore, për garantimin e forcimit të vazhdueshëm të një shoqërie të qëndrueshme, demokratike dhe paqësore.

Përbushja e misionit të FASH kërkon, në radhë të parë, personel të arsimuar, të mirë stërvitur, por edhe të motivuar. Për këtë qëllim, vëmendje e veçantë t'i kushtohet arsimit dhe stërvitjes së fokusuar nga misioni, në përputhje me standarde reale, që u përgjigjen nivelit të zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe atyre të NATO-s. Doktrina e Arsimit dhe e Stërvitjes është projektuar për të gjithë komandantët dhe drejtuesit e tjerë ushtarakë në FA. Një vend të veçantë në këtë Doktrinë zë arsimimi universitar dhe arsimimi profesional ushtarak.

Sistemi Arsimit Ushtarak

Sistemi Arsimit Ushtarak duhet të arrijë një balancë relative ndërmjet koncepteve akademike, realiteteve operacionale dhe perspektivave historike. Përmirësimi i vazhdueshëm i burimeve të mbështetjes, shtimi i informacionit dhe, në veçanti, modernizimi i metodave të shkëmbimit të tij, së bashku me zhvillimin teknologjik, do të ndryshojnë së tepërmi e në mënyrë thelbësore të gjithë stërvitjen në FA. Në këtë kuadër, objektivat që do të synohet të arrihen do të ndryshojnë, ndërkohë që procedurat teknike, metodat e drejtimit,

të vlerësimit e të kontrollit do të evoluojnë vazhdimisht nëpërmjet filozofisë: stërvit - vlerëso - ristërvit. Vetëm kështu do të sigurohet vazhdimësia e këtij procesi thelbësor për FA.

Ky institucion realizon mbështetjen e nevojshme institucionale për përgatitjen e personelit të FA-së dhe zhvillimin e një procesi stërvitor të standardizuar. Ai është përgjegjës për përgatitjen institucionale të oficerëve dhe nënoficerëve; për kryerjen e stërvitjes bazë me të gjithë personelin ushtarak të FA-së; për përgatitjen dhe kualifikimin e ushtarëve profesionistë/me pagesë; sigurimin e përgatitjes së drejtuesve të të gjitha niveleve, si dhe sigurimin e mbështetjes së nevojshme për vetëzhvillimin e tyre; zhvillimin e koncepteve, kërkesave, materialeve doktrinare, udhëzimeve stërvitore, manualeve etj. Qëllimi i sistemit të arsimit Ushtarak është të prodhojë një trupë drejtuesish të përshtatshëm dhe që të mendojnë në mënyrë kritike, si oficerë dhe nënoficerë, të cilët të kenë vlerat e duhura, atributet dhe aftësitë për të kryer siç duhet detyrat e tyre dhe që t'i shërbejnë kombit. Këta drejtues duhet të dinë si operojnë Forcat e Armatosura, aleatët ushtarakë, partnerët e Shqipërisë dhe kundërshtarët e mundshëm. Për më tepër, këta drejtues duhet të tregojnë besnikëri, integritet, gjykim kritik dhe përgjegjësi, ndërsa veprojnë në një mjedis sigurie shumë kompleks, shpesh të dyshimtë dhe shumë shpejt të ndryshueshëm. Arsimiti është në thelb instruksioni formal, që kryhet zakonisht në mjedise klase, me njohuri të shtuara, aftësi, mendim kritik, me vendimmarrje të përmirësuar dhe/apo eksperiencë, si produkt i dëshiruar për studentin. Kjo metodologji është në kontrast me stërvitjen, ku një detyrë bazë apo stërvitje përdoret në kushte specifike dhe këtu standardet përdoren për të vlerësuar aftësitë e individit dhe të njësisë operacionale. Arsimiti universitar në FA, në kurrikulën e tij, gjithashtu përfshin edhe



modulet e edukimit, stërvitjes dhe të trajnimit ushtarak deri në nivelin e togës (për të gjitha armët). Ai siguron vazhdimësinë e përgatitjes dhe ekzekutimin e programit të edukimit të oficerit të ri. Arsimimi i personelit ushtarak në sistemin e FA realizohet nëpërmjet konsolidimit të vazhdueshëm të sistemit arsimor. Arsimimi i përgjithshëm fillon në Universitetin Ushtarak dhe vazhdon në çdo nivel arsimor të oficerit dhe nënoficerit, në akademitë ushtarake, nëpërmjet kurseve të karrierës. Mësimi është progresiv, i ndërtuar mbi aftësitë dhe njohuritë e fituara nëpërmjet trajnimit të mëparshëm dhe detyrave operacionale.

Kursi Bazë i Oficerit (KBO) ofrohet për të gjithë oficerët që kanë



përfunduar edukimin universitar. Kursi zhvillohet në Shkollën e Trupës për një kohëzgjatje gjashtë muaj deri në një vit akademik. Programi synon në përgatitjen e kursantëve me njohuri të plota teorike e praktike për drejtimin dhe menaxhimin e togës në përbushje me sukses të detyrave, në kohë paqe, krize e lufte, si dhe jep njohuri për kompaninë dhe përdorimin e teknikës luftarake në specialitetin përkatës.

Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO). Ky kurs realizohet me të gjithë oficerët me gradën toger dhe lejtënant, që kanë katër deri në shtatë vjet në shërbimin aktiv. Kursi i Avancuar i Oficerit shërben si kusht për marrjen e gradës "Kapiten" dhe zgjat jo më pak se 12 javë mësimore. Programi i këtij kursi përgatitet dhe realizohet nga Shkolla e Trupës.

Kursi Bazë i Oficerit të Shtabit (KBOSH), kryhet në Akademinë e Mbrojtjes dhe zgjat tre muaj. Qëllimi i programit është arritja e njohurive bazë për punën në grup, njohuritë e përgjithshme për shtabin dhe detyrat që plotëson ky.

Kursi është përzgjedhës dhe ka si qëllim primar përzgjedhjen e oficerëve më të mirë për të vazhduar Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm (KOSHP). Në programin e këtij kursi përfshihet dhe synohet për një detyrë me zgjedhje në nivel batalioni për operacione luftarake ose jo luftarake. Programi për këtë kurs të krijohet për oficerët e komponentëve tokësorë, detarë dhe ajrorë.

Kursi i Komandantit dhe Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm (KKOSHP) kryhet në Akademinë e Mbrojtjes dhe ka një kohëzgjatje prej një viti akademik. Programi i tij është vazhdim i kursit Bazë të Oficerit të Shtabit; ky kurs të synojë të përgatisë oficerë të përzgjedhur karriere për të plotësuar detyra në pozicione kyçe në komandim kontroll të njërive kryesore të FA, në shtabet përbërës të forcave, në Shtabin e Përgjithshëm, në shtabet e NATO-s, apo në shtabe të ndryshme ndërkombëtare.

KOSHP duhet t'u japë oficerëve njohuri të thelluara për situatat ndërkombëtare, mbi konceptet bazë për rregulloret e sigurisë e të mbrojtjes (kombëtare dhe ndërkombëtare), për lidhshirësin dhe procesin e planifikimit operacional, duke futur elementët e parë të stërvitjeve të përbashkëta etj. Në këtë kurs qëllimi është që 10-15% e programit të zhvillohet në gjuhën angleze, si gjuhë operacionale e NATO-s, kryesisht lënda e Operacioneve në mbështetje të Paqes.

Kursi i Lartë i Oficerit (KLO). Kursi i lartë i Oficerit do të kryhet në Akademinë e Mbrojtjes me një kohëzgjatje prej një viti akademik. KLO konsiderohet si vazhdim i njohurive të mara në Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e përgatitjes profesionale dhe të Kursi i Lartë i Oficerit është niveli më i lartë i sistemit arsimor ushtarak

Përvetësimi i programit të KLO, me përfundimin e tij, siguron dhënien e gradës "Master" në fushën e mbrojtjes. Jo më pak se 30% e programit të këtij kursi të zhvillohet në gjuhën Angleze, kryesisht modulet e operacioneve shumëkombëshe.

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe i Mbrojtjes (KLSM) kryhet në Akademinë e Mbrojtjes me një kohëzgjatje prej jo më pak se dy muaj. Programi i këtij kursi jep njohuri dhe trajnim analitik për probleme të mbrojtjes dhe të sigurisë, në nivelin kombëtar dhe rajonal, gjeopolitika, menaxhimi i krizave, ligji ndërkombëtar humanitar, konfliktet e armatosura, lufta kundër terrorizmit, etj. Kursi të kryhet 100% në gjuhën Angleze me pjesëmarrjen e autoriteteve civile dhe ushtarake të vendit, si edhe pjesëmarrjen nga vende të rajonit.



Historia 66 - vjeçare e nëndetëseve shqiptare

Më 21 shtator 1958, u krijua Brigada e Nëndetëseve, (BrND): ND e 1-rë, (Whiski 613 C, Stuhia), ND e 2-të, (Rrufeja), ND e 3-të, (Vetëtima), ND e 4-të, (Tufani).

Çlirimi i vendit nga pushtimi nazi-fashist, e gjeti Shqipërinë pa flotë detare luftarake. Edhe ato pak mjete të thjeshta e primitive, që kryenin detyra mbrojtje e patrullimi në vijën bregdetare, u shkatërruan nga lufta.

Në dhjetëvjeçarin e parë të pasluftës, me ndihmën e BS, aleati kryesor i Shqipërisë ato kohë, u hodhën bazat e para për krijimin e një flote luftarake me motoskafe me armatim të lehtë dhe më pas me disa mjete të vogla e të shpejta luftarake, që quheshin "Katër-Silurues", pas tyre dhe disa "Dragamina", me të cilat Shqipëria në ato kohë siguronte ruajtjen e kufijve detar të saj.

Shqipëria e vogël në hapësirën bregdetare, kishte vende shumë strategjike për të zotëruar jo vetëm kufijtë detar të saj, por për gjithë hapësirën që përfshin edhe detin Jon e më tej në Mesdhe. Dhe një nga këto pika strategjike ishte, Gjiri i Pashalimanit, një vend ideal strehimi, jo vetëm për ato



Shqipëria e vogël në hapësirën bregdetare, kishte vende shumë strategjike për të zotëruar jo vetëm kufijtë detar të saj, por për gjithë hapësirën që përfshin edhe detin Jon e më tej në Mesdhe. Dhe një nga këto pika strategjike ishte, Gjiri i Pashalimanit, një vend ideal strehimi, jo vetëm për ato pak anije luftarake që kishte Shqipëria ato kohë, por dhe për një flotë më të madhe e më moderne.

pak anije luftarake që kishte Shqipëria ato kohë, por dhe për një flotë më të madhe e më moderne.

Kjo i tërhoqi vëmendjen aleatit të ngushtë që

kishte Shqipëria në atë periudhë, Bashkimit Sovjetik. Në tetor të vitit 1957, erdhi për vizitë në Shqipëri, ish-ministri i Mbrojtjes i BS, Mareshali i shquar i luftës së Dytë Botërore,

G. K. Zhukov, ku midis të tjerave, u vendos që gjiri strategjik i Pashalimanit të kthehej në një bazë të fuqishme luftarake detare jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për aleatët e saj në vitet '50 e '60, të shekullit që shkoi, siç ishte "Traktati i Varshavës", Aleanca Ushtarake e vendeve të lindjes komuniste. Ishte një ëndërr për ushtrinë shqiptare, e veçanërisht për armën e marinës luftarake, ngritja e një flote të madhe e moderne, që nga fundi i viteve 50-të u bë realitet me ardhjen e mjeteve detare luftarake me përmasa të mëdha dhe së fundi grupi i nëndetëseve me bazën përkatëse, që i dhanë emrin, "Flota Luftarake Detare (FLD) e Shqipërisë", me atë uniformën e bukur të marinarëve, me pelerinën ngjyrë deti mbi supe dhe shiritat e zinj në kapele shkruar me germa të mëdha, "Gjiri i Pashalimanit", nga një strehëz e thjeshtë e mbrojtjes së anijeve peshkarexhë nga erërat e stuhishme detare, në vitet 1957-'58, u kthye shpejt në një port modern luftarak për ankorimin e mjeteve mbi dhe nën ujore të Flotës së Re Detare Shqiptare të porsa ngritur.

Madhështinë e kësaj flote e plotësoi dhe ardhja e nëndetëseve në gushtin e vitit 1958, me lundrimin e tyre të gjatë nga baza e Kaliningradit në brigjet e Baltikut verior të BS, të udhëhequra nga baza e tyre lundruese, "Njemçinova", që në Shqipëri mori emrin "Tomori", e drejtuar nga Admirali rus Jorgorov, i cili vite më vonë në betejat politike ruso-shqiptare, u personifikua me personazhin e "Zheliznovit" në filmin shqiptar të viteve 60-të, "Ballë për Ballë", të shkrimtarit Ismail Kadare.

Emra të argjendtë, "Flota Luftarake Detare" Kapiteni i Rangut të Parë, Xhemal Shani, që u bë komandant i Brigadës së Nëndetëseve, si dhe komandantët Dashamir Ohri, Spiro Kote, Shyqyri Çukaj dhe Beqir Gërbi.

Teknika e re dhe e vështirë për efektivat shqiptarë, u përvetësua në një kohë rekord, në saje të vendosmërisë e përkushtimit, duke marrë në dorëzim postet dhe mjetet luftarake, që kohë pas kohe realizuan stërvitje me nivel të lartë luftarak. Një shembull të tillë tregoi ekuipazhi i nëndetësës së dytë të Brigadës së Nëndetëseve, me lundrimin e parë të saj të gjatë e të vështirë prej 21 ditësh në thellësi të ujërave të Adriatikut, Jonit dhe deri në Mesdhe. Ishte një stërvitje e vështirë për faktin, se i gjithë lundrimi dhe fazat e stërvitjes prej 21 ditësh u zhvilluan nën ujë me nivele të ndryshme thellësie, pa dalë në sipërfaqen e ujit. Nëndetësja drejtohej



nga Komandanti, toger Shezai Kasa, zëvendëskomandanti, toger Skënder Doçi, inxhinieri mekanik, toger Korab Mejdani e detarë të tjerë.

Ky lundrim u realizua në korrik të vitit 1959, pothuaj një vit pas ardhjes së kësaj teknike të re për flotën tonë luftarake. Lundrimi ishte i detyrueshëm për t'u realizuar në thellësi të ujërave detare, për shkak jo vetëm të kërkesave të stërvitjes në kushte lufte të vështirësive maksimale, por dhe të situatës që përjetonte vendi ynë në atmosferën e "luftës së ftohtë", që zhvillohej midis dy kampeve kundërshtarë dhe kur Flota e 6-të Amerikane ishte e pranishme në ujërat e Detit Mesdhe.

Brigada e nëndetëseve përbënte atë kohë armën dhe teknikën më moderne të Flotës sonë Luftarake Detare dhe kjo detyrë sa e rëndë dhe e vështirë, kërkonte angazhim e sakrificë maksimale, për të cilat ekuipazhet përkatëse me komandantët e tyre në krye, i realizuan me sukses. U shquan mjaft nga këta kuadro drejtues të arsimuar në shkollat ushtarake detare në Baku, Sevastopol dhe Shën Petërsburg të BS.

Të tillë ishin: Xhemal Shani, Stavri Çika, Dashamir Ohri, Muharrem Lulolli, Shezai Kasa, Spiro Kote, Shyqyri Çuko, Beqir Gërbi, Skënder Doçi, Aleko Pojani, Petrit Myftiu e shumë të tjerë. Flota Luftarake

Detare, përveç brigadës së nëndetëseve në Portin e Pashalimanit, me bazën lundruese të përmasave të mëdha, "Tomori", me Komandant Stavri Çika, kishte dhe brigadën e anijeve luftarake mbiujëse të ishullit të Sazanit, me "Gjuajtësit luftarak", "Dragaminat" dhe "Katër-Siluruesit" e shpejtësisë së lartë, po ashtu dhe detashmenti i anijeve ndihmëse mbiujëse siç ishin: anija e "Dragës", që thelloi portin e Pashalimanit me komandant Izet Velçani, anija e "Çmagnetizueses", që shkarkonte nëndetëset dhe anijet e tjera luftarake nga ngarkesat elektriko-magnetike kundër fushave të minave detare, me komandant Xhevit Selimullari, anija cisternë, që furnizonte anijet luftarake me ujë e karburant me emrin, "Linda", "Rimorkiatori" me fuqi të madhe tërheqëse, me komandant detarin e vjetër, Dulla, anijet e vogla "Hidrografike", "Palombarja" me grupin e palombarëve, e shumë e shumë anije të tjera ndihmëse. E gjithë ajo flotë luftarake, ishte një garanci për ruajtjen e kufijve detar të Shqipërisë, sigurisht e mbështetur dhe nga një artileri e fuqishme bregdetare e instaluar në pikat më dominante të bregdetit, në ato kushte izolimi e rrethimi që përjetonte Shqipëria komuniste, shtu këtu dhe klimën e nderë të presionit që krijonte "lufta e ftohtë" midis dy kampeve rivale botërore.



ANIJA "ORIKU", MBI NJË DEKADË NË UJËRAT DETARE Erëra të mbara dhe mirënjohje efektivit të anijes "Oriku"!

Anija "Oriku", e cila u prodhua në kantierin e ndërtimit të anijeve Pashaliman, u ul në ujë për herë të parë në datën 13 shtator 2011. Pas kompletimit të anijes me pajisjet dhe materialet e nevojshme të përfundimit të punimeve dhe testimit në lundrim, anija "Oriku" u mor në dorëzim, duke u bërë anija më e re e Forcës Detare, më 24 shkurt 2012. Anija "Oriku" ishte e para anije që në nëntor të vitit 2016 lundroi jashtë ujërave të Republikës së Shqipërisë, duke dhënë kontribut në aktivitetin e NATO-s "Sea Guardian" dhe aktualisht po realizon misionin e saj të 9-të në detin Egje. Në realizimin e këtyre misioneve janë angazhuar 189 efektivë të Forcës Detare, duke u vlerësuar



nga autoritetet tona dhe të Aleancës (MARCOM dhe SHAPE) për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar në dhënien e ndihmës për emigrantët të cilët rrezikojnë jetët e tyre për të hyrë në kufijtë e BE. Gjithashtu anija "Oriku" ka marrë pjesë në shumë stërvitje të përbashkëta dhe me vendet anëtare të NATO-s jashtë ujërave territoriale të Shqipërisë. Vlen të përmendet pjesëmarrja e anijes "Oriku" në një nga stërvitjet më të mëdha shumëkombëshe "Defender Europe 21". Duke i uruar në vijim erëra të mbara dhe mirënjohje të veçantë efektivit të anijes "Oriku", të cilët në çdo situatë apo kushte të vështira kanë realizuar me sukses çdo mision të caktuar.

15 vite SHKURSH, me të drejta të plota në CIOR

Prezenca e Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë (SHKURSH)

Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve Rezervë në Shqipëri, në kuadër të 15-vjetorit të pranimi në Konfederatën Ndër-aleate të Oficerëve në Rezervë të NATO-s (NATO CIOR), zhvilloi një aktivitet, më 5 gusht 2024. Në këtë aktivitet morën pjesë anëtarë të kësaj shoqate nga degët e Tiranës dhe rrethet Elbasan e Durrës, ushtarakë rezerve/lirim/pension, nga shoqata Detaria, shoqata e Aviacionit, shoqata e Tankistëve, shoqata "Skënderbej", shoqata Artiljerëve, etj. Realizimi i këtij aktiviteti, kishte qëllim prezantimin dhe promovimin e Shoqatës Ushtarakëve në Rezervë/Lirim/Pension mbi pjesëmarrjen e kontributin e saj në aktivitetet e CIOR. CIOR është njohur zyrtarisht nga NATO.

Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës nënkolonel (R) Arben Mollaj, si moderator i këtij aktiviteti, përshëndeti dhe uroi pjesëmarrësit dhe pas ekzekutimit të Himnit të CIOR dhe Himnit të RSH, bëri një prezantim mbi CIOR-in dhe rrugëtimin e shoqatës në aktivitetet e CIOR. Gjithashtu në emër të zëvendësministrit të Mbrojtjes ai përcolli mesazhin e urimit për aktivitetin e organizuar nga Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë (SHKURSH), me rastin e përkujtimit të 15-vjetorit të SHKURSH në Konfederatën Ndër-aleate të Oficerëve Rezervë.

"Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë SHKURSH, ka për mision të afrojë dhe të mbajë të bashkuar ushtarakët në rezervë/lirim e pension; të ruajë traditat patriotike të popullit shqiptar, të transmetojë përvojën dhe vlerat më të mira të FARSH; të integrojë këtë grup ushtarakësh në shoqërinë civile dhe në stërvitjet e aktivitetet e ushtarakëve në rezervë të NATO-s", tha në prezantimin e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës, Mollaj. Pas prezantimit, presidenti aktual i shoqatës nënkolonel (P) Hamit Gojani në fjalën përshëndetëse uroi pjesëmarrësit në emër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji dhe Komandantit të QPR-së, kolonel Fadil Ciroku. "Sot SHKURSH mbush 15 vjet nga data e pranimi në Konfederatën Ndër-aleate të Oficerëve Rezervë (CIOR). "Ashtu siç e dini, pas një pune të madhe nga drejtuesit e asaj kohe të SHKURSH, filluan bisedimet me Presidentin e asaj kohe të CIOR nënkolonel Erik Thiri (Gjermania). Bisedat me ambasadorin e Gjermanisë në Shqipëri dhe atashetë e vendeve Gjermani e Shqipëri dhanë ndihmesën e veçantë në kuadër të procedurave të nevojshme për t'u ofruar me CIOR", - tha z. Gjoni. "Vit pas viti prezenca e shoqatës në aktivitete e veprimtari të CIOR ishin hapa të ngadaltë por të sigurt, që nga 2002 në Kongresin e CIOR në Strasburg, Francë, ku e certifikojnë shoqatën si pjesë e CIOR, por kjo u finalizua në 2005 për pranim në CIOR dhe vijoi drejt kalimit nga statusi 'vëzhgues', 'asociues' deri në anëtarësim të plotë në CIOR, i cili u realizua më 05 gusht 2009. Bashkëpunimi me MM dhe SHP ishin një garanci në rrugën e nisur, ku pavarësisht marrëdhënieve



të mira me disa drejtori në MM apo SHP, jo të gjithë e marrin informacionin e duhur sesi veprojnë ushtarakët nga vende të tjera, pas ndërprerjes së karrierës ushtarake". Vlen të theksohet, tha ai, se diskutimet dhe mbështetja nga ish-ministri i Mbrojtjes Luan Hajdaraga e më pas Pandeli Majko, SHSHP gjeneral Aleks Andoni dhe u vijua nga gjeneral Pëllumb Qazimi, na kanë mirëpritur dhe na mbështetën në ato momente të vështira për shoqatën për çka ne iu jemi mirënjohës". Pjesëmarrja e shoqatës në veprimtaritë e CIOR me ushtarakët të cilët njihnin gjuhën angleze ishte një gur themeli për shoqatën dhe për herë të parë 2007 në vendin tonë u zhvillua seminari me oficerët e rinj, i cili trajtoi konceptet, mundësitë e angazhimit tyre në mjedis ndërkombëtar, shkëmbimi i përvojave dhe roli shumë i rëndësishëm i rezervistëve në rajon e mbarë botën. "Pikërisht pas 7 viteve pune intensive, pjesëmarrje



e kontribut në veprimtari të ndryshme, në Kongresin e CIOR, të zhvilluar 4-8 gusht 2009, në Sofje, Bullgari, në mbledhjen e datës 05 gusht 2009, u votua dhe ne u pranuan me të drejta të plota në CIOR, anëtar. Më pas u vijua në takime e veprimtari sipas plan kalendarit të CIOR dhe transmetuam politikat, konceptet e FA-së për komponentin rezervist. Vlen të përmenden: Kol. Zydi Kroj; Kol. Fiqeret Doda; Kol. Mehdi Pogace; Kol. Thoma Konduri; Kol. Suzana Jahollari; Kol. Shamet Shabani; N/kol Hamit Gojani; N/kol Arben Mollaj; N/kol Agostin Coku (SHP); N/kol Enver Ajdari; N/kol ; Shkëlqim Bejo; Maj. Zoi Kote; Maj. Faik Belba; Zalo Hoxha; Ali Sadiku; etj. Por të nderuar shokë e kolegë nuk mund të lëmë pa përmendur kontributin e drejtuesve në strukturat organizative që nga kryetarët dhe stafet e tyre në Tiranë e rrethe të ndryshme të vendit.

Përhëndetën këtë 15-vjetor kolonel (R) Zyhdri Kroj, President Nderi, i cili solli kujtime nga procesi i kërkesave të para deri në anëtarësim; kolonel (R) Thoma Konduri, President Nderi, i cili solli kujtime për periudhën 8 - vjeçare dhe krijimi i marrëveshjeve me vendet e rajonit; kolonel Enver Ajdari, Zv/President për marrëdhëniet ndërkombëtare, kujtoi përfaqësimin e tij në aktivitetet e CIOR dhe përcjellja e mendimeve të SHKURSH në CIOR. Aktiviteti vijoi me dhënien certifikatave në emër të shefit të SHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, certifikatat në emër të shoqatës për anëtarësinë e shoqatës në rrethe, si dhe trofeve për disa nga më të angazhuarit në mbarëvajtjen e shoqatës.

Kush është CIOR, roli i CIOR, mundësimi në transformimin e NATO-s

CIOR është Konfederata Ndër-aleate e Oficerëve Rezervë, organizatë jopolitike e nënshkruar nga vendet e Traktatit të Atlantikut të Veriut; CIOR është e themeluar në nëntor 1948, nga shoqatat e oficerëve rezervë të Belgjikës, Francës dhe Holandës. Marrëdhënia e CIOR me NATO-n është përcaktuar në dokumentin e Komitetit Ushtarak të NATO-s (MC 248/2 datë 27 korrik 2012). CIOR është një organizatë joqeveritare, jo politike dhe jofitimprurëse, e dedikuar për bashkëpunim dhe solidaritet

ndërmjet shoqatave kombëtare të ushtarakëve rezervë brenda Aleancës Euroatlantike. Konfederata promovon dhe organizon masa të avancuara trajnimi, seminare ndërkombëtare dhe takime pune për oficerët rezervë.

Edhe para Luftës së Dytë Botërore kishte kontakte midis shoqatave të oficerëve rezervë të Belgjikës, Francës dhe Holandës. Këto lidhje u ringjallën në vitin 1946 pas përfundimit të luftës. Më 20 nëntor 1948, ata çuan në kongresin e parë në Belgjike dhe themelimin zyrtar të "Konfederatës Ndër-aleate e Oficerëve Rezervë". Themelimi i saj lindi si nevojë e organizimit të ri politiko-ushtarak në kushtet e reja gjeopolitike pas Luftës Dytë Botërore. Kjo i paraprin në kohë themelimit të Aleancës ushtarake Euro-Atlantike - NATO (prill 1949).

Me kalimin e kohës u shtuan gradualisht vende të tjera si Luksemburgu (1952), Danimarka (1956), Greqia (1956), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (1958), Italia (1960), Gjermania (1961), Britania e Madhe (1963), Kanadaja (1964), Norvegjia (1966), Spanja (1992) dhe Estonia (1999). Pas viteve 90 në CIOR u pranuan fillimisht në programin e Partneritetit për paqe, edhe vendet e ish-bllokut komunist me statusin e vëzhguesit e më vonë me plotësimin e kushteve për anëtarësim në NATO, shoqatat e tjera u bënë anëtare me të drejta të plota në CIOR.

CIOR tani ka 34 vende pjesëmarrëse dhe vëzhguese dhe përfaqëson 1 milion rezervistë. Është organizata më e madhe e oficerëve rezervë ushtarakë në botë. Finlanda është vendi i pranuar kohët e fundit, pas pranimit si anëtare e NATO-s. Misioni i CIOR është të krijojë lidhje midis rezervistëve dhe autoriteteve ushtarake NATO-s; për të inkurajuar krijimin dhe përhapjen e lidhjeve ndërmjet oficerëve rezervë nga vendet pjesëmarrëse; dhe për të inkurajuar ato kombe që t'u ofrojnë rezervistëve detyra, të drejta, trajnime të barabarta dhe detyrime mobilizimi, duke respektuar dallimet dhe traditat e tyre kombëtare.

CIOR është një organizatë e dedikuar për bashkëpunim dhe solidaritet ndërmjet shoqatave kombëtare të ushtarakëve rezervë brenda Aleancës Euroatlantike. Konfederata promovon dhe

organizon masa të avancuara trajnimi, seminare ndërkombëtare dhe takime pune për oficerët rezervë. Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë aderon me të drejta të plota në këtë organizatë që prej vitit 2009. Roli i CIOR është të jetë avokat/zëri i rezervistëve në Aleancën e NATO-s, duke i dhënë rregullisht këshilla strategjike Kryetarit të Komitetit Usharak të NATO-s për çështjet e rezervës; dhe për të nxitur zhvillimin profesional të oficerëve rezervë; Për t'i ofruar këshilla NATO-s për çështjet e rezervës; CIOR është një zë për çështjet e rezervës për Aleancën e NATO-s dhe ofron këshilla për përdorimin më të mirë të forcave rezervë në një sërë mjedisesh operacionale, përveç studimit dhe promovimit të harmonizimit në role, detyra dhe të drejtat e rezervistëve në vendet aleate; CIOR gjithashtu kontribuon drejtpërdrejt në qëllimet e NATO-s, duke promovuar dhe përmirësuar bashkëpunimin dhe ndërveprueshmërinë midis forcave rezervë brenda Aleancës dhe partnerëve të saj. Ndërsa transformimi në NATO nënkupton koordinimin e kësaj përpjekjeje brenda një Aleance prej kombesh sovranë, duke lundruar në sfidat e paraqitura nga shumëllojshmëria e kulturave ushtarake, gjuhëve, konsideratave gjeopolitike, shqetësimeve unike të sigurisë kombëtare dhe faktorëve ekonomikë. CIOR sjell ekspertizën e tij kolektive në mbështetje të këtyre sfidave duke bashkuar kombet, duke zhvilluar dialogë të rëndësishëm ndërkulturor dhe duke ofruar një forum për qasje bashkëpunuese ndaj problemeve të përbashkëta.

CIOR mbledhet të paktën dy herë në vit, në verë dhe në dimër, duke punuar përmes komiteve që shqyrtojnë çështjet dhe ofrojnë analiza në lidhje me forcat rezervë. Çështjet tipike me interes përfshijnë kontributin e forcave rezervë në operacionet ndërkombëtare, ri integrimin e rezervistëve brenda komuniteteve të tyre përkatëse pas vendosjes jashtë vendit, ligjin e konfliktit të armatosur, ndikimin e zgjerimit të NATO-s në rezervat dhe mbështetjen e punëdhënësve për rezervistët.

Delegacionet punojnë para dhe gjatë kongreseve në komitetet CIOR si Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë (DEFSEC-C); Komiteti i Çështjeve Ligjore (LEGAL-C); Komiteti i Komunikimit Strategjik (STRATCOM-C); Komiteti i Bashkëpunimit Civilo-Usharak (CIMIC-C); Komiteti i Oficerëve të rinj (YRO-C); Komiteti i Gjuhëve të Huaja (CLA-C); Komiteti i garave Ushtarake (MILCOMP-C); Komiteti i Mbrojtjes Kibernetike (CYBER-C). Ndërsa seminari dimëror përfaqëson dhe zhvillon seminare të politikave të sigurisë mbi çështjet aktuale të politikës së mbrojtjes dhe sigurisë.

Përveç roleve të tyre si oficerë rezervë, shumë delegatë individualë të CIOR-it janë drejtues biznesi dhe industrialë, nëpunës publikë dhe akademikë shumë të arrirë. Prandaj, ata janë në një pozicion unik për të kontribuar në një kuptim më të mirë të çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes në popullatën në tërësi, si dhe sjelljen e ekspertizës dhe përvojës civile në detyrat dhe sfidat me të cilat përballen forcat rezervë në NATO.

Kontributet e CIOR në NATO, vlerat e CIOR, zhvillimi profesional

CIOR ndihmon NATO-n në iniciativat e shtrirjes, duke nxitur paqen përmes dialogut, duke ndihmuar në zgjerimin e anëtarësimit në NATO. Pjesëmarrja aktive në CIOR forcon përkushtimin kombëtar dhe lidhjet me Aleancën e NATO-s, e cila nga ana e saj u siguron vendeve pjesëmarrëse një reputacion të zgjeruar midis kombeve të Aleancës. CIOR kontribuon drejtpërdrejt në qëllimet e NATO-s, duke promovuar dhe përmirësuar bashkëpunimin dhe ndërveprueshmërinë midis Forcave Rezervë brenda dhe

jashtë NATO-s.

CIOR ofron programe unike, të kalibrit të lartë dhe me kosto efektive që janë në dobi të NATO-s, duke sjellë dukshmëri në vlerën e komponentit Rezervë, i cili përmirëson gatishmërinë ushtarake dhe efektivitetin operacional. CIOR është një organizatë e përkushtuar ndaj zhvillimit profesional, duke ofruar programe të kalibrit të lartë dhe me kosto efektive nga të cilat përfitojnë rezervistët individualë, vendet pjesëmarrëse dhe NATO. Kështu, është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi, i rinovuar në vitin 2019 me Komitetin Kombëtar të Forcave Rezervë (NRFC) të NATO-s për bashkëpunim më të ngushtë.

Kur një vend mbështet CIOR-in, ai investon në zhvillimin e rezervistëve kombëtarë dhe komunitetit ndërkombëtar rezervë, si dhe po kontribuon në NATO. CIOR është një organizatë e përkushtuar ndaj zhvillimit profesional dhe ofron një sërë programesh të kalibrit të lartë dhe me kosto efektive që përfitojnë rezervistët individualë, vendet e tyre anëtare dhe NATO-n në tërësi.

Disa nga mundësitë kryesore për zhvillim profesional të disponueshme në mënyrë unike përmes CIOR përfshijnë Gara Ushtarake (MILCOMP), ku mbi 250 atletë marrin pjesë në garat ushtarake të CIOR çdo vit; Oficerët e Rinj Rezervë (YROW) ku çdo vit, rreth 60 oficerë të rinj rezervë marrin pjesë në këtë seminar njëjavor, duke u përqendruar në çështjet aktuale të mbrojtjes dhe sigurisë që lidhen me çështjet e forcave rezervë brenda NATO-s dhe partnerëve të saj; Akademia e Gjuhëve CIOR (CLA), ku Akademia e Gjuhëve CIOR mëson anglisht dhe frëngjisht si gjuhë të dytë, duke theksuar leksikun ushtarak të NATO-s; Seminari Dimëror që mbahet çdo vit, për tre ditë para Takimit të Mes Dimrit (MWM); Ushtrimet e CIMIC, Komiteti CIMIC organizon një stërvitje vjetore civile-ushtarake (CIMEX) përpara Kongresit Veror të CIOR-it; Takimi i mesit të dimrit CIOR/CIOMR (MWM), zakonisht mbahet në shkurt në selinë e NATO-s. Prezantimet zakonisht jepen nga zyrtarë të NATO-s dhe SHAPE, si dhe nga Kryetari i Komitetit të Aleancës së NATO-s, të cilët ofrojnë udhëzime për delegatët dhe informacion mbi gjendjen aktuale të punëve të këtyre organizatave dhe implikimet për Aleancë; Kongresi Veror i CIOR/CIOMR, një vend i CIOR e pret këtë ngjarje në vendin e tyre me rotacion, zakonisht në korrik ose gusht. Një simpozium një ditë e gjysmë mbi çështjet e rezervës mbahet gjatë Kongresit për çështje aktuale me rëndësi për rezervistët nga të gjitha kombet. Simpoziumi tërheq folës në nivelet më të larta politike, ushtarake dhe akademike; Seminari i Partneritetit për Paqe (PfP): Komiteti i Partneritetit për Paqe i CIOR mban një seminar vjetor për anëtarët partnerë, i cili mbahet në vendet partnere.

15 vite SHKURSH me të drejta të plota në CIOR, procedurat e aderimit

Pjesë e rëndësishme e kontributit të SHKURSH janë edhe arritjet në fushën e integritetit Euroatlantik. Hapi i parë drejt anëtarësimit në CIOR ishte marrja e informacionit të nevojshëm mbi CIOR, masat që duheshin marrë, dokumentet që duheshin përgatitur se edhe pranimi në të bëhej gradualisht nëpërmjet statuteve, mik, vëzhgues dhe asociues, ndërsa anëtarësimi në të me të drejta të plota kushtëzohej me pranimin në NATO i vendit tonë. Kërkesat për njohje e bashkëpunim me shoqatat: Itali, Turqi dhe SHBA, por pa asnjë përgjigje, pasi ne na mungonin mjetet e komunikimit, si faks, e-mail etj. Me vonë iu drejtua Presidentit të CIOR, por kjo kërkonte njohje dhe aprovim nga lidërsi SHP dhe MM.

Nëpërmjet ambasadorit shqiptar të kohës në Gjermani dhe

atasheut ushtarak në Gjermani iu dërgua kërkesë Presidentit të CIOR, n/kolonel Erik Thiri, për kushtet e pranimit tonë në CIOR, i cili ngarkoi shoqatën e ushtarakëve rezervë Gjermani. Një ndihmesë për ne ishte ish-atasheu ushtarak i Gjermanisë në Shqipëri, koolonel Harmut Digutssch, i cili bashkëpunoi me ambasadorin dhe atasheun ushtarak shqiptar në Gjermani, të cilët udhëzuan shoqatën tonë mbi hartimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Pasi u njohëm me mundësitë, filluam takimet e bisedat me stafet në SHP dhe MM. Ishte domosdoshmëri aprovimi i kërkesës nga vendimmarrësit, SHP dhe MM. Por ndryshimet e qeverisë kërkuan të ribëjmë miratimin e lidershipit për aplikim në 2001. Në atë kohë theksohej se kushtet kryesore për pranim ishin: Shoqata të jetë e njohur me vendim gjykatë; Të jetë shoqatë kombëtare; Të njihet zyrtarisht nga autoritetet e larta të mbrojtjes.

Pasi u përgatit dokumentacioni i nevojshëm me ftesë të presidentit CIOR në 2002, u mor pjesë në seminarin e Sllovenisë. Prezenca e SHKURSH në seminarin CIOR në Lubjanë, Slloveni, 2002, bëri të mundur njohjen dhe shkëmbimin e eksperiencave me shoqatat ushtarake të NATO-s dhe atyre PfP.

Me ftesë të Presidentit të CIOR, n/kolonel Karsten Thuen (Danimarka), në korrik 2002 morëm pjesë në Kongresin e CIOR, në Strasburg, Francë. Gjatë zhvillimit të kongresit delegacioni ynë i paraqiti komitetit dokumentacionin e nevojshëm, ku aplikoi për të marrë statusin e vëzhguesit. Në mbledhjen e komitetit në mënyrë unanime shoqatës sonë iu dha statusi i vëzhguesit, i cili u pasua edhe në dy vitet e ardhshme 2003 dhe 2004.

Me ftesë të Presidentit CIOR, n/kolonel Filipe Imbolzano nga Italia, morëm pjesë në Kongresin e CIOR në Mahstrit, Holandë (21-26 shkurt 2003). Në këtë kongres morëm pjesë me statusin e Vëzhguesit. Në 2003, me ftesë të CIOR, morëm pjesë në workshopin e CIOR në "George Marshall Center" (Gjermani) në datat 13-16 nëntor 2003; dhe në 2004 në Kongresin e CIOR në Vjenë, Austri (26-31 korrik 2004), etj.

17-19 prill 2005 delegacioni i CIOR, vizitoi Shqipërinë dhe u takua me autoritete të larta të mbrojtjes, MM dhe SHSHPFA, të cilët pas shkëmbimit të mendimeve dhe ideve, kërkuan opinionet e vendimmarrësve për pranimin e shoqatës sonë në CIOR. 1-8 gusht 2005 në Gent, Belgjike, në Kongresin e CIOR-it, Shqipëria mori statusin e Asociuesit. Pas shtatë viteve përfaqësimi në aktivitetet e CIOR, në gusht 2009, në Kongresin e Sofjes, Bullgari, u pranua me të drejta të plota në CIOR. Tashmë shoqata jonë konsiderohet që mori pasaportën Euroatlantike dhe pranimi në CIOR është fryt i punës dhe i përpjekjeve disavjeçare me pjesëmarrje në seminare, kongrese, takime e vizita të ndryshme për të bindur vendimmarrësit jo vetëm për ligjshmërinë e shoqatës, por edhe për seriozitetin e saj për t'u bërë pjesë e kontribuar në misionin e saj.

Mbështetja e CIOR-it, aprovimi i drejtuesve të lartë ushtarakë dhe stafit të MM të viteve 2000 – 2009, bënë të mundur pranimin e shoqatës sonë me të drejta të plota në 2009. SHKURSH i Shqipërisë dallohet nga shoqatat e tjera për faktin se vetë programi i saj nuk është vetëm për të mbrojtur të drejtat ekonomike të ushtarakëve, por është gjithashtu pjesë përbërëse dhe kontribuon për sigurinë kombëtare dhe integrimin në Bashkimin Europian mbi bazën e një marrëveshjeje dhe autorizimi që ka me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, duke qenë pjesë përbërëse

dhe anëtare me të drejta të plota në Konfederatën Ndër-aleate të Oficerëve në Rezervë të NATO-s (CIOR).

Mbështetja e CIOR-it, aprovimi i drejtuesve të lartë ushtarakë dhe stafit të MM të viteve 2000 – 2009 bënë të mundur pranimin e shoqatës sonë me të drejta të plota me 2009. 8 gusht 2009, kongresi miratoi kërkesën e Shqipërisë për pranim me të drejta të plota në CIOR. Nga ajo periudhë rregullisht SHKURSH është pjesë e aktiviteteve vjetore në CIOR. SHKURSH është pjesë e saj që në fillimet e formimit të shoqatës, pas miratimit të MM/SHPFA (2001), në 2002 mori pjesë nën statusin e "Vëzhguesit" në CIOR deri në 2005; 4 gusht 2005 u pranua nën statutin "Bashkëpunëtor"; dhe më 8 gusht 2009, SHKURSH u pranua me të drejta të plota në CIOR.

Rrugëtimi për CIOR dhe procesi

Një pjesë e rëndësishme e kontributit të SHKURSH janë arritjet në fushën e integritetit euroatlantik. Kronologjia e aktivitetit të SHKURSH për anëtarësim drejt CIOR u mbështet në marrjen e informacionit për CIOR, marrjen e masave dhe përgatitja e dokumentacionit nevojshëm, pranimi në CIOR në mënyrë graduale përmes statusit, mik, vëzhgues dhe bashkëpunëtor. Ndërsa anëtarësimi me të drejta të plota kushtëzohej me pranimin e vendit tonë në NATO. Kurse procesi rezultoi në Kërkesë për njohje dhe bashkëpunim shoqatave të Italisë, Turqisë dhe SHBA-së; Kërkesë Presidentit të CIOR-it, për njohje; Përgatitja e dokumentacionit



nevojshëm, sipas ftesës presidentit CIOR në 2002 në seminarin e Sllovenisë; Më 26.7.2002 në mënyrë unanime shoqatës sonë iu dha statusi i vëzhguesit, i cili u pasua edhe në dy vitet e ardhshme 2003 dhe 2004; Në gusht 2005, në Kongresin e CIOR-it në Gent, Belgjikë, Shqipëria mori statusin e Asociuesit; Kërkohej njohja dhe miratimi nga udhëheqja e SHP dhe MM; Inspektime në vendin tonë nga CIOR, mbi procedurat dhe veprimtarinë e shoqatës; Pas shtatë viteve përfaqësimi në aktivitetet e CIOR, në gusht 2009, në Kongresin e Sofjes, Bullgari u pranua me të drejta të plota në CIOR. Tashmë shoqata jonë konsiderohet që mori pasaportën Euroatlantike "Anëtar".

Ushtria Amerikane i bashkohet betejës, nëse ndonjë prej këtyre vendeve shkon në luftë

Pas dy luftërave botërore shkatërruese, disa vende evropiane u lanë në gërmadha, duke humbur afërsisht 36.5 milionë banorë të tyre. Për të parandaluar konfliktet e ardhshme, Mbretëria e Bashkuar dhe Franca formuan një aleancë mbrojtëse në vitin 1947. Në vitin 1949, ky pakt u zgjerua duke përfshirë Belgjikën, Luksemburgun, Holandën, Shtetet e Bashkuara, Kanadanë, Portugalinë, Italinë, Danimarkën, Norvegjinë dhe Islandën, kolektivisht e njohur si Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Gjatë 75 viteve të ardhshme, anëtarësimi i NATO-s është rritur për të përfshirë më shumë se 30 vende, me Suedinë duke u bërë shtesa më e fundit në 2024.

Megjithatë, NATO nuk është e vetmja marrëveshje mbrojtëse e mbajtur nga Shtetet e Bashkuara. Në fakt, SHBA-ja është e

detyruar me traktat të mbrojtë mbi 50 vende sot.

Paradoksi i Aleancave Amerikane

Që nga fillimi, Shtetet e Bashkuara kanë pasur një qëndrim paradoksal ndaj pjesës tjetër të botës. Nga njëra anë, SHBA-të e shohin veten si një “Qytet në një kodër” - një tokë e lirisë që qëndron si shembull për pjesën tjetër të botës. Nga ana tjetër, kanë pasur një neveri për t’u përfshirë në “ngatërrim aleancash”. Për pjesën më të madhe të historisë së SHBA-ve, Oqeanet e paanë Atlantiku dhe Paqësori i dhanë Shteteve të Bashkuara një izolim të lumtur nga problemet e Botës së Vjetër. Kjo përfundoi kur Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore treguan se mospërfshirja mund t’i lejojë kërcënimet e huaja të dalin jashtë kontrollit aq sa mund të kërcënojnë Amerikën. Pra, përmes një sistemi aleancash, Shtetet e Bashkuara mbajnë një perimetër të thellë mbrojtës për



bregun perëndimor në Azi dhe bregdetin lindor në Evropë. SHBA-të punojnë me aleatët për të penguar rivalët e fuqisë kryesore dhe për të zhvilluar strategji për të kundërshtuar kërcënimet në zhvillim. NATO

Aleanca më jetike e Shteteve të Bashkuara është Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut. Ajo u themelua në vitin 1949 për të kundërshtuar Bashkimin Sovjetik ekspansionist dhe vazhdon të kundërshtojë ekspansionizmin rus edhe sot. NATO ka ndihmuar në sigurimin e paqes, stabilitetit dhe prosperitetit të paprecedentë për Evropën. Uniteti i aleancës zgjati më shumë se rivali i saj në Evropën Lindore, Traktati komunist i Varshavës, dhe përfundimisht thithi shumicën e anëtarëve të saj.

Kombet anëtare të NATO-s

Anëtarët e NATO-s sot janë: Shqipëria, Belgjika, Bullgaria, Kanadaja, Kroacia, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia e Veriut, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

Tre vende të tjera kanë shpallur synimin e tyre për t'u anëtarësuar në NATO: Bosnje-Hercegovina, Gjeorgjia dhe Ukraina. Anëtarësimi i Bosnjës është disi problematik për shkak të ndarjeve të thella etnike që kërcënojnë paqen dhe stabilitetin e vendit. Gjeorgjia nuk është plotësisht nën kontrollin e territorit të saj për shkak të ndërhyrjes paraprake të Rusisë në rajonet e diskutueshme dhe Ukraina është aktualisht e përfshirë në një luftë të plotë me Rusinë. Derisa të arrihen marrëveshjet e paqes me Rusinë, dy vendet e fundit nuk kanë gjasa të arrijnë anëtarësimin e plotë në NATO.

Kur NATO-ja mbrojti një anëtar...

Në nenin 5 të traktatit të NATO-s, vendet anëtare angazhohen që ta konsiderojnë një sulm ndaj secilit prej tyre si sulm ndaj të gjithëve. Hera e parë dhe e vetme që ky traktat u thirr ishte kur Shtetet e Bashkuara u sulmuan më 11 shtator 2001. Aleatët e tjerë të NATO-s ranë dakord se ky ishte një sulm ndaj të gjithëve dhe dolën në mbrojtje të Shteteve të Bashkuara.

Në një shprehje praktike të kësaj mbrojtjeje kolektive, NATO dërgoi 7 avionë të sistemeve të paralajmërimit dhe kontrollit të hershëm ajror (AWACS) nga Evropa në kontinentin e SHBA-së për të patrulluar qiellin dhe për të parandaluar sulme të mëtejshme. I quajtur Operacioni "Eagle Assist", ky mision zgjati 7 muaj. 830 anëtarë të ekuipazhit nga 13 vende të ndryshme të NATO-s mbrojtën qiellin amerikan për 4300 orë në mbi 360 fluturime operacionale.

Traktati i Rios

Që nga Doktrina Monroe e vitit 1823, Shtetet e Bashkuara i kanë ndaluar vendet evropiane të fillojnë koloni të reja në kontinentin amerikan. Kur Lufta e Ftohtë me Bashkimin Sovjetik filloi pas Luftës së Dytë Botërore, SHBA-të u përpoqën të forconin hegjemoninë e saj në Botën e Re me Traktatin Ndër-Amerikan të Ndihmës Reciproke të vitit 1947. Zakonisht quhet Traktati i Rios ose Pakti i Rios sepse u nënshkrua në Rio de Janeiro.

Traktati është një marrëveshje kolektive e mbrojtjes midis Shteteve të Bashkuara dhe mbi një duzinë vendeve të Amerikës Latine, me anë të së cilës një sulm ndaj njërit konsiderohet si sulm ndaj të gjithëve. Megjithatë, ndërhyrjet e shumta amerikane në Karaibe dhe Amerikën Qendrore, si dhe mbështetja e tij për Mbretërinë e



Bashkuar gjatë Luftës së Ishujve Falkland me Argjentinën, kanë dëmtuar reputacionin e traktatit me disa nga vendet e rajonit.

Anëtarët e Traktatit të Rios

Anëtarët aktualë të Traktatit të Rios janë Argjentina, Bahamas, Brazili, Kili, Kolumbia, Kosta Rika, Republika Domenikane, El Salvador, Guatemala, Haiti, Hondurasi, Panama, Paraguaj, Peru, Trinidad dhe Tobago, Shtetet e Bashkuara, Uruguai, dhe (ndoshta) Venezuela. Statusi i anëtarësimit të Venezuelës është i paqartë sepse qeveria e saj ka dërguar mesazhe kontradiktore në lidhje me qëllimet e saj.

Ish-anëtarë të Traktatit të Rios

Kuba u pezullua nga traktati në vitin 1962 për shkak të aleancës së saj me Bashkimin Sovjetik dhe përfshirjes në krizën e raketave Kubane. Për më tepër, shumë vende të Amerikës Latine u zhgënjyen kur Shtetet e Bashkuara mbështetën Britaninë në luftën e saj me Argjentinën mbi Ishujt Falkland. Kjo, dhe shqetësimet për përfshirjen e SHBA-së në luftërat në Lindjen e Mesme, bëri që Meksika të tërhiqej nga traktati në vitin 2002. Gjatë 15 viteve të ardhshme, Bolivia, Ekuadori dhe Nikaragua u larguan gjithashtu për të krijuar një aleancë të re të tyre.

Traktati ANZUS

Emri i plotë i traktatit ANZUS është Traktati i Sigurisë së Australisë, Zelandës së Re dhe Shteteve të Bashkuara. Ky pakt i sigurisë kolektive filloi në vitin 1951 për të zyrtarizuar bashkëpunimin midis këtyre vendeve anglisht-folëse për të ruajtur sigurinë në Paqësorin Jugor. Australia dhe Zelanda e Re ishin të shqetësuara për përhapjen e komunizmit në Azinë Juglindore dhe mendonin se Mbretëria e Bashkuar ishte shumë e preokupuar me çështjet evropiane për të ofruar ndihmën e duhur, kështu që ata i shikonin Shtetet e Bashkuara si një partner. Australia dhe Zelanda e Re dërguan forca për të mbështetur Shtetet e Bashkuara në Luftën e Vietnamit.

Zgjerimi dhe kontraktimi i ANZUS

Edhe pse asnjë vend i ri nuk iu bashkua ANZUS-it përveç tre vendeve origjinale, nga viti 1954 deri në 1977 ata të gjithë iu bashkuan një organizate të re traktati: SEATO (Organizata e Traktatit të Azisë Juglindore, e njohur gjithashtu si Pakti i Manilës). Kjo përfshinte Australinë, Francën, Zelandën e Re, Pakistanin, Filipinet, Tajlandën, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Pakistani u largua nga SEATO kur aleanca nuk arriti ta mbështeste atë në luftën e saj me Indinë. Kur Lufta e Vietnamit përfundoi në 1975, organizata humbi qëllimin e saj kryesor dhe u shpërbë disa vjet më vonë.

ANZUS nuk është shpërbërë, por në vitin 1984 Zelanda e Re e shpalli veten një zonë jo-bërthamore dhe refuzoi të lejonte nëndetëset amerikane me energji bërthamore të vizitonin portet e saj. Dy vjet më vonë, Shtetet e Bashkuara njoftuan se po pezullonin detyrimet e traktatit ndaj Zelandës së Re.

Traktatet dypalëshe të mbrojtjes

Shtetet e Bashkuara kanë nënshkruar traktate të mbrojtjes reciproke me disa vende që nuk janë pjesë e një aleance më të gjerë sigurie. Këto përfshijnë Filipinet (1951), Korenë (1953) dhe Japoninë (1960). Të tre janë në buzë të Paqësorit të Azisë, dhe të tre janë vende ku veteranët amerikanë kanë luftuar në të

kaluarën për liri, duke përfshirë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe Luftës së Koresë. Aleancat me këto vende ruajnë lirinë e deteve dhe përmbajnë ndikimin dhe ekspansionizmin e kundërshtarëve rajonalë: Rusisë, Koresë së Veriut dhe Kinës.

Aleatët kryesorë jo-NATO

Në epokën moderne, nuk është gjithmonë e dobishme të hysh në një aleancë formale me një vend tjetër, veçanërisht nëse Shtetet e Bashkuara duan të mbajnë marrëdhënie të mira si me atë vend ashtu edhe me rivalët e tij lokalë. Megjithatë, në vitin 1987, Kongresi miratoi legjislacionin që lejonte SHBA-në të hynte në marrëdhënie bashkëpunimi me miq të rëndësishëm të Shteteve të Bashkuara jo-NATO.

Statusi i "Aleatit të Madh Jo-NATO" u lejoi këtyre vendeve të marrin trajnime ushtarake të SHBA-së, të blejnë raunde anti-tanke të uranimit të varfëruar, të marrin pajisje dhe furnizime të tepërta ushtarake amerikane, të strehojnë rezervat e rezervave amerikane të luftës të pajisjeve në pronësi të SHBA-së, të marrin pjesë në kërkime bashkëpunuese dhe zhvillimi, fitimi i aksesit në teknologjinë hapësinore, marrja e financimit amerikan për blerjen ose dhënien me qira të pajisjeve mbrojtëse dhe përfitime të tjera.

Aleatët aktualë të mëdhenj, jo anëtarë të NATO-s

Vendet aktuale me statusin MNNA janë Argjentina, Australia, Bahreini, Brazili, Kolumbia, Egjipti, Izraeli, Japonia, Jordania, Kuvajti, Katari, Maroku, Zelanda e Re, Pakistani, Filipinet, Singapori, Koreja e Jugut, Tajlanda dhe Tunizia. Tajvani nuk ka status zyrtar MNNA për të shmangur provokimin e Kinës, por Kongresi ka mandaturuar që atij t'i jepen të njëjtat privilegje.

Statusi i MNNA nuk do të thotë se Shtetet e Bashkuara janë të detyruara nga traktati t'i mbrojnë këto vende. Megjithatë, SHBA-ja ka traktate dypalëshe të mbrojtjes me disa prej tyre siç përshkruhet më herët në këtë artikull. Vendi më i diskutueshëm në këtë kategori është Pakistani. Disa herë janë bërë mocione në Kongres për të hequr statusin e saj MNNA për shkak të pjesëmarrjes së tij të dobët në përpjekjet kundër terrorizmit.

Aleatët e ardhshëm të mundshëm të mëdhenj jo-NATO

Vendet në Evropën Lindore dhe Gjirin Persik janë sugjeruar si aleatë të mëdhenj potencialë jo-NATO që kanë nevojë për mbrojtje nga Rusia dhe Irani, respektivisht. Këto përfshijnë Armeninë, Gjeorgjinë, Moldavinë, Ukrainën, Arabinë Saudite, Irakun, Omanin dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Për shkak se statusi MNNA nuk kërkon që Shtetet e Bashkuara të vijnë në mbrojtje të këtyre vendeve, do të ishte e mundur edhe në raste si Ukraina, ku po zhvillohet një luftë aktive me Rusinë.

India është përcaktuar si një "Partner i madh i mbrojtjes" me shumë nga të njëjtat privilegje si një MNNA, por vetëm pak nga ai status i plotë. India është kombi më i populluar në botë, demokracia më e madhe në botë dhe një fuqi e madhe ekonomike dhe ushtarake në rritje. Është një partner i rëndësishëm me Shtetet e Bashkuara për të balancuar ambiciet e Kinës fqinje. Megjithatë, rivaliteti i saj i ashpër me Pakistanin do të thotë se SHBA-ja ka shumë të ngjarë të favorizojë njërin ose tjetrën. Në vitet e fundit, bashkëpunimi i papërsosur i Pakistanit në Luftën kundër Terrorit ka qenë megjithatë i dobishëm ndonjëherë në teatrin e Afganistanit.



Një pajisje e kontrollit të mendjes në distancë është zbuluar në Korenë e Jugut - me plane për të përdorur teknologjinë për procedurat mjekësore 'jo invazive'. Në një test, studiuesit ekspozuan minjtë e laboratorit ndaj fushave magnetike të krijuara për të reduktuar oreksin, duke çuar në një humbje prej 10 për qind të peshës trupore (4.3 gram).

Teknologjia e parë në botë e kontrollit të mendjes

Një pajisje kontrolli e mendjes në distancë, “me rreze të gjatë” dhe “vëllim të madh” është zbuluar në Korenë e Jugut - me plane për të përdorur teknologjinë për procedurat mjekësore “jo invazive”. Studiuesit me Institutin Korean për Shkencën Bazë (IBS) zhvilluan harduerin, i cili manipulon trurin nga një distancë duke përdorur fusha magnetike dhe testuan teknologjinë duke nxitur instinktet e “nënës” në subjektet e tyre të testimit femra: minjtë.

Në një test tjetër, ata ekspozuan një grup testimi të minjve laboratorikë ndaj fushave magnetike të krijuara për të reduktuar oreksin, duke çuar në një humbje prej 10 për qind të peshës trupore, ose rreth 4.3 gram.

“Kjo është teknologjia e parë në botë që kontrollon lirshëm rajone specifike të trurit, duke përdorur fusha magnetike”, sipas profesorit të kimisë dhe nanomjekësisë, i cili ndihmoi në kryesimin e përpjekjes së re.

Studiuesi, Dr. Cheon Jinwoo, drejtor i Qendrës IBS për Nanomedicine të Koresë së Jugut tha se ai pret që pajisja e re të përdoret për një sërë aplikacionesh të kujdesit shëndetësor, ku ai tha se ishte shumë i nevojshëm.

“Ne presim që ai të përdoret gjerësisht në kërkime për të kuptuar funksionet e trurit, rrjetet nervore artificiale të sofistikuara, teknologjitë e ndërfaqes tru-kompjuter të dyanshëm dhe trajtime të reja për çrregullimet neurologjike”, - tha Dr. Cheon.

Por pavarësisht cilësisë së fantashkencës së kontrollit të mendjes në distancë, ekspertët e shëndetit vunë në dukje se fushat magnetike janë përdorur me sukses në imazhet mjekësore për dekada.



“Koncepti i përdorimit të fushave magnetike për të manipuluar sistemet biologjike është tashmë i vendosur mirë”, - shkroi Dr Felix Leroy, një shkencëtar i lartë në Institutin e Neuroshkencave të Spanjës, në një shkrim që shoqëroi studimin e ri në Nanoteknologjinë e Natyrës.

“Është aplikuar në fusha të ndryshme, - vuri në dukje ai, - imazhe rezonancë magnetike [MRI], stimulim magnetik transkranial dhe hipertermi magnetike për trajtimin e kancerit”.

Risia e shtuar nga ekipi IBS i Koresë së Jugut ishte fabrikimi gjenetik i nanomaterialeve të specializuara, roli i të cilëve brenda neuroneve në tru mund të akordohej nga larg nëpërmjet fushave magnetike të zgjedhura me kujdes.

Teknika, e quajtur zyrtarisht gjenetika magneto-mekanike (MMG), udhëhoqi Dr. Cheon dhe kolegët e tij teksa zhvillonin teknologjinë e tyre të modulimit të trurit.

Në studimin e ri, të publikuar këtë korrik në “Nature Nanotechnology”, ekipi e quajti shpikjen e tyre Nano-MIND, për “Nano-Magnetogenetic Interface for NeuroDynamics”.



Shkencëtarët projektuan minj të veçantë për eksperimentet e tyre, duke përdorur një teknikë të zëvendësimit të gjeneve të njohur nga studiuesit si rikombinimi Cre-Lox.

Këta minj laboratorikë të inxhinieruar gjenetiki zhvilluan “kanale jonike” më të ndjeshme magnetike, të cilat veprojnë si porta në neuronet e tyre, ose qelizat e sistemit nervor, duke lejuar disa molekula dhe atome të hyjnë në kohë dhe ritme të caktuara. Në testin e grupit të “instinkteve të nënës”, stimulimi MMG i disa minjve femra laboratorike i inkurajoi ato të lokalizojnë dhe mbledhin “këlyshët” e tyre të humbur më shpejt në një kurs si labirint.

“Minjtë femra të stimuluar nga Nano-MIND filluan t'u afroreshin këlyshëve më shpejt - mesatarisht 16 sekonda më shpejt - dhe i morën shpejt të tre të vegjëlit në të gjitha sprovat”, - shkruan studiuesit.

Ekipi kreu gjithashtu një eksperiment dy-javor me grupin e kontrollit dhe minjtë e grupit eksperimental se si këto kafshë të modifikuara gjenetiki do të reagonin ndaj impulseve magnetike Nano-MIND, duke i inkurajuar ata të hanë më shumë ose të hanë më pak.

Teknologjia u tregua e aftë për të inkurajuar minjtë të hanë tepër dhe të hanë më pak, pra të kontrollojnë sasinë e të ngrënit.

Në eksperimentin në të cilin sinjali MMG inkurajoi minjtë për të ngrënë, pesha e tyre trupore u rrit mesatarisht me rreth 7.5 gram, që do të thotë afërsisht një rritje prej 18 për qind në peshën e trupit.

Impulsi magnetik i agjërimit bëri që minjtë të humbnin më pak (10 për qind humbje të peshës trupore ose rreth 4.3 gram), por në mënyrë të konsiderueshme nuk i ngadalësoi minjtë apo pengoi aftësinë e tyre për të lëvizur.

“Ushqyerja e reduktuar nuk ndikoi në lëvizjen e tyre”, - shkruan ata, duke nënkuptuar se efekti ishte thjesht në oreks dhe ndryshe nuk pengonte aftësinë e minjve për të vepruar.

Teknologjia, shkroi Dr. Cheon dhe ekipi i tij, do të gjejë përdorimin e saj më të menjëhershëm për të ndihmuar studiuesit e shëndetit të kuptojnë se cilat pjesë të trurit dhe pjesa tjetër e sistemit neurologjik janë përgjegjëse për cilat gjendje shpirtërore dhe sjellje të tjera.

Por në artikullin e tij të opinionit mbi inovacionin Nano-MIND dhe aspektin e tij të zëvendësimit të gjeneve, Dr. Leroy në Spanjë paralajmëroi që të mos nxitohemi shumë shpejt për testimin njerëzor.

“Duhen studime të mëtejshme për të vlerësuar efektet e mundshme kumulative, duke përfshirë neuropërshtatjen ose neurotoksitetin”, - këshilloi Dr. Leroy.

LOJËRAT OLIMPIKE "PARIS 2024", SHQIPËRIA SHKRUAN HISTORINË ME DY MEDALJE BRONZI



Valiev dhe Dudaev: Synojmë medalje të artë, Shqipërinë e kemi në zemër

Chermen Valiev dhe Islam Dudaev ishin dy heronjtë e Shqipërisë në Lojërat Olimpike "Paris 2024". Ata që të dy janë sportistë të Sport Klub Tirana dhe shënuan rezultatin historik, duke fituar dy medaljet e para olimpike për Shqipërinë, në disiplinën e mundjes. Chermen Valiev dhe Islam Dudaev shkruan historinë për vendin tonë në Olimpiadë, duke sjellë dy medalje të bronzta, të parat për përfaqësuesen shqiptare në këtë eveniment dhe që nuk kishte ndodhur kurrë më parë.

Delegacioni që përfaqësoi Shqipërinë në Lojërat Olimpike "Paris 2024" mbërriti në Tiranë, më 12 gusht 2024. Ata u pritën, me një ceremoni të dedikuar, tapet të kuq dhe me lule. Në dalje të aeroportit, qindra tifozë ishin prezent për të pritur dy kampionët kuqez.

Pasi mbërritën në Rinas dhe sollën dy medaljet e para historike për vendin tonë, Chermen Valiev dhe Islam Dudaev folën për mediat edhe pse jo me shumë fjalë, ata folën në shqip për këtë arritje, duke shpresuar që në Lojërat e tjera Olimpike të arrijnë një sukses edhe më të madh. Në fjalën e tyre, të dy sportistët thanë se kërkojnë medalje të arta për vendin tonë.

"Faleminderit Shqipërisë, e kam në zemër", - tha Valiev, që shtoi entuziazmin të tifozët. Ndërsa Islam Dudaev nga ana e tij tha se synon edhe më tepër, duke kërkuar medaljen e artë. "Jam shumë i lumtur, do Zoti në herën tjetër medalje të artë për Shqipërinë", - tha Dudaev, duke shpërthyer entuziazmin mbështetësit e tij në ovacione dhe duartrokitje. Edhe kreu i Federatës Shqiptare të Mundjes në një prononcim për mediat vlerësoi sportistët që i siguruan Shqipërisë dy medalje

bronz në lojërat Olimpike. Ai tha se rrugëtimi dhe misioni tashmë ishte përbushur. "Jam krenar për atë që kemi bërë. Falënderoj të gjithë. Është një rrugëtim dhe mision i përbushur tashmë, dhe shpresoj që ky rrugëtim mos të mbarojë këtu", - tha kreu i Federatës Shqiptare të Mundjes, Sahit Prizreni.

Duke futur Shqipërinë në listën e medaljeve olimpike dhe duke shkruar historinë për sportin shqiptar, Chermen Valiev dhe Islam Dudaev, ngritën flamurin kuqez në Paris, duke bërë ëndrrën realitet, flamurin e Shqipërisë dhe flamurin e Sport Klub Tiranës, që është thelbi i ekipit olimpik shqiptar. Këta sportistë u kthyen në ambasadorët më të mirë të Shqipërisë, e cila kishte synim një medalje Olimpik dhe ia doli me dy, që janë të parat gjithashtu edhe për klubin dhe për atletët shqiptarë. Duke bërë që flamuri shqiptar të shkonte në majat më të larta të aktiviteteve sportive, siç janë lojërat olimpikë, këta sportistë janë gur themeli për të ardhmen e sportit dhe për të dhënë mesazhin se për sportin duhet bërë më shumë.



Fitues i këtyre Lojërave Olimpikë u shpall ekipi i SHBA-së me 40 medalje ari, 44 argjend dhe 42 bronz, 126 në total. SHBA-ja rikthehet edhe një herë të jetë dominues në eventin më të rëndësishëm sportiv në glob. Përcaktues në këtë rezultat final ishte medalja e fundit e artë e fituar nga femrat në basketboll të cilat mposhtën Francën me rezultatin e ngushtë 67-66. Në vendin e dytë u rendit Kina me 40 medalje ari, 27 argjend dhe 24 bronz, 91 medalje në total. Në vendin e tretë Japonia, e ndjekur nga Australia dhe Franca.

Me një ceremoni mbresëlënëse, Parisi mbylli këto Lojëra Olimpikë, për t'i lënë stafetën Los Anxhelos, vendi që do të mirëpres Lojërat Olimpikë në 2028.

Ecuria e Shqipërisë në Lojërat Olimpike “Paris 2024”

Parisi për shqiptarët do të kujtohet përjetësisht si qyteti ku për herë të parë siguroam medalje olimpike, madje jo një, por dy të tilla, dy medalje bronz që e vendosin Shqipërisë mes vende që kanë fituar medalje olimpike.

Mundja kuqezi dhuroi spektakël, kur Valiev dhe Dudaev siguruan dy medalje olimpike, me shpresën që ky të jetë një fillim i ri. Në fund të Lojërave Olimpike, dy medaljet e mundjes e vendosin Shqipërinë në vendin e 80-të nga 91 shtete pjesëmarrëse.

Ishte data 10 gusht kur Chermen Valiev shkroi historinë në “Paris 2024”. Ai fitoi medaljen e parë për Shqipërinë në historinë e Lojërave Olimpike, duke mposhtur me rezultatin 6-2 në finalen për medaljen e bronzit Viktor Rassadin nga Taxhikistani, në stilin e lirë në mundje në peshën deri në 74 kg.

Pas të parës erdhi medalja e dytë për Shqipërinë nga mundësi Islam Dudaev, i cili mundi numrin një të botës në peshën 65 kg, hungarezin Iszmail Muszukajev, në kategorinë stil i lirë. Veç dy sportistëve që i dhuruan medalje vendit tonë, pjesë e këtij eventi ishin edhe gjashtë sportistë të tjerë që nuk mundën të siguronin medalje.

Sot sportistët elitarë të ngjyrave të Shqipërisë në kompeticionet ndërkombëtare, jo vetëm shpërblehen më mirë se sa në shumë vende të Europës për rezultatet e larta në arenën e më të mirëve, po as nuk mbeten më pa mbështetje “kur varin këpucët e garave në gozhdën e fundit të aktivitetit sportiv”. Ata janë të integruar në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, me grada sipas rezultateve, pagë deri në fund të jetës aktive, si edhe pension në bazë të gradës. Madje në këtë grup nderimi kombëtar, përfshihen edhe kampionët olimpike të Kosovës.

Kush është Chermen Valiev, që i dha Shqipërisë medaljen e parë Olimpikë në histori

Chermen Akhsarbekovich Valiev ka lindur, më 10 dhjetor 1998, në Osetinë e Veriut në Rusi dhe aktualisht është një mundës i stilit të lirë që garon në 74 kilogramë për Shqipërinë.

Për vendlindjen e tij, Rusinë, Valiev ka fituar një titull kampion bote dhe një Evropian për U23, një kampion kombëtar rus dhe është fitues i shumëfishtë medaljeve të arit në turnetë ndërkombëtare.

Që nga transferimi në Shqipëri në vitin 2024, Valiev u kualifikua për të përfaqësuar Shqipërinë në Lojërat Olimpikë Verore 2024, në Paris duke u renditur i treti në Turneun Olimpik Botëror të Kualifikimit. Shqipëria ka marrë pjesë në dhjetë turne të Lojërave dhe pjesëmarrja



e mundësit Chermen Valiev në ekip i dha Shqipërisë medaljen e parë historike në Lojërat Olimpikë, duke siguruar të bronzën në stilin e lirë deri në 74 kilogramë.

Në dhjetë pjesëmarrjet e vendit tonë në Olimpiada, kjo është hera e parë që kuqezinjtë marrin medalje. Veç anës morale dhe suksesit absolut, si dhe vlerës monetare nga shteti shqiptar, Valiev merr edhe gradën honorifike ushtarake ‘kolonel’.

Epilogu, mbyllet Lojërat Olimpikë “Paris 2024”

Në ndryshim nga ceremonia hapëse, me një ditë më shi në lumin Senë, ceremonia mbyllëse nisi pas perëndimit të diellit në kryeqytetin francez. Kënga e Edith Piaf “Sous le ciel de Paris” (“Nën qiellin e Parisit”), kënduar nga Zaho de Sagazan dhe kori i Akademisë “Haendel-Hendrix” shënuan fillimin e ceremonisë të mbylljes së Lojërave Olimpikë në Paris.

Kjo ishte një shfaqje e planifikuar që të zgjaste për gati tre orë në “Stade de France”, që përfshiu dorëzimin për në Lojërat e ardhshme 2028 në Los Anxhelos.

Sensacioni francez i notit, Léon Marchand, simbolikisht mori flakën nga kazani olimpik, në kopshtet e Tuileries, për në stadium, ku edhe u shua më vonë, sipas DPA.

Rreth 270 interpretues mahnitën spektatorët në stadium dhe miliarda të tjerë në mbarë botën përmes televizionit dhe transmetimeve të drejtpërdrejta, në fund të Lojërave që u hapën, më 26 korrik.

Në këtë ceremoni u përfshinë edhe Billie Eilish, Red Hot Chili Peppers dhe Snoop Dogg. Parada e atletëve nuk ishte sipas vendit, por në një përzierje kombesh, me mbajtës të flamurit, duke përfshirë heroin francez të regbit Antoine Dupont, notaren amerikane Katie Ledecky dhe triathletin britanik Alex Yee.

U përfshi gjithashtu ceremonia e fitores për maratonën e femrave, e fituar nga holandezja Sifan Hassan, 36 orë pas një bronz në 10 000 metra dhe shtatë ditë pas një bronz në 5 000 metra.

Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach mbylli zyrtarisht Lojërat, të fundit të tij pasi ai do të largohet vitin e ardhshëm, ndërsa krye bashkiakja e Parisit, Anne Hidalgo i dorëzoi flamurin olimpik homologues së saj të Los Anxhelosit, Karen Bass, të cilin më pas e mori ylli i Hollivudit, Tom Cruise.

Ceremonia e mbylljes së Lojërave u mbajt para 71 500 spektatorëve në stadiumin “Stade de France”, të cilët duartrokitën gjatë parakalimit të rreth 9 000 atletëve, me flamuj të shteteve të tyre në duar.



Atdheu përjetë mirënjohës!

Në panteonin e artë të historisë së kombit kulmon një nga ngjarjet më të mëdha, epopeja e ngadhënjishme e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Kjo luftë në rrugëtimin e kombit shkroi lavdinë e tij. Sado që kohët ecën dhe largojnë madhësinë hyjnzuese të kësaj epopeje, gjaku i derdhur i bijave dhe bijve të kombit thërret në histori, thërret për atë çka ata dhanë jetën në lulen e rinisë.

Liria për të ishte gjëja më e shenjtë, ishte mbi jetën. Me patosin e shpirtit, rrokën armët qindra e mijëra vetë e iu ngjitën maleve në luftë, ku shkruan një histori dritëdhënëse, përballë një armiku të egër, të madh, çnjerëzor, që kërkonte të rrëronte e zhdukte lirinë e kombit, ekzistencën e tij. Por një popull i tërë, i etur për liri, që kishte treguar se atdheu ishte më i shtrenjtë se çdo gjë, shkroi histori të pa treguar, që sot ngelen si gurë themeli të kujtesës së tij historike. Pëllëmbë e tokë, gjak e histori, partizanët, bijtë e tij, kumtuan mesazhin e madh se gjaku i derdhur do të ishte flamuri i kombit, lartësimi i tij në çdo moment të jetës, flamuri dhe ylli ishin që i udhëhoqi në përpjekje, në betejë, në gjakderdhje, kur dhe shokët i binin pranë, ata ngritën lart atë flamur që simbolizon sot qytetërimin tonë.

Mustafa Matohiti, Hero i Popullit

Mustafa Matohiti u lind në Lekdush, më 15 nëntor 1912. Mbaroi shkollën fillore dhe atë plotore në Delvinë. I ati Sabriu rropatej në punë të ndryshme për bukën e gojës, por të birin donte ta shkollonte. Varfëria dhe shtypja ziente përbrenda çdo zemre. Mustafai ishte 17 vjeçar, kur më 28 nëntor 1929, në Gusmar, qendër e n/prefekturës së Kurveleshit, mori iniciativë dhe tha: “Neve kurveleshasve na urrejnë armiqtë e kjo na gëzon dhe do t’i luftojmë akoma më shumë”. Kjo protestë tregon jo vetëm urrejtjen kundër padrejtësive, por edhe zgjuarsinë dhe guximin e Mustafait.

Në vitin 1929 Mustafai u punësua në Tiranë, tek një farmacist. Donte të vazhdonte shkollën, por askush nuk e ndihmonte. Me durim dhe vullnet fitoi në një konkurs provimesh dhe u fut në një shkollë oficerësh. Në shkollë u lidh ngushtë me Asim Vokshin, Hero i Popullit. Në verën e vitit 1933 mbaroi shkollën dhe doli oficer për artilerinë. Emërohet në Elbasan, ku njihet me shumë elementë antizogistë, të cilëve u liste për historinë dhe luftërat e popullit tonë për liri dhe pavarësi. Në maj 1937 e arrestuan xhandarët e Zogut për veprimtarinë atdhetare dhe e burgosën në Tiranë. Regjimi zogist e përjashtoi nga radhët e ushtrisë dhe i dha banim të detyrueshëm në Delvinë. Madje qeveria zogiste



**“Neve kurveleshasve na urrejnë
armiqtë e kjo na gëzon dhe do
t’i luftojmë akoma më shumë”.**

**Kjo protestë tregon jo vetëm
urrejtjen kundër padrejtësive,
por edhe zgjuarsinë dhe guximin
e Mustafait.**

ia kishte shënuar emrin në defterin e njerëzve më të rrezikshëm të regjimit. Pas kësaj, Mustafanë e dërguan me banim të detyrueshëm në Lekdush nën një mbikëqyrje të rreptë. Në nëntor 1938 ai arratiset dhe shkoi në Greqi me shpresë që të shkonte në Luftën e Spanjës, ku ndodheshin Asim Vokshi, Petro Marko, Ramiz Varvarica e të tjerë, por autoritetet greke e ndaluan dhe e dorëzuan te xhandarmëria shqiptare, ku për dy muaj ai iu nënshtrua torturave.

Agresionin fashist, të 7 Prillit 1939, e priti me një zemërim prej atdhetari të vërtetë. Në 1941 u ndodh në Piqeras, ku zhvilloi veprimtarinë patriotike në bashkëpunim me Mitro Xhanin. Më 18 mars 1942, në kujtim të Luftës së Mashkullorës nga çeta e Çerçiz Topullit, Mustafa Matohiti para autoriteteve dhe popullit mbajti një fjalim të zjarrtë patriotik. Në fund ai nga gjiri nxori një flamur kombëtar, mbi të cilin qe shkruar: "Sot me flamur shpalosur, nesër me pushkë në dorë malevel!". Kështu deklaroi Mustafai në Mashkullorë dhe ai s'la katund e kasolle pa ligjëruar si bilbili për idealet e luftës për liri. Me udhëzim të Qarkorit të PKSH-së për Gjirokastrën, në lajthitë e Gusmarit, në prill 1942, formoi çetën partizane, ku komisar të saj luftëtarët e lirisë caktuan Mustafa Matohitin... Me iniciativën, pjekurinë e maturinë, Mustafai brenda muajve mars-maj 1942, krijoi në zonën e Kurveleshit këshillat antifashiste nacionalçlirimtare dhe njësitë e armatosura pranë tyre... Në maj 1942, në Kuç u formua celula e parë komuniste për Kurveleshin dhe sekretar u caktua Mustafa Matohiti, i cili ishte njëkohësisht dhe komisar i çetës së parë partizane të krahinës.

Më 28 nëntor 1942, në ditën e 30-vjetorit të Pavarësisë Kombëtare, në krye të 250 kryengritësve kurveleshas, sulmon administratën fashisto-zogiste dhe me trimëri, guxim e mençuri korri një fitore historike që pati një mbështetje të madhe mbarë popullore në Kurvelesh e më larg. Kurveleshi u çlirua nga vargonjtë e mercenarëve dhe pushtuesve fashistë.

Mustafa Matohiti ishte njeri i aksionit të guximshëm, por ai shquhej edhe për oratorinë e përsosur. Fjala shpatë e barut e Mustafait që bashkë me Mehmet Shehun dhe Abaz Shehun demaskuan me argumente krerët ballistë Ali bej Këlcyra, Rasim Babameto, Zenel Gjoleka, atje në rrapet e Dervenit, më 4 maj 1943. E ku nuk shkeli këmba e Mustafait!? E njohu Kurveleshi, Lopësi e Mesapliku, Buzi, Rrëzoma e Krahësi, Bënça, Bregdeti e Përmeti, Kardhiqi, Gjirokastra e Mallakastra, Zagoria, Dëshnica e Poliçani, Tepelena e Konispoli... Aftësitë drejtuese, organizuese dhe fryma luftarake e tij u shfaqën edhe kur u emërua komisar i Grupit të Katërt "Çamëria", apo kur u caktua komisar i Brigadës VI Sulmuese, më 26 janar 1944. Brigada VI Sulmuese zhvilloi shumë beteja dhe në njërën prej tyre, në atë të 29 marsit 1944, në Mërgëlliç, Mustafa Matohiti, Dino Kalenja, Lefter Talo dhe Meleq Gosnishti, të katër Heronj të Popullit, me gjakun e tyre të kulluar do të shkruanin pavdekësinë dhe lirinë që do të vinte më 29 nëntor 1944, përmes pushkës fitimtare partizane.



Meleq Gosnishti, Hero i Popullit

U vra gjatë luftimeve për marrjen e kalasë së Margëlliçit në Patos, më 30 mars 1944. Lindi në fshatin Gosnisht të Përmetit. I biri i Iliaz dhe Hatixhe Gosnishtit. Qe fëmija më i madh nga shtatë fëmijët e kësaj familje. Emigroi që në moshën 14 vjeçare drejt Parisit dhe u kthye më vonë për të marrë pjesë në Luftën për çlirimin e Vendlit. U vra teksa po luftonte në Kalanë e Margëlliçit së bashku me të tjerë partizanë dhe me shokun e tij, Heroin e Popullit, Mustafa Matohitin. Dy ditë pas vrasjes së tij, në Tiranë gjeti vdekjen dhe vëllai i tij i vogël Zini Gosnishti. Varri i tij gjendet ende në rrethin e Përmetit. Për nder të këtij hero i ka marrë emrin e tij një ndër shkollat më të mira 9-vjeçare të rrethit të Përmetit, gjimnazi i Patosit dhe një rrugë në Tiranë.

Mustafa Gjinishi, komisar i parë i çetës partizane të Pezës



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Peqini e kishte bir dhe mësues

Në fund të fundit komunist ishte Mustafai... në fund të fundit Mustafa Gjinishi ishte nacionalist. Po ai ishte komunist, komunist idealist dhe nacionalist se e donte Shqipërinë me Kosovë e Çamëri. Mustafai ishte më popullor, me reputacion në Shqipëri, më i respektuari, më i ëmbli, më i dashuri... Italianët dhe gjermanët Mustafa Gjinishi, Myslim Pezën... i kërkonin kudo... Mustafa Gjinishi në kryengritjen e Fierit, për aktivitetin e tij, Zogu e dënoi me varje. Por, ishin mbi 15 figura të dëguara dhe me reputacion të Peqinit që i dërguan Zogut telegram për faljen e jetës. Populli i krahinës së Peqinit kishte Mustafa Gjinishin për idhull, bir dhe mësues të tij. Prezenca, fjalët dhe porositë, shembulli frymëzues i tij, do të bënin që nga krahina e Peqinit të dilnin në luftë shumë partizanë, duke shkuar kryesisht në Pezë, në çetën me komandant Myslim Peza dhe me komisar Mustafa Gjinishi. Pjesa më e madhe e luftëtarëve, si ilegalë dhe partizanë kërkoheshin të kapeshin nga pushtuesi, duke i etiketuar dhe si bashkëluftëtarë "të rrezikshmit" Mustafa Gjinishi. Mustafai shfletonte libra të ndryshëm në bibliotekën e pasur të dajës së tij, patriotit të njohur të Peqinit Mahmud Kaziu. Mustafai kishte për dëshirë të shfletonte në gjuhën frënge, të cilën ia mësonte daja. Shfletonte librin që fliste për Napoleon Bonapartin dhe shikonte vizatimet e pikturat në libër, betejën e Vaterlosë, luftën e Borodinos, ishullin e Elbës, ku Bonoparti u internua etj. Mustafai mësoi dhe nga fjalori i Sami Frashërit, të cilin Mahmud Kaziu e kishte si gjënë më të shtrenjtë dhe me vlera. Fjalori mbi 1000 faqe është dhe sot i ruajtur nga familja Kaziu në Peqin, i cili është botuar mbi 135 vite më parë.

Babai, Adem Gjinishi ishte një personalitet në luftën për pavarësi të vendit, kundërshtar politik i Vërlaçit dhe i Zogut. Ishte delegat në Kongresin e Lushnjës 1920, mik i ngushtë i patriotit elbasanas, Aqif Pashë Elbasani. Adem Gjinishi ishte politikan më me influencë i Peqinit e më gjerë. Ai ishte tepër guximtar, burrëror e me karakter, urrente padrejtësitë dhe abuzimet. Shkroi në shtypin e kohës për qeverinë dhe ministrat, për pandershmeri në zgjedhje, si skandale të turpshme etj. Adem Gjinishi ishte kandidat për deputet i Partisë Popullore, opozitare me Zogun, por u vra në prag të zgjedhjeve në vitin 1923. Vrasja e tij bëri

jehonë në shtypin e kohës... Babai Adem kishte fëmijë Rexhep, Mustafa, Xhemile dhe Fitnete.

E lidhi idealin me njerëz të shquar...

Mustafai ka lindur më 15 janar 1912 në Peqin. Prindërit e tij ishin Adem dhe Rukie Kaziu. Rexhepi, vëllai i madh u interesua për ecurinë e mësimeve të Mustafait, ku mbas shkollës unike në Peqin, vazhdoi Shkollën Teknike Amerikane të Harry Fultz-it në Tiranë, në vitet 1924-1930. Ai shkëlqeu në të gjitha drejtimit dhe ishte studenti më i vlerësuar, për maturinë, oratorinë e reputacionin që gëzonte në shkollë. Studioi në shkollë libra të iluministëve francezë Volter, Ruso etj., ishte për ide të reja progresiste. Në shkollë përqafoi idealet komuniste që ishin frymëzuese të kohës. Pas përfundimit të Shkollës Teknike ishte përfaqësuesi i Ali Kelmendit për përhapjen e ideve komuniste. Në karakterin e tij kishte dhe ide e koncepte demokratike. Shkolla Teknike u bë vatra e parë e edukimit dhe rritjes së nivelit kulturor të Mustafait e të fillimit të aktivitetit të tij patriotik, duke përqaftuar ide të reja për përparimin e vendit. Në vitet në vijim mbante lidhje me studentët e shkollës, duke përhapur aty idetë komuniste, përparimtare të kohës. Në shkollë ishte zgjedhur sekretar i klubit të letërsisë së shkollës dhe në vitin 1932 u zgjodh drejtues-sekretar i përgjithshëm i të gjithë graduantëve (të diplomuarve) të të gjithë viteve që kishin mbaruar Shkollën Teknike. Pas përfundimit të Shkollës Teknike, kërkoi të studionte për diplomaci jashtë shtetit por regjimi i Zogut, nuk i siguroi të drejtë si i dyshimtë... hapi në Tiranë dhe më pas në Kavajë librari me literaturë përparimtare të kohës...

Në vitet 1930-1935 Mustafai e lidhi idealin me njerëz të shquar si Ali Kelmendi, Riza Cerova, Skënder Luarasi, Asim Vokshi, me patriotin e tij Demir Godelli, me Tajar Zavalanin, Petro Marko etj. Në këtë rreth të shquar intelektualësh, bisedonte, punonte dhe vepronte dhe Mustafai i ri. Në Tiranë u krijuan çelulat e para të përhapjes të ideve komuniste, ku bënte pjesë dhe Mustafai. Duke mbajtur lidhje me Shkollën Teknike Amerikane, filloi të bashkëpunonte ngushtë me qarqet revolucionare në Tiranë. Nga fundi i vitit 1933 u arrestua dhe u dënua për politikë, për grupin e krijimit të partisë komuniste. Veprimtarinë politike në burg nuk e pushoi, por komunikonte me letra me shokët, bashkëpunonte dhe udhëzonte. Komunikonte me Riza Cerovën, dhe në këmbishën e shokut të qelisë i shkroi letër, por letra mbërriti tek shefat e burgut dhe filluan mbi Mustafanë torturat... ku mbas dështimit të kryengritjes së Fierit, djaloshi Mustafa Gjinishi, i cili edhe pse i burgosur qysh kohë më parë për faje politike, dënohet prapë në gjyqin politik të Fierit... patriotët e Peqinit me mençuri dhe diplomaci i kërkuan Zogut heqjen e dënimit me vdekje, "për mos me u lanë një njollë këtij populli", u dënua me 101 vite burg. Mustafai nga burgu, nëpërmjet Demir Godellit, propozonte që të shkonin në frontin e lirisë vullnetarë në Spanjë, shokë të rinj dhe të shëndetshëm...

Organizoi forcat komuniste dhe popullin për luftë

Mustafa Gjinishi, para 7 prillit 1939, ishte amnistuar dhe po ngrinte



zërin për pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste... emigroi në Jugosllavi. Fashistët e kërkonin në Shqipëri. Në Beograd u krijua i ashtuquajti "Shtabi i solidaritetit me Jugosllavinë", ku kryetar i shtabit ishte Mustafa Gjinishi. Pas dy vitesh i arratisur në Jugosllavi, kthehet në atdhe, duke hyrë nga Shqipëria e Jugut në prill 1941. U lidh me grupin komunist të Korçës dhe më pas shkoi në Pezë, ku patrioti dhe luftëtari Myslim Peza kishte ngritur çetën e tij. Bashkëpunimi me Myslim Pezën ishte i ngushtë. U bë anëtar i PKSH-së që në themelimin e saj, më 8 nëntor 1941. Aksionet e para ishin: organizimi i demonstratës antifashiste më 28 nëntor 1941, në Tiranë. Ishte komisar i parë i çetës partizane të Pezës, duke pranuar komunistë në Pezë Vasil Shanton, Qemal Stafën, Mihal Durin etj. Organizoi aksionin gueril për lirin nga burgu fashist të Peqinit të Miladin Popoviçit. Bëri organizimin e forcave komuniste dhe të popullit në luftë kundër fashistëve italianë e gjermanë. Punoi për rritjen e efektivit të çetës së Pezës kryesisht nga Tirana, Durrës, Shijak, Kavajë, Peqin, Elbasan, Lushnjë etj., të cilat u bënë baza të fuqishme të luftës partizane. Mustafai për këto aksione dhe përkushtimin ndaj lëvizjes, kërkohet nga milicia fashiste, i cili konsiderohej prej tyre si i "jashtëligjshëm". Por ishte guximi i tij, që iu hodh në fyt komandantit të xhandarmërisë së Peqinit, i cili nuk bëri zë, por i dorëzoi të gjitha armët për partizanët. Kudo jepej alarmi për kapjen e të "rrezikshmit", i cili ishte ndër më të kërkuarit nga pushtuesi. Ai mbante pseudonime të ndryshme si "Alfi", "Xhindi", "Dajë", "Tafari" etj.

Mustafa Gjinishi kontriboi dukshëm për zhvillimin e Konferencës së Pezës më 16 shtator 1942. Idetë e tij që zunë vend ishin "luftë okupatorit pa dallim feje, krahine e ideje". Këtu u takuan komunistë e zogistë, nacionalistë e pa parti, gjithsej 18 delegatë, të cilët zgjodhën Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar prej 8 vetash, ku 3 ishin komunistë (Y. Dishniça, E. Hoxha dhe M. Gjinishi) dhe 5 nacionalistë (M. Peza, Baba Faja, A. Kupi, N. Çoba

dhe K. Qafmolla). Ishte mbledhja e parë ku të gjithë shqiptarët ishin bashkë, e nuk kishin nëpër këmbë të huaj. Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar zgjodhi kryetar nacionalistin Kamber Qafmolla dhe sekretar komunistin Mustafa Gjinishi. Dihet roli i Mustafait në këtë këshill, pasi K. Qafmolla ishte i sëmurë dhe më pas u largua nga këshilli. Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm, Mustafai ishte një ndër anëtarët e tij. Rol të dukshëm Mustafai ka luajtur dhe në Konferencën e Mukjes, ku në delegacionin e Frontit Nacionalçlirimtar bënë pjesë komunistë, zogistë, nacionalistë etj. Ndër problemet kryesore që ngrii dhe përkrahu Mustafai ishte problemi i Kosovës, i bashkimit të saj me Shqipërinë pas lufte...

Mustafa Gjinishi ra si luftëtar i palodhur

Meritë e veçantë e Mustafait në luftë ishte ngritja e aktivitetit të njësiteve guerile dhe formacioneve ushtarake, njësiteve e çetave apo dhe të krijimit të Këshillave Nacionalçlirimtare në zonat e çliruara. Në veçanti punoi për të sheshuar kontradiktat ndërmjet forcave të ndryshme politike, për t'i bashkuar ato të gjitha në luftë kundër pushtuesit. Dihet se Mustafa Gjinishi gjatë luftës vazhdimisht u mundua të sheshojë mosmarrëveshjet politike të PKSH-së, të Legalitetit, Ballit Kombëtar e nacionalistëve, për t'i mobilizuar dhe organizuar në luftë këta të fundit. Në një informacion të hollësishëm si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, në momentet më të vështira të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në operacionin gjerman, më 19 dhjetor 1943, shkruan për vështirësitë dhe humbjet e forcave partizane, shkaqet, shkaktarët dhe orienton rrugët për të dalë nga kjo situatë. Ai përshkruan me objektivitet, paanshmëri, saktësi dhe qëndrim kritik, i përshkruan momente të vështira, duke kritikuar individë komunistë, por dhe ballistë, legalistë e nacionalistë si bashkëpunëtorë me gjermanët. Në maj 1943, Mustafa Gjinishi u caktua nga Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar për të qenë shoqëruesi dhe përkthyesi i misionëve angleze, koordinator i tyre në Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Në verën e vitit 1944 Mustafai u caktua nga Shtabi i Përgjithshëm dhe u dërgua në veri, në Dibër në Divizionin I Sulmues e më pas në Korparmatën I Sulmuese. Radio "Londra" në mjaft emisione të saj, kur fliste për luftën çlirimtare në Shqipëri theksonte se "më luftëtarët Mustafa Gjinishi e Myslim Peza po korrin suksese mbi armikun". Çështja e Mukjes dhe mesazhet e radio "Londrës" për "Tafarin", bënë që Mustafa Gjinishi, më 24 gusht 1944, të bjerë në një pritë në fshatin Grevë të Peshkopisë.

Në urdhrin e ditës të Ushtrisë Nacionalçlirimtare midis të tjerash thuhej se "ra në fushën e nderit shoku ynë Mustafa Gjinishi, anëtar i Kryesisë së Këshillit Nacionalçlirimtar dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Mustafa Gjinishi luftëtar i palodhur dhe i patrembur, pa kursyer asgjë, dha jetën në vijat e para të luftës për çlirimin e atdheut dhe të popullit shqiptar". Për tri ditë rresht për të nderuar luftëtarin, repartet e ushtrisë ulën flamurin kombëtar në gjysmë shtizë. Ai u quajt dëshmor i rënë në luftë kundër gjermanëve në frontin e Maqellarës në Dibër. Pas çlirimit në Peqin, një shkollë dhe një rrugë morën emrin e dëshmorit Mustafa Gjinishi, si dhe një rrugë në Tiranë, por më vonë u cilësua si agjent i anglezëve dhe figura e tij mbeti në heshtje. Roli i tij në LANÇ është rivlerësuar në studimet e kryera pas vendosjes së pluralizmit politik. Sot Mustafa Gjinishi është dëshmor i atdheut. Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, me vendim nr. 9, datë 20 maj 2003, i jep Mustafa Adem Gjinishit certifikatën e Dëshmorit të Atdheut. Eshtrat e tij nuk janë në varrezat e dëshmorëve të Elbasanit. Në qytetin e Peqinit është ngritur një bust në qendër të qytetit. Për jetën dhe veprën e Mustafa Gjinishit, shkrimtari nga Peqini Astrit Kaziu ka shkruar monografinë "Legjenda Gjinishi përballë së vërtetës" në vitin 2005.

Pjesëmarrja e luftëtarëve nga vendi në Luftën e Vlorës 1920

PROF. ASOC. DR.
BERNARD ZOTAJ

(Në kuadrin e 104-vjetorit të fitores, më 3 shtator 1920)

Thirrje për të shkuar në Vlorë

Luftimi popullor, si një nga format e luftimit, mori zhvillim me pjesëmarrjen masive të popullit në luftën çlirimtare të Vlorës, të vitit 1920 dhe të rrethinave të saj. Efektivi i forcave vullnetare erdhi duke u rritur me shpejtësi e në kohë, me vullnetarë të ardhur nga të gjitha krahinat e vendit. Kryengritja mori zhvillim dhe pjesëmarrja e popullit, i cili u ngrit në këmbë për të fituar të drejtat e tij, për liri dhe identitet. Forcat kryengritëse në fillim ishin pak. Kjo dhe për vet karakterin e luftës, e cila nuk fillon menjëherë me pjesëmarrjen e popullit, për shkak të mundësive të kufizuara të rezervave njerëzore, por dhe të aparatit mobilizues në zonë e në vend. Zyrat e rekrutimit ushtarak mungonin në të gjithë krahinën e Vlorës dhe më gjerë. Por, me çlirimin e fshatrave një pas një, u krijua mundësia e shtimit të luftëtarëve. Kryengritjen e armatosur që nisi popullsia patriotike e krahinës së Vlorës kundër pushtesit italianë, u shndërrua shpejt në një kryengritje të të gjithë popullit shqiptar. Thirrjeve të Komitetit të “Mbrotjes Kombëtare”, për të shkuar në Vlorë iu përgjigjën shumë vullnetarë nga anë të ndryshme të vendit e sidomos nga krahinat e afërta. Kryengritësit u organizuan në çeta mbi bazë fshati, krahine e prefekturë, duke vënë në komandë njerëzit me përvojë luftarake të provuar më parë. Nën drejtimin e Komitetit të “Mbrotjes Kombëtare” u ngrit kështu një ushtri vullnetare kryengritëse, që arriti në 4.000 luftëtarë e përbërë kryesisht nga fshatarë. Por gjatë zhvillimit të kryengritjes kjo forcë arriti deri në 6.000 luftëtarë.

Ngritja dhe organizimi i komiteve

Një ndër masat përgatitore për daljen e vullnetarëve për luftë, ishte ngritja dhe organizimi i komiteve të fshehta të “Mbrotjes Kombëtare”. Të tilla me shpejtësi u krijuan në Shqipërinë e Jugut e të Mesme, më konkretisht në Vlorë, Tepelenë, Gjirokastrë, Përmet, Mallakastër, Fier, Berat, Skrapar, Pogradec, Korçë, Kolonjë, Tiranë, Elbasan, Shkodër etj. Të gjitha këto përgatitje u pasqyruan në shtypin përparimtar të kohës, si në organizimin e mitingjeve e të ndihmave të vijueshme, gjatë gjithë periudhës së

luftës. Lëvizja në përkrahje të masave për luftë u zgjerua shumë gjatë muajve prill dhe maj të vitit 1920. Mitingje solidariteti dhe kërkesa e ultimatumë u bënë nga shumë qytete të vendit, ku pjesëmarrësit shprehnin gatishmërinë për ta ndihmuar nga ana materiale, por dhe për të shkuar vullnetarë në Vlorë. Në mbështetje të luftës në mjaft krahina e zona të vendit u organizuan mitingje. Në Gjirokastrë, pjesëmarrësit u shprehën se “shqiptarët dje derdhën gjakun për të huaj, dinë të derdhin gjakun edhe për veten e tyre”. Ndërsa në mitingun e organizuar nga populli i Kolonjës, u theksua se “... të gjithë jemi gati të bëhemi theror për atdheun”. Në kujtimet e mësuesit elbasanas Ahmet Gashi, drejtues i bandës “Afërdita”, theksohet se “...për 10 ditë rresht shkua lagje më lagje e shtëpi më shtëpi të qytetit me bandën muzikore e me flamurin kombëtar për të mbledhur ndihma. Nuk mbeti shtëpi e dyqan pa na dhënë. Gjithsej u mbledhën 3000 napolona ar, të cilat ia dorëzuan Komisionit Qendror të Luftës së Vlorës. Përfaqësuesit e Komitetit të ‘Mbrotjes Kombëtare’ vunë në dijeni qeverinë e Tiranës për gatishmërinë e tyre dhe për fillimin kryengritjes. Kryeministri Sulejman Delvina dhe shumica e anëtarëve të qeverisë e pranuan gatishmërinë e tyre dhe i premtuan këtij Komiteti, kryesisht ndihma me materiale, por këto jo në rrugë zyrtare”.

Konflikti i armatosur shtrihej në Labëri

Konflikti i armatosur që po përgatitej në Vlorë shtrihej në tri zona të Labërisë si: në Vlorë, në Tepelenë dhe në Himarë. Kështu, konflikti mernte karakterin e një lufte lokale të banorëve të zonës së pushtuar nga imperialistët italianë. Hapjen e një konflikti më të madh shtetëror midis Italisë dhe Shqipërisë, qeveria e Tiranës nuk e dëshironte. Ajo nuk e përballonte jo vetëm për mungesë forcash, por dhe për pozitën e vështirë në të cilin ndodhej vendi. Qeveria e Tiranës në vijimësi njoftonte në Vlorë se, nga Tirana, Elbasani, Peqini, Kavaja e të tjera, po regjistroheshin e stërviteshin kryesisht luftëtarë, ndërsa në disa rrethe kishte filluar grumbullimi i ndihmave materiale si në Korçë, Berat, Tiranë, Shkodër e Gjirokastrë. Natyrisht, peshën më të madhe të luftës në njerëz dhe në materiale e mbajti populli patriot i krahinës së Vlorës, në të cilën përfshihej atëherë dhe Tepelena, Kurveleshi e Himara. Kjo është e dukshme veçanërisht në fazën e parë të veprimeve luftarake. Me kohë në Kurvelesh ishte bërë një mbledhje, ku kishin marrë pjesë të gjithë fshatrat e Labërisë, për një lëvizje kundër forcave italiane që mbanin të pushtuar Vlorën. Kështu që “ditët e fundit mësuam sigurisht që lëvizja nisi”. Për sigurimin me ushqim të



çetave të Kurveleshit dhe të Tepelenës, u vendos që çdo familje të jepte 3% të sasisë së kokëve të bagëtive të tyre. Sipas vendimit të Komisionit Ushtarak të Luftës së Vlorës, fshatrat që kishin më pak se 20 luftëtarë do bashkonin me çetën e fshatit më të afërt. Në përfundim të mbledhjes u ngrit flamuri kombëtar dhe u deklarua se nuk njihet asnjë qeveri dhe se nuk pranohej të paguheshin taksat e detyrimit e vendosura nga qeveri në shërbim të pushtetit. Çdo fshat ngriti një komision me 5-7 veta për sigurimin dhe administrimin e furnizimeve për çetat.

Gazetari italian për luftën

Luftimet për marrjen e garnizonit të Tepelenës vazhduan për dy javë, sepse trupat italiane deri dy batalioneve të këmbësorisë dhe një bateri artilerie, në pamundësi t'u qëndronin forcave kryengritëse në terren të hapur, u futën në Kalanë e qytetit. Forca kryengritëse bllokuan furnizimet përfshi furnizimin me ujë. Çetat e Kurveleshit (Golemit, Picarit, Lekdushit, Progonatit dhe Kolonjës) ishin përhapur nga ana e rrëzës së kodrave dhe sulmonin në drejtim të kalasë nga perëndimi e jugu. Më 21 qershor 1920 garnizoni u dorëzua. Gazetari italian Gustavo Tralio do të shkruante "... Tepelena, qytezë e vogël, e struktur në një kodër dhe e rrethuar nga mbeturinat e kështjellës së Ali Pashës, u pushtua nga kryengritësit, të cilët përparuan gjatë kodrave. Këtë natë kemi dëgjuar topat që gumëzhijnë. Qyteti rronte prej disa netësh në ethe të vazhdueshme, sot në mëngjes u zgjua me zhurmën e zakonshme, duke pllakosur zija nëpër rrugë". Ndërsa një gazetë tjetër italiane do të shkruante: "Po jetojmë orë të tmerrshme. Të ngjethet mishi nga pamja e tmerruar e qytetit (Tepelenës). Disa thonë se kryengritësit janë 5.000, të tjerë thonë 10.000, po asgjë s'dihet e saktë. Është e pamundur të vërtetosh shumën e saktë të humbjeve tona".

Vullnetarë nga të gjitha krahinat e vendit

Vullnetarë nga krahina të tjera të vendit dhe ndihma materiale arritën në fazën e dytë të luftimeve, në kohën e rrethimit të ushtrisë

italiane në qytetin e Vlorës. "... Rreth 5-6.000 shqiptarë rrethuan qytetin, por reagimi i trupave ishte i fortë dhe efikas. Situata nga dita në ditë po mernte përmasat e një lufte kombëtare për çlirimin e Shqipërisë...". Vullnetarë dhe ndihma të tjera erdhën jo vetëm nga krahinat e afërta si: Berati e Gjirokastra, por edhe nga Korça, Elbasani, Durrësi e Tirana etj. Kontribut të shquar dhanë në Luftën e Vlorës në vitin 1920 dhe Mallakastër, Gjirokastra, Përmeti, Skrapari, Devolli, si dhe çetat e Çamërisë me Muharrem Rushitin dhe Alush Takën, çeta e Tiranës me Said Toptanin, si dhe çeta e Himarës me Nase Labin e Naqe Konomin, etj. Midis fazës së parë dhe të dytë erdhën ndihma vullnetare nga krahina Mallakastrës etj. Vullnetarë nga Tirana erdhën 200 luftëtarë, të cilët megjithëse nuk morën pjesë aktive në luftë, por për moralin ishin shumë të vlefshëm. Në luftë erdhën edhe luftëtarë nga fshatrat e Bregdetit, si nga Vunoi e Himara, si edhe nga Borshi. Fitoret e para qenë inkurajuese për forcat kryengritëse dhe shërbyen si nxitje për veprimtari më të vrullshme të komiteteve të ngritura në krahinat e tjera të vendit. Më tepër se 1000 vullnetarë u nisën për në front nga rrethet e Tiranës, Elbasanit, Beratit, Durrësit, Fierit, Korçës, Përmetit e Gjirokastrës. U mbledhën ndihma të shumta në të holla, veshje, sende ushqimore e armatime. Në front shkuan qindra vullnetarë të rinj nga të gjitha krahinat e vendit. Kështu, nga Gjirokastra, Korça e Çamëria mbërritën 700 vullnetarë. Çetat e Skraparit me 300 luftëtarë, të udhëhequr nga Riza Cerova e Muço Kapinova, mbërritën në Vlorë e në Tepelenë.

Pjesëmarrës në Luftën e Vlorës ishin dhe mjaft ushtarakë. Këta ndikuan në mobilizimin e njerëzve, me gjithë vështirësitë e shumta si mungesa e theksuar e rrugëve dhe mjeteve të transportit, vështirësi në furnizimin me armë dhe municione. Më tej u ndje mungesa në fuqinë dhe në dobinë e zjarrit, pra të pajisjes me armatim, përballë një kundërshtari të armatosur me mjete më të mira të kohës. Të gjitha këto u kompensuan nga epërsia e pjesëmarrjes së masave popullore në këtë luftë kryengritëse, por dhe nga udhëheqja e ushtarakëve shqiptarë, si dhe nga njohja e mirë e terrenit.

Masakra përbindëshe fashiste e 9 shtatorit të 1943, në qytetin e Korçës

Kapitullimi i Italisë fashiste, më 8 shtator 1943, do të shkaktonte, fillimisht në datën 9, brenda qytetit të Korçës dhe në datën 14 në Gërhot, bazë ushtarake vetëm pesëqind metra larg Gjirokastrës, dy masakra të mëdha të ushtrisë së saj ndaj shqiptarëve. Kapitullimi pa kushte i Italisë për qarkun Korçë-Kolonjë do të ishte ditë e mbushur me ngazëllim edhe shpresë, me besim për ndonjë kthesë fatmirë në qëndrimin e partive shqiptare, veçanërisht Partisë Komuniste dhe Ballit Kombëtar, po ashtu edhe të krahëve të tyre të armatosur, sikur të mos ndodhte një kob. Madje qe mynxyrë.

Në zonën e Korçës komanda italiane e Armatës së Nëntë, që drejtonte të gjithë trupën e pushtimit në Shqipëri, pati vendosur divizionin “Areco” (“Arezzo”). Ky mbulonte edhe një pjesë të kufirit lindor të shtetit të perandorisë, ku bashkë me Romën dhe Adis Abebën, qe bashkuar me përdhunë edhe Tirana. Brenda hapësirës shqiptare vija e veprimit të “Arezzo” në veri takohet me territorin e veprimit të divizionit Firenze (“Firenze”) dhe në jug, me qendër Gjirokastrën, atë të divizionit “Peruxha” (“Perugia”). “Arezzo” ishte krijuar për nevojat e përforcimit të okupimit të Shqipërisë, në mars 1939, në qytetin jugor italian Maçerata (Macerata). Në portin e Vlorës trupat e tij patën zbarkuar, më 25 qershor dhe prej vendndodhjes bazë në qytetin dhe krahinën e Korçës, morën pjesë në luftimet, për zaptimin e Jugosllavisë dhe të Greqisë.

Divizioni kishte tremijë vetë dhe përbëhej nga bashkimi i dy regjimenteve këmbësore: ai me numër 225 dhe tjetri 226. Po ashtu prej një regjimenti të tretë të artilerisë malore si edhe i tre grupeve të repartit të xhenios dhe të shërbimeve. Në Luftën e Parë Botërore dy regjimentet këmbësore, atëherë njësi të pavarura, me kurajën e tyre patën bërë famë në përleshjen me austriakët, aq sa këta të fundit ua thërritnin ushtarët, për shkak të ngjyrës së spaletave, me emrin “djajtë e verdhë”.

Fillimisht komandant i divizionit “Arezzo” qe gjenerali Mikele Molinari (Michele Molinari). Më pas u bë Arturo Torriano. Lajmi i armëpushimit, i cili quhet ndryshe edhe ai i kapitullimit të Italisë fashiste para aleatëve anglo-amerikanë, mbërriti nëpërmjet radios, në orën 20.30. Oficerët ishin në mensë, duke ngrënë qetësisht darkën. Njoftimi nga Roma krijoi menjëherë hutim, ankth dhe pasiguri. Kishte rënë si bombë dhe i pati gjetur të gjithë njerëzit e “Arezzo” larg atdheut, në një territor të turbullt dhe kundërshtar.



Ca më tepër shumë të rrezikshëm, tani që shteti i tyre kishte falimentuar. Rugët shqiptare të komunikacionit drejt detit, për ta kapërcyer atë dhe për të shkuar në Itali, qenë fare të pakta e të vështira, të ngushta dhe me terrene të përshtatshme për të rënë nën pritë e vendasve. “Arezzo” po ashtu kishte rezerva të pakta ushqimi dhe municioni. Në rast të ndonjë sulmi ai nuk mund të rezistonte gjatë. Dokumentet e ushtrisë italiane të kësaj periudhe dëshmojnë se regjimenti i artilerisë i kësaj njësie, për shembull, kishte për të ngrënë vetëm për njëzetë e katër orë.

Ndërsa oficerët ndodheshin në këtë gjendje të rëndë shpirtërore dhe e dinin fare mirë se trupa e tyre divizionale ishte tepër e shpërndarë në territor dhe për pasojë me fuqi zjarri të shpërqendruar, u mor vesh se gjysmë ore para dhënies në lajmit nga radioja italiane, në 20.30, pati ardhur një urdhër nga korparmata, me qendër Elbasanin, e cila porosiste që ai të mos merrej parasysh, sepse çfarë Radio-Roma kishte thënë, pati qenë



thjesht propagandë.

Në orën 22.30 prej po kësaj komande mbërriti urdhri tjetër: të bashkëpunohej me gjermanët kundër rebelëve.

Me këtë fjalë të fundit nënkuptoheshin të gjitha grupet shqiptare të rezistencës, të çdo ideje të ishin. Në fonogramin e saj me numër 01/3532 këmbëngulej po ashtu: “Vigjilencë maksimale! Kundërshtoni çfarëdolloj sulmi rebel!” Ndërkohë nga komanda qendrore e Tiranës, Armata e 9-të, një fonogram tjetër komunikonte po të njëjtin qëndrim të prerë: “Paralizoni me çdo mjet sulmet e rebelëve kundër forcave tona! Në pritje të urdhrave asnjë lloj iniciative apo veprimi të pa kondicionuar”. Në Pogradec situata që zhvilluar pothuaj njëlloj si në Korçë.

Oficerët e garnizonit po darkonin në mensë, kur në të hyri oficeri i shërbimit, duke thirrur: “Zoti Kapiten, ushtarët në vendqëndrimet e tyre janë duke bërë zhurmë, pasi kanë dëgjuar nëpërmjet radios se Italia ka kërkuar armëpushim”. Atëherë komandanti i regjimentit, major Vistarini, hyri në lidhje me radio me gjeneralin Torriano në Korçë. Ky fillimisht iu përgjigj se lajmi nuk qe i vërtetë, por më pas shqiptoi diçka konfuze, një lloj shprehjeje pa kokë e pa këmbë si afërsisht “ende nuk kemi lajme të sakta”. Kur mesnata që ndante 8 shtatorin prej ditës së nëntë të atij muaji kishte kaluar një gjysmë ore, regjimenti-garnizon i Pogradecit lajmëroi divizionin në Korçë se kishte vënë re lëvizje automjetesh matanë kufirit.

Ato po ndodhnin në drejtim të lartësisë 721. Kjo kuotë topografike gjendej në rrugën gjatë bregut të liqenit të Ohrit, saktësisht atje ku përfundonte territori jugosllav dhe niste ai shqiptar. Në orën 01.25 të 9 shtatorit për këtë zhvillim komanda e divizionit “Arezzo” vuri në dijeni eprrorët e vet të drejtpërdrejtë të korparmatës në Elbasan. Prej saj mori urdhrin që gjermanët të kundërshtoheshin me armë në rast se përpqeshin të hynin në territorin shqiptar.

Shumë shpejt, rreth orës 02.30, nga kjo komandë u saktësua: para se të merrej vendimi për t'i ndaluar, duhej fillimisht të hetonin qëllimin e kolonës gjermane. Gjenerali Arturo Torriano këtë urdhër ia përcolli garnizonit të Pogradecit, i vetmi që në këtë situatë

ishte afër lëvizjes së autokolonës dhe mund të vepronte. Ky rreth orës 03.00 u nis nga kazemat dhe në 05.30 zuri pozicione afër Shën Naumit. Ndërkohë në Korçë Torriano rizhvendosi trupat e tij, duke mbajtur një pjesë në gatishmëri për të ndihmuar garnizonin e Pogradecit, siç qe ai i Bilishtit. Garnizonin e Dardhës e vendosi në Zemlak, kurse ato me vendqëndrim në Ersekë i urdhëroi të vinin në Korçë. Nëpërmjet këtij riorganizimi, gjenerali mernte masa që në rast se gjermanët do të vazhdonin lëvizjen e tyre drejt qafës që të çonte në Korçë, pengesa duhej të bëhej në frontin Zemlak-Maliq, duke e lënë regjimentin e Pogradecit aktiv për të siguruar e mbajtur të hapura rrugët e komunikimit me Elbasanin. Ky ishte drejtimi më i mundshëm për në bregdet, portin e Durrësit, dhe prej andej në Itali. Në orën 04 të 9 shtatorit komanda e korparmatës

me fonogramin 01/3534 urdhëroi: “Ndaloni kolonën gjermane në vijën e kufirit dhe sqaroni qëllimin e tyre, duke dërguar një oficer! Lajmëroni Komandën Gjermane! Jemi në pritje të urdhrave nga lart”.

Një oficer i dërguar nga Pogradeci për në Ohër, në komandën e divizionit gjerman të vendosur këtu, mori përgjigjen se këta të fundit nuk do të lëviznin nga programi i tyre i veprimit. Në relacionin e tij për komandën e korparmatës gjenerali Arturo Torriano do të shpjegonte se: “Në këtë moment duhet të kujtojmë se pothuajse vazhdimisht e përditë autokolonat gjermane të furnizimeve të reparteve me të gjitha llojet e armëve, sidomos ato të blinduarat dhe të korracuarat, po kalonin tranzit drejt Korçës dhe të gjitha pozicionet përgjatë rrugës Follorinë-Korçë-Ura e Peratit qenë pothuajse të rrethuara nga repartet e Wermahitit. Me pak fjalë në këtë mënyrë hyrja e tyre në Shqipëri tashmë ishte një fakt i kryer”. Më pas Torriano shtonte: “Gjithsesi, qoftë për sa ishte bërë deri tani, por edhe për të qenë në linjë me urdhrat e komandës eprorë urdhërova që herët në mëngjes të kapeshin pozicionet dhe të pengohej rruga e hyrjes për në Korçë në Qafën e Pllaçës, duke minuar edhe fushën e Pojanit”. Më 9 shtator, kur tashmë që mëngjes, gjermanët kapën në befasi dhe çarmatosën përgjatë vijës kufitare të Pogradecit me territorin jugosllav postat e Policisë Financiare. Komandanti i garnizonit të qytetit, majori Vistarini, pasi për çfarë ndodhi e informoi eprorin e vet në Korçë, mori prej këtij të fundit urdhrin e anasjelltë të tetë orëve më parë: trupat të largoheshin nga pozicionet e përparuara të zëna gjatë natës dhe të riktheheshin në kazermë.

Ndërkohë nga komanda qendrore e Armatës së Nëntë të divizionit “Arezzo” me fonogramin e orës 15.30 i erdhën direktivat e para të veprimit. Ato theksonin se pritej nga Roma të vinin udhëzime për një hyrje paqësore të gjermanëve në territorin e shtetit shqiptar dhe se kjo do ta lehtësonte mos përplasjen e dhunshme mes dy ish-aleatëve.

Mesazhi i ardhur vinte në dukje po ashtu se: “Ne jemi ushtarakë dhe duhet të kemi parasysh ruajtjen e armëve tona dhe se do të mbrohemi vetëm në rast se do të sulmohemi. Ndaj gjermanëve nuk do të kryejmë asnjë veprim armiqësor. Megjithatë nga ana jonë do të ketë veprim reagues me vendosmëri në rast se ata na kërkojnë armët apo na detyrojnë të vendosemi me trupa në shërbim të tyre...”.

Kur atë ditë të 9 shtatorit sapo pati kaluar mesdita, në komandën e divizionit “Arezzo” mbërriti urdhri që ai së bashku me repartet e Rojës së Kufirit dhe të Policisë Financiare, të cilët qenë shtrirë që nga skaji më verilindor i rrethinave të Pogradecit deri në atë jugperëndimor të Kolonjës, të grumbulloheshin pa u vonuar në qytetin e Korçës. Në orën 13.00 ndërhyri shtabi i Korparmatës në Elbasan. Ai transmetoi të shkruar marrëveshjen e përfunduar mes asaj komande dhe autoritetit epror të divizionit 100 gjerman, i cili përfaqësohej nga majorët Lebner dhe Kress.

Në bazë të saj njësitë italiane do të lëviznin lirisht në rrugët e Shqipërisë për të shkuar në drejtimet e para-saktësuar dhe si kompensim duhej t’u dorëzonin gjermanëve armët e artilerisë dhe po ashtu edhe armët e reparteve. Trupat duhej të mbanin pistoletat, armët personale automatike, mitralozat si edhe municionet e tyre. Pasditen e 9 shtatorit 1943, komanda e divizionit “Arezzo” në qytetin e Korçës urdhëroi të gjitha repartet vartëse të bëheshin gati, sipas një rregulli të caktuar, për të lëvizur në drejtim të Elbasanit.

Me vete të merrnin maksimumin e furnizimit me ushqime dhe municione. Patjetër edhe tërë armët në dispozicion. Po atë pasdite komandës së garnizonit të Pogradecit i erdhi urdhri që kundër gjermanëve të ziheshin me shpejtësi një pritë në fshatin Lin dhe një tjetër në rrugën automobilistike, e cila të çonte në Ohër. Pas dy orësh të dy këta urdhra u anuluan.

(E vëmë në dijeni lexuesin se të gjitha këto të dhëna dhe veçanërisht ato të paraqitura këtu, i kemi marrë prej librit me 1144 faqe të gjeneralit italian Masimo Koltrinari (Massimo Coltrinari) “Qëndresa e ushtarakëve italianë jashtë vendit - Shqipëria 1943-1945” - “La resistenza degli militari italiani all'estero - Albania 1943-1945”, botuar në “Rivista Militare” 1999).

Pikërisht prej këtij burimi do të veçojmë edhe këto radhë të mëposhtme, të cilat janë të një rëndësie historike jo të vogël: “Marrëdhëniet me popullsinë lokale dhe me forcat e rendit publik atë pasdite do të merrnin një rrjedhë të padëshiruar. Në orën 16.00 të datës 9 shtator popullsia e Korçës së bashku me oficerët, trupën dhe civilët italianë, inskenuan një lloj demonstrimi duke thirrur “Vdekje gjermanëve!”, “Rroftë Italia!”, “Rroftë Shqipëria e Lirë!”, por një autobлиндë e ardhur prej komandës së divizionit hapi zjarr mbi këta demonstrues, duke vrarë 20 vetë dhe plagosur 150 të tjerë”.

Gjenerali Koltrinari këtë fragment e ka shkëputur prej një raporti të togerit Barbieri, i cili më 15 nëntor 1943, bashkë me shumë të dhëna të tjera, do t’i fuste në një raport informues (çfarë deri atëherë kishte parë në divizionin “Arezzo”), gjeneralin Arnaldo Azzi. Ky konsiderohej epror i trupave italiane të bashkuara me forcat partizane shqiptare. Edhe pse zyrtarisht shpallja e

kapitullimit pa kushte të Italisë fashiste para aleatëve anglo-amerikanë njihet si veprim i bërë publik nëpërmjet radios në orën 19.00 dhe më pas në të gjitha edicionet e saj të përsëritura, në strukturat e divizionit “Arezzo”, përfshirë edhe garnizonin e Pogradecit, ai u bë i njohur nëntëdhjetë minuta më pas.

Madje deri në 22.30 ai ende qe i pakonfirmuar nëpërmjet linjës së hierarkisë ushtarake dhe u trajtua me statusin e përafërt të një fjalënaje. Në rrethana të tilla paqartësie mes ushtarakëve italianë dhe po aq edhe hutimi të dukshëm të tyre, për pasojë edhe një pasigurie të përgjithshme, çfarë duhej përlogaritur me shumë kujdes për pasojat që mund të jepte në rast ndonjë veprimi të ngutur, ndryshe nga çdo qytet tjetër në Shqipëri, në Korçë qarkori i PKSH-së si edhe këshilli nacionalçlirimtar i saj, bënë thirrje për një manifestim të madh popullor. Ky duhej të mbahej të nesërmen që në orët e para të mëngjesit.

Ndërkohë nën bindjen se duhej sa më shpejt të zbatonin një urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, i cili porosiste që t’u bëhej thirrje trupave italiane të bashkoheshin me formacionet partizane dhe në pamundësi të kësaj, t’u dorëzonin të gjitha armët, gjatë mbrëmjes së vonë dhe orëve të para të natës së 8 shtatorit, nëpërmjet dërgatave, nisën bisedimet me komandën e divizionit në Korçë dhe atë të regjimentit të zgjeruar të vendosur në Drenovë. Këto qenë edhe dy grumbullimet më të mëdha ushtarake italiane në këtë qytet.

Prani të njerëzve të Lëvizjes NÇ tek gjenerali Arturo Torriano deri në mesnatë të 8 shtatorit, sipas librit të Masimo Koltrinarit, nuk ka, çfarë nuk do të thotë megjithatë se ndonjë komunikim i ndërsjellë nuk ka ndodhur. E nesërmja në qytetin e Korçës solli manifestimin më të përgjakshëm të luftës së Dytë Botërore, Brenda disa minutave u vranë 59 fëmijë, të rinj e të reja, burra e gra u plagosën 120 të tjerë. Në nderim të tyre në qytetin e Korçës është ngritur një memorial modest, ku në çdo 9 shtator vihen buqeta me lule e kurora. Kjo është edhe një datë e rëndësishme, jo vetëm e historisë së Korçës që pasuronte traditën atdhetare të këtij qyteti me shumë vlera, por edhe një eveniment patriotik i dhimbshëm i kontributit të Korçës, në LANÇ. Në Korçë u formuan e zhvilluan luftimet kundër pushtuesve nazifashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre: 22 çeta, 4 batalione e 5 brigada partizane. Korça ka 960 dëshmorë, përveç qindra të vrarëve që janë quajtur viktime.

LANÇ me vlerat e saj rrezaton e ndriçon rrugën e brezit të ri e të qytetarëve të ditur e të ndershëm që duan të punojnë për zhvillimin e përparimin e vendit, ku kanë lindur e janë rritur, që fshati e qyteti, Atdheu ynë të ecë për së mbari të bëhet më i mirë e më i bukur, me punë e mirëqenie për të gjithë. T’i themi jo përçarjes e hakmarrjes. Të mos zgjohemi në mëngjes e të lemerisemi nga kronikat e zeza të shtypit e televizionit. Të mos kemi më 97-98, “Gërdece” apo të vrarë në bulevardin Dëshmorët e Kombit. Brezit tonë të veteranëve të LANÇ-it iu dhimbset çdo gjë që është fituar me gjak e sakrifica të panumërta, me djersë e me punë të ndershme. Le të ecim me dinjitet e me kokën lart, siç dhe e meritojmë në gjirin e familjes së shteteve demokratike europiane.

Skënderbegasi i “Medaljes së Artë” Mihallaq Prifti, mjeku i njohur ushtarak

Dr. Mihallaq Prifti ka lindur më 9 nëntor të vitit 1933, në Vlorë dhe banon në Tiranë. Shkollën fillore dhe atë unike i ka kryer në vendlindjen e tij, në Vlorë. Dy vitet e para të gjimnazit i ka kryer në Tiranë në vitet 1950-1952. Dy vitet e tjera, në periudhën 1952-1954 i ka kryer në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Gjatë kësaj periudhe, ai është ndër nxënësit më të mirë të shkollës, si në përgatitjen teorike, ashtu dhe në atë ushtarake. Skënderbegasi nga Vlora, ishte ndër nxënësit që mbaroi shkollën “Skënderbej” me ‘Medalje Ari’.


Në këtë mënyrë, si kontingjent i Forcave të Armatosura, ai ishte ndër maturantët e këtij viti që dërgohet për të ndjekur studimet e larta në Universitetin Shtetëror të Tiranës, për interes të Ministrisë së Mbrojtjes. Në shtator të vitit 1952

ai nis studimet në Fakultetin e Mjekësisë, duke i përfunduar studimet në vitin 1954 me rezultate shumë të mira. Pas diplomimit si mjek i përgjithshëm, ushtarak, me gradën kapiten i dytë, nis punë në profesionin e tij të mjekut në ushtri. E emërojnë mjek në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak. Në këtë institucion shëndetësor punon në vitet 1959-1961.

Në vitin 1961 ai dërgohet për studime pasuniversitare në Moskë të ish-Bashkimit Sovjetik. Atje specializohet në degën anestezi-reanimacion dhe kthehet përsëri aty ku kishte qenë, në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak, duke ushtruar profesionin e fituar në Moskë. Del në pension në vitin 1990. Megjithëse në pension, ai nuk heq dorë nga profesioni që ka ushtruar një jetë të tërë, duke asistuar me orar të reduktuar në klinika private të njohura në kryeqytet. Dr. Mihallaq Prifti, është baba i tre fëmijëve.



Partizani, skënderbegasi dhe kirurgu me emër, Prof. Dr. Ismail Feta



Ismail Feta lindi më 20 tetor 1927, në një familje me shumë fëmijë (ndërroi jetë më 15 korrik të vitit 2002), me të ardhura të pakta, në fshatin Zagrad, Komuna Bellovë e Dibrës, ku dhe mbaroi shkollën 7-vjeçare. Hallet e familjes e detyruan që në moshën 13-vjeçare të largohej nga vendlindja dhe të shkonte në Tiranë për të punuar në punë të ndryshme, herë si shërbëtor tek disa tregtarë dibranë dhe herë-herë shiste gështenja nëpër rrugët e kryeqytetit. Ishin fillimet e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, ku djaloshi dibran lidhet me lëvizjen Antifashiste, duke ndihmuar njësitet guerile në aksionet e tyre luftarake në qytetin e Tiranës. Kur brigadat partizane me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare kaluan në Veri, në ndjekje të pushtuesve nazistë, ai u rreshtua në përbërje të Brigadës së 18 S si partizan i thjeshtë. Më pas si bëri një kurs të shkurtër organizuar nga mjeku i brigadës për infermier, shërbeu si i tillë në kompani, batalion dhe në brigadë deri në çlirimin e plotë të vendit.

Pas çlirimit të vendit, ai është ndër partizanët e luftës që u ul, më 28 mars 1945, në shkollën e kadetëve në Tiranë, që më vonë mori emrin shkolla "Skënderbej". Në vitet 1947-1951, Ismaili u dërgua në shkollën e mesme mjekësore në Lubjanë të Sllovenisë. Pas

prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, dërgohet në Akademinë Ushtarake në Kiev të Ukrainës dhe përfundoi studimet e mesme për ndihmësmjek. Pasi punoi gati një vit mjek në Shqipëri, në vitin 1952-1959, kreu studimet për mjekësi në Akademinë Ushtarake Mjekësore "Kirov" të Shën Petërburgut me rezultate të shkëlqyera. Në periudhën 1952-1958, Ismaili kreu detyrën e Shefit të Degës së Shëndetësisë në Ministrinë e Mbrojtjes. Ai ka meritën që falë aftësive profesionale, përkushtimit në punë dhe eksperiencës së fituar, ai bashkë me disa kolegë të tjerë, të konsolidojë shërbimin shëndetësor të ushtrisë në të gjitha hallkat batalion-grup, regjiment-brigadë, korpus-divizion dhe në bazat e furnizimit të ushtrisë. Për aftësinë organizative dhe drejtuese të Doktor Ismail Fetës, flet edhe kujtesa e gjithkujt që është shtruar apo dikë ka vizituar në pavijonet e shërbimit kirurgjik në ish-spitalin ushtarak që drejtonte Ismaili Feta e Spiro Dedja. Ismail Feta, pasi përfundoi me rezultate të shkëlqyera studimet e larta në Akademinë Ushtarake të Mjekësisë në Shën Petërburg, qëndroi edhe një vit mësimor 1958-1959 për t'u specializuar në fushën e kirurgjisë, sidomos për operacionet e stomakut, patologjitë e zorrëve dhe të mëlçisë, në vitin 1971-1972

është specializuar edhe në Kinë. Pra, pasi mori njohuritë e nevojshme profesionale si mjek i përgjithshëm dhe i specializuar për kirurgji, kryesisht në rrugët abdominale, doktor Ismaili i ishte fiksuar mirë në mendje e në zemër "Betimi i Hipokratit", që ndër të tjera do të thoshte se: "Betohem, zotit të mjekësisë, se do t'ia mbaj besën me të gjitha forcat e mia e me të gjithë dijeninë time. Do të përpiqem sa të mundem të ndihmoj të sëmurët dhe kurrë nuk do të bëj ndonjë dëm ose padrejtësi. Në rast se e shkel këtë betim, turpi të më mbulojë!".

Duke parë në kompleks dhe në vazhdimësi veprimtarinë e doktor Ismailit nga fillimi i punës si infermier në repartet partizane e deri sa mbylli sytë, më 15 korrik 2002, iu përmbajt me rigorozitet dhe besnikëri Betimit të Hipokratit qoftë si mjek, qoftë si njeri. E them këtë se ai la mangët kohën e gjumit, të pushimit dhe të çlodhjes, e privoi veten nga shumë gjëra, duke venë çdo gjë në shërbim të punës mjekësore dhe në shërbim të jetës së njerëzve, duke u bërë shembull i njeriut ideal dhe i mjekut me shpirt të madh njerëzor. Puna e pa matur dhe pasioni i rrallë për profesionin si dhe dashuria e madhe për njerëzit e bënë atë kirurg të shquar dhe njeri që nga shumë kush nuk do të harrohet, sepse nga duart e tij gjatë 40 vjetëve punë

u vizituan dhe u operuan me mijëra e mijëra pacientë, ushtarë dhe oficerë, punëtorë dhe fshatarë, fëmijë dhe të moshuar nga mbarë vendi.

Kolegët e kanë vlerësuar Prof. Ismailin si mjek dhe si njeri. Doktor Jordan Haxhinikolla, në kujtimet e tij të shumta, thotë: “Një ditë ndodhesha para hyrjes së Korpusit të Spitalit, kur vjen një ambulancë dhe qëndron përpara shkallëve. Hapet dera e pasme dhe që andej zbrit doktor Ismaili. Ai mbante në duar një vajzë të vogël 9-10 vjeçare dhe u drejtua me nxitim për në pavijonin e kirurgjisë, i ndjekur nga i ati i vogëlushes. Ajo kishte hipur në një man dhe ishte rrëzuar, duke dëmtuar mëlçinë e zezë. Ismaili u mor vetë me atë paciente, që ndonëse e dëmtuar rëndë, na thoshte: ‘Mezi pres të bëhem mirë dhe të vete në shkollë, kur Ismailit i duhej të operonte ¼ e lobit të djathtë të mëlçisë, por dilema ishte e madhe pasi nuk dihej nëse do ta suportonte vajza e vogël këtë ndërhyrje? Në saje të kujdesit dhe mjeshtërisë së Ismailit, operacioni doli me sukses. Vajza shpëtoi dhe ajo aktualisht është mjekë dhe quhet Sanije Lleshi”.

Dr. Arqile Veshi, ndër të tjera shkruan për Dr. Fetën: “...Gjatë karrierës time si kuadro i lartë në Ushtrinë Shqiptare, pata nderin që të bashkëpunoja edhe me të nderuarin Ismail Feta. Në shenjë nderimi për shokun dhe bashkëpunëtorin e talentuar në të gjitha fushat si ato profesionale dhe shoqërore, dëshiroj të le të shkruara vlerësimet dhe konsideratat e mia personale, por mendoj edhe të opinionit të gjerë për kirurgun dhe njeriun që të shëronte sa me mjekim edhe me fjalën e ëmbël e dashamirëse...”.

Ky kuadër e mjek model, me kontribut të madh shoqëror, humanitar e njerëzor, gjatë punës më se 40-vjeçare, jo vetëm mjekoi e shëroi me mijëra njerëz, por edhe shpëtoi nga vdekja mijëra të tjerë nëpërmjet operacioneve të shumëllojshme e shpesh shumë të vështira. Por nuk u vlerësua dhe nuk u shpërblye aq sa i takonte për kontributin shoqëror e profesional si nga sistemi ekonomiko-shoqëror i para viteve 1990, ashtu edhe nga sistemi demokratik i pas viteve 1990. Këshilli i Qarkut Dibër, me vendim Nr. 26, datë 03.09.2003 i dha Ismail Fetës titullin: “Qytetar Nderi i Qarkut Dibër”.

Gjergji Aleksi, shkrimtari dhe mjeku i njohur ushtarak

Gjergji Misto Aleksi është një nga skënderbegasit e periudhës 1947-1954 që arriti të bëhet një nga mjekët e njohur të vendit dhe autor i disa romaneve. Gjergji Aleksi është një nga kadetët që u ulën në bankat e shkollës “Skënderbej” në vitin e tretë të hapjes së këtij institucioni që studioi më pas për mjekësi dhe u bë një nga mjekët e njohur të vendit. Gjergji u lind në Korçë më 15.11.1935, por për shkak të transferimit të shpejtë të familjes në Tiranë, shkollën fillore ai e përfundoi në vitin 1947, në Laprakë të Kryeqytetit. Në këtë vit ai nis studimet në shkollën “Skënderbej”, ku në periudhën 1947-1950 përfundon shkollën unike, ndërsa në periudhën 1950-1954 dhe maturën e kësaj shkolle. Ai është ndër pak skënderbegas, që atë vit, që në përfundim të studimeve, për rezultatet e larta që arriti, u vlerësua me “Medalje Ari”. Studimet e larta për mjekësi, Gjergji i kreu në periudhën 1954-1959 në Institutin e Mjekësisë në Tiranë, i cili më vonë u inkuadrua në Fakultetin e Mjekësisë Universitetit Shtetëror të Tiranës. Në vitin 1959, pasi përfundoi me rezultate shumë të mira Fakultetin e Mjekësisë, diplomohet mjek dhe njëkohësisht, i jepet grada ushtarake “Kapiten i Dytë”. Me këtë gradë, ai emërohet mjek ushtarak në Brigadën e Nëndetësive të Pashalimanit në Vlorë, ku shërbeu deri në vitin 1962, kohë në të cilën emërohet në një detyrë tjetër brenda kësaj njësie të njohur ushtarake.

Në vitet 1962-1965, ai shërben si shef shëndetësie në Shkollën e Lartë të Aviacionit në Vlorë, ku ka fituar dhe gradën tjetër më të lartë, “Kapiten i Parë”.

Gjatë viteve 1965-1966, Gjergji kryen një kurs specializimi të drejtuar nga specialistë të huaj, për mjek radiolog dhe ishte në vartësi të Degës së Ministrisë së Shëndetësisë së Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. Në vitet 1966-1968 punon si mjek i përgjithshëm në repartin Terapisë së Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak e më vonë, në laboratorin Kliniko-Biokimik të këtij spitali. Në vitet 1968-1969, ai bën profilizim të dytë me specialistë të huaj në Radio-Biologji, pranë Laboratorit Radio-Biologjik të porsa ngritur në Tiranë, në vartësi të Degës së Shëndetësisë së Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. Në vitet 1969-1970, ai specializohet jashtë shtetit (në Kinë) për Radio-Biologji dhe në përfundim të këtij kualifikimi, caktohet mjek Radio-Biolog në sektorin radio-biologjik të laboratorit special të Degës së Shëndetësisë pranë Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. Në këtë detyrë punoi në periudhën 1970-1971. Në vitet 1971-1975, kryen detyrën e shefit të sektorit të Laboratorëve të Spitalit Ushtarak dhe më vonë Institutit Kombëtar të Mjekësisë Ushtarake (IKMU) në Tiranë. Në vitin 1981, Gjergji Aleksi fiton gradën profesionale “Kandidat i Shkencave”. Në vitet 1981-1989, ai është anëtar i këshillit shkencor të Institutit Kombëtar të Mjekësisë Ushtarake (IKMU) në Tiranë dhe sekretar i tij. Ndërsa në vitin 1987, ai fiton gradën shkencore pedagogjike “Docent”. Në vitet 1981-1990 ai jep mësim si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Mjekësisë për lëndën e Radiobiologjisë (Mjekësia e Rrezatimeve Jonizuese) në Tiranë. Në vitin 1990 mbaroi temën për gradën “Doktor i Shkencave” dhe e fiton atë në vitin 1991.

Gjatë viteve 1980-1990, ka botuar shumë artikuj e studime shkencore në fushën e specialitetit të vet dhe atë të mjekësisë së përgjithshme. Në vitin 1991, për arsye moshe, del në pension. Në vazhdim, është pedagog i jashtëm në Shkollën e Lartë të Infermierisë në Tiranë.

Që nga vitet e shkollës ‘Skënderbej’ e në vazhdim, hobi i tij kanë qenë e mbeti letërsia dhe artet. Krahas atikujve të shumtë, ai ka shkruar edhe disa libra. Në vitin 1996 ai ka botuar romanin e tij të parë me subjekt autobiografik me titullin “Mjeku i Limanit Antik”. Në vitin 1999 del me romanin e tij të dytë me titull “Skënderbegasi Genci Gora, me subjekt autobiografik, ku vendin kryesor e zë jeta në shkollën “Skënderbej”. Në vitin 2001, ai botoi romanin “Teto Emilia” dhe në vitin 2004, romanin “Rrezet Misterioze...”.



Gjeneralitet personal apo identikit kombëtar?

Gjeneralitet personal apo identikit i një kombi?

Pasaporta shqiptare e viteve '30, përveç gjeneraliteteve brenda saj kishte edhe pesë këshilla mahnitëse të shkruara.

Aty shkruhej:

/Të dish dhe të jesh i sigurt se fatbardhësia dhe lumturia jote gjendet në Shqipëri, e cila të jep nder e të fal emrin shqiptar.

/Ruaje mirë karakterin kombëtar dhe kryelartësinë shqiptare, bindu lidhjeve dhe urdhrave të vendit kudo që të jesh.

/Çdo shqiptar është vëllai yt, nderoj kurdoherë dhe ndihmoje kur të ketë nevojë.

/Mos e përbuz gjuhën e nënës tënde, duke folur gjuhë të huaja kur nuk është nevoja.

/Ndero flamurin e atdheut tënd, kush nuk e nderon shenjën e kombësisë, e çnderon vendin e vet.

/Ruaje mirë karakterin kombëtar dhe kryelartësinë shqiptare; bindju lidhjeve dhe urdhrave të vendit kudo që të jesh.

Në pasaportat shqiptare kanë lënë gjurmë të gjitha regjimet politike të kohës. Kjo duke nisur që nga vitet 20-të shekullit të kaluar, kur për herë të parë shteti shqiptar filloi t'i pajiste nënshtetasit e tij me pasaporta për të udhëtuar jashtë shtetit.

Një pasaportë e viteve 1920-1924 ka elementë të ngjashëm, por ajo ndryshon me pasaportat e periudhës së Republikës (1925-1928) e sidomos me ato të Monarkisë (1928-1939). Përveç formës së regjimit që gjendet e stampuar në ballinën e çdo dokumenti dhe elementëve të tjerë të sigurisë, të dhënave personale etj.,

pasaportat e periudhës së Monarkisë ishin të pajisura me disa këshilla, që kishin për qëllim forcimin e ndjenjës së atdhedashurisë. Por vlera dhe rëndësia e një pasaporte është në raport të drejtë me kredibilitetin politik që shteti gëzon në arenën ndërkombëtare. Nga ky këndvështrim qytetarët shqiptarë nuk kanë qenë njëloj të vlerësuar në periudha të ndryshme historike.

Në çdo pasaportë krahas të dhënave të përgjithshme vendoseshin edhe dy elementë të rëndësishëm "besimi" dhe "kombësia". Por



në vitet 60-të, kur vala e luftës kundër fesë dhe besimeve fetare po vinte duke u rritur, prania e këtyre elementëve në pasaporta do të vihet në diskutim.

Në një shkresë drejtuar sektorit juridik të kryeministrisë që mban datën 8 maj 1965, është shprehur se, ishte bërë rregull që në letërnjoftime, pasaporta dhe dokumente të tjera zyrtare të pasqyroheshin, përveç të dhënave dhe cilësive të nevojshme për përcaktimin e identitetit të shtetasit, edhe kombësia me besimin e tij fetar dhe për këtë i referohej nenit 15 të Kushtetutës, ku thuhej se: "Të gjithë shtetasit janë të barabartë pa ndryshim kombësie, race ose feje. Çdo akt që sjell privilegje në favor të shtetasve ose që kufizon të drejtat e tyre për shkak ndryshimi në kombësi, racë ose fe, është kundër Kushtetutës dhe sjell me vete dënime të parashikuara me ligj". Letërnjoftimi (pasaporta) është një dokument zyrtar që vërteton shtetësinë, identitetin e shtetasit (emrin, emrin e të atit dhe të nënës, datëlindjen, vendlindjen, gjendjen shoqërore dhe gjendjen familjare të mbajtësit. Të gjitha faktet që shënohen në letërnjoftim (pasaportë) quhen të pakundërshtueshme dhe kanë fuqi detyruese për çdo veprim që kryen shtetasi (martesë, etj.), gjersa nuk provohet e kundërta.

Ky i fundit nuk ishte element thelbësor i pasaportës, duke patur parasysh se çdo shtetas kishte të drejtë që të shprehej ose jo lidhur me përkatësinë e tij fetare. Por ndryshonte puna lidhur me "kombësinë".

Kjo, sepse shtetas shqiptarë ishte ai që lindte nga prindër shqiptar, ose që e fitonte shtetësinë nga natyralizimi. Ata që e fitonin shtetësinë shqiptare me natyralizim nuk kishin kombësi

shqiptare. Kështu që element thelbësor i identitetit të çdo shqiptari mbetej kombësia.

Pavarësisht përpjekjeve për ta hequr "kombësinë" nga pasaportat shqiptare në vitin 1965 ajo nuk u bë mundur. Konfuzioni që do të shkaktonte një veprim i tillë, sot do të kishte pasoja të pallogaritshme. Shqipëria do të mbushej me pakica inekzistente nga të gjitha vendet e botës, në varësi të parave që ato do të kishin në dispozicion. Gjatë periudhës së regjimit komunist, Shqipëria nuk lejonte qytetarët e saj të udhëtonin jashtë shtetit ndaj nuk lëshonte pasaporta të zakonshme por vetëm pasaporta diplomatike dhe shërbimi në numër të kufizuar.

Pasaporta shërbimi u lëshoheshin edhe shoferëve apo studentëve shqiptarë me studime në vende të huaja por pas përfundimit të misioneve apo studimeve pasaporta duhej të dorëzohej përsëri në organet e policisë.


Me ardhjen e demokracisë autoritetet lëshojnë pasaporta për çdo qytetar që bën kërkesë dhe që përmbush kushtet e vendosura me ligj.

Pasaporta e Shqipërisë është dokument identifikimi dhe udhëtimi që përdoret nga shtetasit shqiptarë për të kryer udhëtime jashtë kufijve të Shqipërisë dhe shërben për të provuar shtetësinë shqiptare dhe për të identifikuar mbajtësin e saj.

Organi kompetent për lëshimin e tyre është Ministria e Brendshme. Mbajtësi i pasaportës shqiptare gëzon të drejtën për mbrojtje diplomatike në çdo skaj të botës kapilarisht nga Shteti shqiptar në rast të cenimit të dinjitetit, integritetit dhe të drejtave njerëzore të shtetasve shqiptarë në vendet e huaja.



REVISTA MBROJTJA



*[http://www.mbrojtja.gov.al/
index.php/publikimet/
revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimet/revista-mbrojtja)*